



Plani Zhvillimor Urban

Shtime

2009-2020



PËRMBAJTJA

I. HYRJE

- I.1. SISTEMI I PLANIFIKIMIT HAPËSINOR NË KOSOVË
- I.2. PËRFITUESIT E PROJEKTIT
- I.3. BURIMI I TË DHËNAVE PËR HARTIMIN E PROFILIT URBAN
- I.4. ROLI DHE NATYRA E PLANIT ZHVILLIMOR URBAN

II. ROLI I PJESËMARRËSVE

- II.1. ROLET VENDIMMARRËSE / JO-VENDIM MARRËSE
- II.2. QEVERISJA KOMUNALE
- II.3. NDARJA ADMINISTRATIVE E QYTETIT
- II.4. PJESËMARRËS KYQ NË HARTIMIN E PZHU

FAZA E PARË

III. PROFILI ZHVILLIMOR HAPËSINOR URBAN

- III.1. ZHVILLIMI HISTORIK I VENDBANIMIT TË SHTIMES
- III.2. ORGANIZIMI HAPËSIONR DHE ADMINISTRATIV I VENDBANIMIT
- III.3. POZITA, PEIZAZHI DHE KARAKTERISTIKAT NATYRORE TË QYTETIT
- III.4. ZHVILLIMI DEMOGRAFIK I QYTETIT
- III.4.1. NUMRI I POPULLSISË
- III.4.2. SHTIMI NATYROR I POPULLSISË
- III.4.3. STRUKTURA E POPULLSISË SIPAS MOSHËS DHE GJINISË
- III.4.4. FAMILJA DHE KARAKTERISTIKAT E SAJ
- III.4.5. LËVIZJA MEKANIKE E POPULLSISË – MIGRIMET
- III.6. SHFRYTËZIMI I TOKËS NË QYTETIN E SHTIMES
- III.7. BANIMI NË QYTETIN E SHTIMES
- III.8. VENDBANIMET JOFORMALE
- III.9. TRASHËGIMIA KULTURORE
- III.10. ZHVILLIMI EKONOMIK
- III.10.1. BUJQËSIA
- III.10.2. TRANSPOTRI
- III.10.3. TREGTIA
- III.10.4. TURIZMI
- III.10.5. INDUSTRIA
- III.10.6. BUXHETI KOMUNAL DHE SHËRBIMET BANKARE
- III.10.7. PROJEKTET KAPITALE TË REALIZUARA NË PERIU DHËN 2001-2008
- III.11. INFRASTRUKTURA
- III.11.1. INFRASTRUKTURA RRUGORE
- III.11.2. TRANSPORTI PUBLIK
- III.11.3. ENERGJIA ELEKTRIKE
- III.11.4. INFRASTRUKTURA E FURNIZIMIT ME UJË
- III.11.5. SISTEMI I KANALIZIMIT
- III.11.6. TELEKOMUNIKACIONI
- III.11.7. MENAXHIMI I MBETRURINAVE

IV. SWOT ANALIZA – E QYTETIT SHTIME

- IV.1. SFIDAT E IDENTIFIKUARA NË QYTETIN E SHTIMES

V. POTENCIALET PËR ZONËN URBANE

VI. RAPORTI I TAKIMIT TË PARË PUBLIK

FAZA E DYTË -VIZIONI, PARIMET DHE CAQET

I. PLANI HAPËSINOR I KOSOVËS -ZONA E KALTËR

I.1. QËLLIMET E PËRGJITHSHME PËR ZONËN E KALTËR

I.2. ZONAT ME INTERES TË VEÇANTË NË ZONËN E KALTËR

II. VIZIONI PËR QYTETIN E SHTIMES

II.1. PARIMET E PËRGJITHËSHME TË ZHVILLIMIT

II.2. PARIMET E QEVERISJES SË MIRË

III. QËLLIMET AFATËGJATE TË ZHVILLIMIT

IV. PRIORITETET STRATEGJIKE

FAZA E TRETË-KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

I. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR URBAN

I.1. KONCEPTET KRYESORE TË ZHVILLIMIT HAPËSINOR

I.2.. STRUKTURAT KRYESORE HAPËSINORE

I.3. ZHVILLIMI HAPËSINOR

II. STRUKTURA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

II.1. ZHVILLIMI EKONOMIK

II.2. DESTINIMI I SIPËRFAQEVE

II.3. BANIMI

II.4. INFRASTRUKTURA SOCIALE

II.4.1. ARSIMI

II.4.2. SHËNDETËSIA

II.4.3. KULTURA, SPORTI DHE REKREACIONI

II.5. SHËRBIMET ADMINISTRATIVE DHE PUBLIKE

II.6. ORGANIZIMI ADMINISTRATIV TERRITORIAL

II.7. TRAFIKU DHE TRANSPORTI

II.8. RRJETI I UJËSJELLËSIT

II.9. RRJETI I KANALIZIMIT

II.10. PEIZAZHI DHE MJEDISI

II.10.1. PEIZAZHI

II.10.2. MJEDISI

II.10.3. TRASHËGIMIA NATYRORE DHE KULTURORE

FAZA E KATËRT-STRATEGJITË E ZHVILLIMIT URBAN

I.STRATEGJITË DHE VEPRIMET PËR ZBATIM,

I.1 STRATEGJITË PËR ZBATIM DHE PLANET E VEPRIMIT TË SHOQËRUARA ME KONCEPTET HAPËSINORE OSE PARIMET

I.1.1. STRATEGJIA E ZHVILLIMIY EKONOMIK TË QYTETIT TË SHTIMES

I.1.2. DESTINIMI I SIPËRFAQEVE DHE MËNYRAT E PËRDORIMIT

I.1.3. TRANSPORTI DHE TRAFIKU

I.1.4. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT SOCIAL

I.1.5. PEIZAZHI DHE MJEDISI

FAZA E PESTË –DISPOZITAT PËR ZBATIM

I. DISPOZITAT PËR ZBATIM

I.1. UDHËZIMET MBI ÇËSHTJET E INTERPRETIMIT TË PLANIT ZHVILLIMOR URBAN LIDHUR ME HARTIMIN E PLANEVE RREGULLATIVE DHE PLANEVE TJERA

I.2. KUSHTET E PËRCAKTUARA NGA QEVERIA LOKALE MBI ÇËSHTJE TË RËNDËSISHME PËR ZHVILLIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E TOKËS NË ZONËN URBANE

I.2.2. KUSHTET PËR RREGULLIMIN E HAPËSIRËS

2.2.1. KUSHTET PËR RREGULLIMIN E HAPËSIRËS PËR OBJKTET ME RËNDËSI PËR KOSOVËN

2.2.2. TOKA NDËRTIMORE PËR ZHVILLIMIN E QYTETIT

- I.2.3. KUSHTET PËR VENDOSJEN E OBJEKTEVE TË VEPRIMTARIVE EKONOMIKE
- I.2.4. KUSHTET PËR VENDOSJEN E OBJEKTEVE TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE
- I.2.5. KUSHTET DHE MËNYRA E NDËRTIMIT TË OBJEKTEVE TË BANIMI
- I.2.6. KUSHTET PËR PËRCAKTIMIT E RRJETIT TË SIPËRFAQEVE TË KORRIDOREVE APO TRASEVE TELEKOMUNIKUESE DHE RRJETIT TË INFRASTRUKTURËS KOMUNALE
- I.2.7. KUSHTET PËR RREGULLIMIN E ZONAVE DHE TËRËSIVE ME VLERA TË VEÇANTA
- I.2.8. MASAT PËR ZHVILLIMIN E SIPËRFAQEVE SPORTIVE DHE REKREATIVE
- I.2.9. MËNYRA E TRAJTIMIT TË HEDHURINAVE
- I.2.10. MASAT PËR ZBATIMIN E PLANIT
 - I.2.10.a. DETYRIMI PËR HARTIMIN E PLANEVE DETALE RREGULLUESE
 - I.2.10.b. MASAT PËR RREGULLIMIN DHE MBROJTJEN E TOKAVE
- I.3. DISPOZITAT LIDHUR ME KONSULTIMIN, BASHKËPUNIMIN DHE PJESËMARRJEN
- I.4. DISPOZITAT MBI RENDIN KRONOLOGJIK APO ETAPAT E ZBATIMIT
- I.5. ELEMENTET DHE UDHËZIMET PËR HULUMTIM TË MËTUTJESHËM

LISTA E SKEMAVE

Roli i pjesëmarrësve

- Skema 1. Skema e mobilizimit institucional
Skema 2. Struktura organizative e komunës së Shtimes.

LISTA E TABELAVE

- Tabela 1. Grupet punuese komunale
Tabela 2. Grupet punuese këshilli i ekspertëve
Tabela 3. Grupet punuese nga kompania

Zhvillimi demografik,social dhe vendbanimet e Shtimes

- Tabela 4. Zhvillimi demografik i Shtimes deri sot
Tabela 5. Kontingjentet më të rëndësishëm të strukturës së moshës dhe gjinisë
Tabela 6. Migrimet në komunën e Shtimes,Migrimet në botën e jashtme dhe ato definitive
Tabela 7. Bilanci i sipërfaqeve ekzistuese sipas mënyrës së përdorimit në kuadër të komunës kadastrale të Shtimes
Tabela 8. Territori i analizuar në hektar
Tabela 9. Fondi i banesave dhe sipërfaqet banesore
Tabela 10. Madhësia dhe sipërfaqja e banimit për anëtar
Tabela 11. Treguesit urbanistik të gjendjes ekzistuese

Karakteristikat fiziko-gjeografike dhe mjedisi

- Tabela 12. Monumentet e trashëgimisë kulturore

Zhvillimit ekonomik dhe infrastruktura

- Tabela 13. Të hyrat në buxhetin e komunës së Shtimes për vitin 2008-2010
Tabela 14. Bilanci i sipërfaqeve sipas mënyrës së përdorimit
Tabela 15. Sipërfaqet e gjelbra të komunës kadastrale të qytetit të Shtimes
Tabela 16. Monumentet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore

LISTA E GRAFIKËVE

Zhvillimi demografik,social dhe vendbanimet e Shtimes

- Grafiku 1. Shtimi natyror në promil për vitin 2006 në Shtimes
Grafiku 2. Piramida e popullsisë së qytetit të Shtimes në vitin 2004
Grafiku 3. Tri grup-moshat e popullsisë së qytetit Shtime
Grafiku 4. Përqindja e popullsisë sipas gjinisë në qytetin e Shtimes
Grafiku 5. Përqindja e familjeve sipas numrit të anëtareve

Karakteristikat fiziko-gjeografike dhe mjedisi

- Grafiku 6. Gjatësia e rrugëve në territorin e qytetit të Shtimes

Zhvillimit ekonomik dhe infrastruktura

- Grafiku 7. Të hyrat e administratës komunale për vitin 2008-2010
Grafiku 8. Përqindja e investimeve kapitale sipas sektorëve në komunën e Shtimes për periudhën 2001-2008

LISTA E HARTAVE

Zhvillimi demografik,social dhe vendbanimet e Shtimes

- Harta 1. Komunat kadastrave- Shtime: ndarja në 5 lagje
Harta 2. Zona urbane Ortofoto 2004

Zhvillimi demografik,social dhe vendbanimet e Shtimes

- Harta 3. Shfrytëzimi i tokës në zonën urbane
Harta 4. Zgjerimi i zonës së ndërtuar sipas viteve
Harta 5. Vendbanimet jo formale
Harta 6. Konceptet e zhvillimit hapësinor urban
Harta 7. Potencialet e zhvillimit ekonomik
Harta 8. Plani i shfrytëzimit të tokës në qytetin e Shtimes
Harta 9. Institucionet arsimore,kulturore dhe shëndetësore

- Harta 10.** Organizatat administrative
- Harta 11.** Rrjeti i rrugëve
- Harta 12.** Rrjeti i ujësjellësit
- Harta 13.** Sistemi i kanalizimit
- Harta 14.** Ndotja e lumit Shtimjanja, mbetjet e mbeturinave dhe masat kundër përmytjeve
- Harta 15.** Përkufizimi i sipërfaqes ndërtimore në tokat e kategorisë II-IV
- Harta 16.** Trashëgimia kulturore dhe natyrore e qytetit të Shtimes

I. HYRJE

Kuvendi Komunal i Shtimes ka marrë vendim për hartimin Planit Zhvillimor Urban të Shtimes, në Shtator 2007. Me datën 05.11.2008 u nënshkrua kontrata me kohëzgjatje prej 8 muajve në mes K. K. Shtime dhe **N. Sh. P.** Data-GIS-cosulting.

Qëllimi i projektit – Qëllimi kryesor i këtij projekti është që Qyteti i Shtimes të ketë një plan zhvillimor urban modern, efikas dhe të bazuar në norma e standarde evropiane. Ky projekt do të jetë në harmoni të plotë me objektivat e „Ligjit Nr.03/L-106, ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 2003-14”, si dhe do të ketë harmonizim të plotë me Planin Zhvillimor Komunal.

Plani Zhvillimor Urban do të siguroj bazë të mirë për një zhvillim të qëndrueshëm të qytetit të Shtimes. Zhvillimi i qëndrueshëm nuk nënkupton vetëm ruajtjen e mjedisit kryesor, por edhe shfrytëzimin e kontrolluar të resurseve me qëllim të krijimit të kushteve të zhvillimit ekonomik, për gjeneratat e ardhshme dhe balancimin e zhvillimeve hapësinore. Kjo do të thotë që të ri koordinohen kërkesat sociale dhe ekonomike për hapësirën me funksionet e saj kulturore dhe ekologjike, kështu që të kontribuojnë në balancimin e zhvillimeve hapësinore.

Plani zhvillimor është dokument që hartohet për territorin urban të Shtimes për periudhën e ardhme kohore deri në vitin 2020 dhe jep udhëzime konkrete për veprimet që duhet të ndërmerren: Pse duhet ndërmarr ato veprime, po ashtu, sqaron se si duhet të realizohen veprimet e tilla?. Veprime këto që do të ndikonin në përmirësimin e jetës së qytetarëve të komunës së Shtimes, duke ndikuar në ngritjen e kualitetit social, ekonomik dhe fizik të hapësirës përkatëse.

Plani Zhvillimor urban jep mundësi të vazhdimësisë së planifikimit edhe për të ardhmen (pas periudhës së caktuar). Në dokumentin e planit merren vendime afatgjate, por gjithmonë duke pasur parasysh fleksibilitetin e planit, kur dihet se: në të ardhmen mund të paraqiten rrethana të reja që kërkojnë modifikime të vazhdueshme (kërkesat e ndryshme të popullsisë, ndryshimet në politikën qeveritare, parimet ndërkombëtare etj.).

PZHU tani orientohet kah procesi dhe veprimi, fillon me konsensus mbi çështjet, është seleksionuar dhe i fokusuar duke adresuar përparësitë dhe mangësitë. Është proces në të cilin përfshihet edhe ajo që është e paplanifikuar. Këtij procesi i paraprinë një vizion realist dhe i qëndrueshëm. Me aprovimin e dokumentit, i cili do të jetë i hartuar përmes procesit të konsultimeve publike dhe i bazuar në vlerësimin e gjendjes ekzistuese, resurseve potenciale, duke identifikuar çështje apo fusha ku duhet ndërmarrë veprime urgjente, me qëllim të mbrojtjes, kultivimit dhe zhvillimit të vlerave socio-ekonomike dhe mjedisore të qytetit të Shtimes.

Rezultat i përfundimit të Planit do të jetë informata përmbajtjesore për gjendjen demografike-sociale, ekonomike, infrastruktura dhe mjedisi në qytetin e Shtimes. Në shtrirjen hapësinore të dukurive do të duken qartë caqet e zhvillimit urban dhe zonat me prioritet për intervenim nga do të rrjedhin propozimet për zhvillimin e ardhshëm hapësinor dhe mënyrën se si do të arrihet ky zhvillim.

I.1. SISTEMI I PLANIFIKIMIT HAPËSINOR NË KOSOVË

Sistemi i planifikimit në bazë të „Ligjit Nr.03/L-106, dhe ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 2003-14”, në bazë të Nenit 9 Nivelet e planifikimit janë:

1. Planifikimi për territorin e Kosovës
2. Planifikimi për territorin e Komunave

Llojet e planeve në bazë të Nenit 10.2 në nivel të Komunës janë këto:

1. Plani zhvillimor i komunës
2. Plani zhvillimor urban
3. Plani rregullativ urban


Në bazë të Nenit 14.1 Komuna përgatitë Planin Zhvillimor Urban për të gjitha territoret urbane brenda territorit të komunës. Plani Zhvillimor Urban është plan strategjik multi-sektorial, i cili përcakton synimet afat gjata për zhvillimin dhe menaxhimin të zonave urbane, për periudhën më së paku pesë (5) vjeçare.

PZHU bazohet në gjendjen ekzistuese sociale, ekonomike dhe mjedisore dhe është proces gjithëpërfshirës, transparent me pjesëmarrje publike në vendimmarrje. Pjesëmarrja publike nënkupton involvimin e të gjithë faktorëve relevant me interes: Drejtoritë komunale, Ministritë e Qeverisë së Kosovës, Institucionet shkencore dhe hulumtuese, Organizatat e shoqërisë civile, komunale etj.

Bazuar në kornizën logjike të aktiviteteve, ky proces planifikohet të zgjasë 8 muaj.

Më poshtë është dhënë skema e mobilizimit institucional të pjesëmarrjes në procesin e hartimit të PZHU-së

Skema 1. Skema e mobilizimit institucional



PZHU bazohet në:

- Parimet e përcaktuara me Ligj
- Vizionin dhe caqet strategjike
- Raportet e sektorëve të rëndësishëm
- Strategjitë zhvillimore të sektorëve të ndryshëm
- Elemente tjera të përcaktuara me akte të veçanta

Si i tillë, plani përcakton parimet dhe qëllimet afatgjate të planifikimit hapësinor për periudhën deri në vitin 2020. Gjithashtu përcakton afatet kohore reale dhe implikimet buxhetore.

Korniza për hartimin e PZHU përbëhet nga pesë faza:

Faza I -Përgatitja e profilit dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese

Faza II - Vizioni, Parimet dhe Caqet

Faza III - Korniza e Zhvillimit Hapësinor

Faza IV - Strategjitë dhe veprimet për zbatim

Faza V- Dispozitat për zbatim

• **Faza e parë e Planit është hartimi i profilit**– dokumenti mbi gjendjen ekzistuese të zhvillimit hapësinor urban. Ky është dokumenti bazë për njohjen dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese të zhvillimeve në hapësirë, si dhe përcakton orientimet themelore për hartimin e PZHU-së

• **Faza e dytë e Planit** - Vizioni, parimet dhe caqet strategjike të zhvillimit hapësinor urban.

• **Faza e tretë e Planit** – Korniza e zhvillimit Hapësinor shpreh parashikimet e dëshiruara hapësinore për territorin urban.

• **Faza e katërt** - është Strategjia dhe veprimet për zbatim. Kjo fazë formulon pakon e strategjive dhe veprimet për realizimin e qëllimeve brenda kornizës hapësinore, afatet kohore, implikimet financiare dhe kornizën institucionale.

• **Faza e pestë** - Përfshin elementet e Zbatimit obligativ, që ndërlidhen me nivelin urban dhe komunal.

Gjatë hartimit të PZHU-së, struktura e projektit do të ndahet në katër fusha kryesore:

1. Popullsisë, çështjeve sociale, banimit dhe vendbanimet.
2. Mjedisit, përfshirë trashëgiminë kulturore, natyrore, peizazhet, etj.
3. Zhvillimin ekonomik, industrinë, turizmin, rekreacionin, tregtinë, bujqësinë, etj;
4. Infrastrukturës - transportit urban, komunikimet, etj.

Përveç katër fushave kryesore të projektit janë edhe komponentët tjera që fuqizojnë planin për zbatim gjithëpërfshirës dhe implementues:

1. Plani Zhvillimor Urban (përgatitja e dokumentit final dhe pranimi i planit nga asambleja komunale) duke përfshirë edhe planin gjeneral të shfrytëzimit të tokës, i cili është në pajtueshmëri me ligjin për planifikim hapësinor të Kosovës. Drafti i planit rregullativ urbanistik nuk është pjesë e këtij projekt propozimi. Gjatë procesit të planifikimit ekipi punues do të konsultohet vazhdimisht me drejtorinë e urbanizmit për punë të mëtutjeshme.

2. Rregullimi afatgjatë i zhvillimit hapësinorë dhe ekonomik i qytetit të Shtimes duke u bazuar në koncepte të ndryshme të zhvillimit hapësinor dhe urban.
3. Bashkëpunimi i ngushtë dhe trajnimi i stafit të qeverisë lokale gjatë hartimit të Planit zhvillimor urban, si dhe, do tu mundësohet atyre për të vazhduar detyrimet dhe përgjegjësit të cilat dalin nga plani zhvillimor urban.
4. Trajnimi i stafit të selektuar nga komuna në GIS, i cili do të ofroj njohuri të mira në GIS, si dhe do të jetë ndihmë e madhe në implementimin e projektit.
- ✓ Paketën e GIS softuerit (me të cilën kompania e realizon projektin) komuna mund ta propozoj, ndërsa kompania Data GIS consulting do ta siguroj brenda ofertës së vet solucionin e MapInfos v. 8.0.
5. Ofrimin e konceptit për GIS infrastrukturë dhe menaxhimin e të dhënave me GIS.

I.2.. PËRFITUESIT E PROJEKTIT

Ky projekt është gjithëpërfshirës dhe shumë dimenzional. Andaj, përfitimet janë shumë të rëndësishme nga fakti se do të planifikohet një zhvillim i përgjithshëm në përputhje të plotë me interesat e qytetareve të Shtimes. Projekti, gjithashtu do të jetë në harmoni të plotë me politikat e zhvillimit dhe mbrojtës që ka Qeveria komunale.

Plani Zhvillimor Urban që do të hartohet në përputhje të plotë me interesat e qytetarëve të Shtimes dhe që do të bëhet në harmoni me politikat e zhvillimit hapësinor të Kosovës dhe të Unionit Evropian, paraqet një përfitim real dhe afatgjatë për të ardhmen e qytetit. Në këtë kontekst, përfituesit kryesor të këtij projekti do të jen: KK Shtime, Institucionet e Kosovës, komuniteti, sektori shoqëror, sektori privat, OJQ-ët, , grupet e interesit etj.

I.3. BURIMI I TË DHËNAVE PËR HARTIMIN E PROFILIT URBAN

Mbledhja e të dhënave si bazë për hartimin e Planit Zhvillimor Urban është element i domosdoshëm. Gjatë hartimit të profilit urban si dhe për vlerësimin i gjendjes ekzistuese janë shfrytëzuar burime dhe metoda të ndryshme për grumbullimin, sistemimin dhe analizimin e të dhënave të nevojshme. Grumbullimi i të dhënave është bërë nga strukturat komunale të Shtimes dhe stafi i kompanisë përmes një bashkëpunimi të ngushtë mes grupeve punuese.

Sektorët e Qeverisë komunale kanë bërë grumbullimin e të dhënave bazë në fusha të caktuara duke qenë në përputhje me kërkesat e kompanisë.

Të dhënat bazë për hartimin e Planit Zhvillimor Urban janë shfrytëzuar nga burime të ndryshme:

- Të dhënat zyrtare nga sektorët e Qeverisë Komunale – plotësimi i veglave të punës.
- Regjistrimi i popullsisë që është realizuar në vitin 2004 nga komuna e Shtimes
- Të dhënat nga zyrat komunale dhe regjionale të Qeverisë së Kosovës (Zyra e Punës dhe punësimit, Zyra për mirëqenie sociale, ESK), etj.
- Të dhënat nga Drejtoria për Urbanizëm

- Të dhënat nga kompanitë publike komunale.
- Plani detal urbanistik – i hartuar nga Enti për Urbanizëm, Prishtinë.
- Parcelat kadastrale – zyra komunale për Kadastër.
- Hartat topografike: 1: 50 000, 1: 25 000
- Orto-fotot (prodhim: viti 2000 dhe 2004) - zyra komunale për Kadastër.
- Puna në terren (ekipet e kompanisë kanë vizituar tërë zonën urbane).
- Aplikimi i GIS dhe GPS
- Literatura shkencore.

Në vazhdimësi të procesit të hartimit të planit, janë grumbulluar të dhëna të reja dhe të rëndësishme, që janë inkorporuar në dokumentin e profilit. Kjo nënkupton plotësimin e profilit me të dhëna të reja edhe në të ardhmen.

I.4. ROLI DHE NATYRA E PLANIT ZHVILLIMOR URBAN

a) Promovon interesat e përbashkëta të popullatës në katër fushat kryesore:

- Demografi dhe zhvillim social
- Mjedis dhe shfrytëzim të tokës
- Infrastrukturë dhe
- Zhvillim ekonomik

b) Plani Zhvillimor urban duhet të:

- Mundësojë që përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent, të përcaktojë kahet e zhvillimit social, shfrytëzimin mjedisor, mbrojtjes mjedisore, zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe infrastrukturë për qasje dhe lidhje më të mirë e mbi të gjitha rritjen e kualitetit të jetesës.
- Ndikojë në vendimet politike, lidhur me investimet publike në infrastrukturë, për t'i përmirësuar shërbimet ndaj qytetarëve;
- Përkrahë zhvillimin e balancuar në mes të zonave urbane me zhvillim ekonomik më të ulët;
- Të jetë udhëzues në hartimin e Planeve Rregullative Urbane
- Identifikojë lokacionet me potencial të zhvillimit hapësinor të qytetit;
- Aprovojë vendimet lidhur me zonat e industrisë dhe biznesit, banimit, shërbimeve, turizmit dhe trashëgimisë natyrore dhe kulturore;
- Identifikojë rolin e zonave kryesore brenda qytetit, në zhvillimin e përgjithshëm socio-ekonomik dhe kulturor të qytetit.

c) Roli i qeverisë lokale - Qeverisja, si vendimmarrëse dhe implementuese e vendimeve të marruara, duke u mbështetur në parimet kryesore:

- Pjesëmarrja publike;
- Sundimi i ligjit;
- Transparenca;
- Përgjegjësia;
- Konsensusi;
- Barazia dhe gjithë përfshirja;

- Efikasiteti dhe
- Llogaridhënia

II.ROLI I PJESËMARRËSVE

Në respektim të parimeve ndërkombëtare të rekomanduara me ligj, e posaçërisht të Agjendës 21 dhe Agjendës së UN-HABITAT, procesi tenton të përfshijë një numër sa më të madh të pjesëmarrësve në fazën përgatitore për hartimin e Planin Zhvillimor Urban, në mënyrë që parimet e gjithë-përfshirjes, transparencës, efikasitetit, barazisë dhe qëndrueshmërisë, të promovohen dhe zbatohen në praktikë nga Komuna.

Në bazë të Ligjit për Planifikim Hapësinor, Plani Zhvillimor Urban është plan multi-sektorial, i cili merr parasysh zhvillimet e sektorëve që menaxhohen nga komuna, involvimi, i të gjithë pjesëmarrësve të cilët mund të kenë ndikim ose të jenë të ndikuar nga plani esencial për të zbatuar parimet e pjesëmarrjes publike dhe transparencës së procesit të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban.

II.1. ROLET – VENDIMMARRËSE/JO-VENDIMMARRËSE

Roli në vendim- marrje përveç qeverisë lokale duhet të jetë transparent edhe për pjesëmarrësit të tjerë në proces siç janë shoqëria civile, sektori privat, OJQ, shoqatat e ndryshme të fermerëve, bletarëve, ekspertëve të pa varur, e institucioneve të ndryshme që involvohen në proces të planifikimit.

Pjesëmarrësit nga niveli qendror, përfaqësues të ministrive të Qeverisë së Kosovës – me të dhënat, raportet dhe strategjitë e sektorëve përkatës e plotësojnë përmbajtjen e dokumentit


Një pjesë e konsiderueshme e të dhënave rrjedhin nga sektori jo-qeveritar, analizat dhe raportet e të cilëve në të shumtën e rasteve kanë shërbyer për krahasim, e në disa raste edhe si të vetmet burime të dhënave.

II.2. QEVERISJA KOMUNALE

Pas përfundimit të Luftës në qershor të vitit 1999 Kosova ka hy nën administrimin ndërkombëtar të Kobëve të Bashkuara. UNMIK- shtriu ndikimin e vet edhe në qeverisjen lokale, ku sipas Nenit 3 të rregullores së vet Nr. 2000/45, komunave ju ndanë rolet dhe përgjegjësit, si dhe, rolin në ofrimin e kushteve themelore bazike për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Procesi i decentralizimit në Kosovë qartësojë edhe kompetencat për vetëqeverisje lokale. Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale Nr. 03/L-040 në Kreu III Kompetencat komunale, Neni 15 Parimi i subsidiaritetit –Komunat ushtrojnë kompetencat e tyre sipas parimit të subsidiaritetit dhe, Neni 16 –Komuna ushtron kompetenca vetjake, të deleguara dhe të zgjeruara në përputhje me ligjin.


Organet komunale janë: Kuvendi që është organi më i lartë në komunë dhe, Kryetari që kryen udhëheqjen komunale të ekzekutivit.

Skema 2. Struktura organizative e komunës së Shtimes

II.3. NDARJA ADMINISTRATIVE E QYTETIT TË SHTIMES

Komuna kadastrale e Shtimes është e ndarë në pesë lagje urbane: Shtime I , Shtime II, Shtime III, Shtime IV dhe Shtime V.

Harta 1. Komunat kadastrave – Shtime: ndarja në 5 lagje urbane



II.4. PJESËMARRËS KYÇ NË HARTIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR URBAN

Nga Kuvendi Komunal Shtime - Udhëheqës i të gjitha grupeve punuese dhe tërë procesit janë:

1. Naim Ismajli - Kryetar i Komunës
2. Mehdi Salihu - Drejtori DPUKM

Institucionet kyçe të komunës të involvuara në procesin e hartimit të planit janë:

1. Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mjedis - Mehdi Salihu, drejtor
2. Drejtoria për Administratë Komunale - Ekrem Reçica, drejtor
3. Drejtoria për Ekonomi dhe Financa - Sabri Çerkini, drejtor
4. Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport - Liman Pajaziti, drejtor
5. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - Fatmir Emini, drejtor
6. Drejtoria e inspektoratit - Bashkim Ahmeti, drejtor

Grupet punuese komunale:

Tabela 1. Grupet punuese komunale

Grupet punuese komunale	Anëtarët e grupit punues
Demografi dhe zhvillim social	1. Lulzim Sahiti-kryesues
	2. Liman Pajaziti
	3. Fatmir Emini
	4. Taulant Salihaj
Mjedisi dhe shfrytëzimi i Tokës	1. Bashkim Ahmeti-kryesues
	2. Skënder Dauti
	3. Fadil Emini
Zhvillimi ekonomik	1. Shaban Shabani -kryesues
	2. Lulzim Muharremi
	3. Ejup Ismajli
	4. Rexhep Limani
Infrastruktura	1. Fehmi Hysenaj- kryesues
	2. Bekim Dauti
	3. Idajet Rexhepi
	4. Ramadan Ukaj

Këshilli i ekspertëve

Tabela 2. Grupet punuese këshilli i ekspertëve

Emri Mbiemri	Profesioni
Adriatik Beqa	Ing. i Arkitekturës
Ali Ademaj	Ing.i Hidroteknikës
Arif Beqa	Jurist.i dpl.

Enver Ademi	Mjek specialist
Hava Shahini	Prof.Gjeografie
Mehdi Salihu	Ecc.i dipl.
Naim Zeqiri	Historian
Naser Sahiti	Dr . Makinerisë
Rexhep Limani	Ing Bujqësisë
Sabri Çerkini	Ecc.i Dipl.
Ekrem Reçica	Jurist i dpl.

Tabela 3.Grupet punuese nga kompania:

Grupet punuese komunale	Anëtarët e grupit punues
Menaxher i projektit	1. Prof. Dr. Ord. Asllan– Pushka, socio-ekonomist
Udhëheqës profesional	1. Dr. Sc. Ibrahim Ramadani, prof. - urbanist
Demografi dhe zhvillim social	2. Mr.sc. Hazer Dana - Demograf /planer
Mjedisi dhe shfrytëzimi i Tokës	2. Dr. Sc. Gani Gashi – hidrolog, hartograf
Zhvillimi ekonomik	3. Riza Murseli, prof. – gjeo- ekonomist/ planer
Infrastruktura	4. Tomor Qela, prof – Gjeograf/ GIS specialist
Stafi profesional	1. Dr. Sc. Shpejtim Bulliqi, Gjeomorfolog 2. Mr. Sc. Burbuqe Nushi-Latifi , specialist i shëndetit publik 3. Bajram Kafexholli, GIS ekspert 4. Hasim Kryeziu / GIS ekspert 5. Luljeta Krasniqi, ecc.dipl. 6. Mr. sc. ecc. Mic Avdullahu 7. Ramush Aliu, ing. nder. 8. Izjah Celaj, prof., lektor

“PROFILI DHE VLERËSIMI I GJENDJES EKZISTUESE”

FAZA E PARË

III. PROFILI ZHVILLIMIT HAPËSINOR URBAN

Profili i gjendjes ekzistuese, do të realizohet përmes sigurimit dhe dokumentimit të informacioneve konkrete në lidhje me territorin urban të Shtimes. Gjendja ekzistuese do të hulumtohet në sfera të ndryshme me qëllim të inkorporimit të gjitha elementeve hapësinore. Për këtë qëllim, në këtë fazë, formohen grupe punuese, që do të punojnë në fusha të ndryshme (p.sh. Popullsia, zhvillimi social, mjedisi, shfrytëzimi i tokës, zhvillimi ekonomik, infrastruktura etj). Pra, qëllimi është që të grumbullohen sa më shumë informata të nevojshme për fusha ndër më të ndryshmet, sepse kjo fazë përbën një bazë të rëndësishme të procesit të planit zhvillimor urban. Kjo për faktin se duke e ditur gjendjen aktuale në hapësirën urbane, më lehtë mund të planifikohen zhvillimet e ardhshme. Në bazë të hulumtimeve dhe konsultimeve që do të realizohen për paraqitjen e gjendjes ekzistuese, në sektor dhe fusha të ndryshme tematike, duhet të identifikohen të gjitha problemet dhe çështjet që ekzistojnë në hapësirë.

Përcaktimi i çështjeve do të shërbej si bazë e mirë për hapat e mëtejshëm të procesit, duke planifikuar vazhdimisht të gjitha mundësitë e zgjidhjes së tyre. Profili përfshin këto elemente dhe gjatë punës mund të evidentohen edhe fusha të tjera.

III.1. ZHVILLIMI HISTORIK I VENDBANIMIT SHTIME

Territori i Shtimes me rrethinë ishte i banuar që nga periudhat e hershme, madje edhe nga parahistoria. Gjurmët e banimit vërehen në lokalitetet e shumta, këtë e dëshmojnë kultura materiale, formë gërmadhash të gjetura në disa vendbanime të kësaj hapësire, si në viset malore ashtu edhe në fusha. Lokalitetet që dëshmojnë lashtësinë janë vendbanimet Petrovë, Legjendas (Petroviq), Mollopolc, Vojnovc, Godanc i Epërm, si dhe në vet qytetin e Shtimes dhe kodrat përreth, etj. Lokaliteti në afërsi të Shtimes “Lajthijat” dëshmon për gjurmët e lashta të kohës iliro-romake dhe mesjetare. Të gjitha këto lokalitete duhet të gjurmohen dhe të vihen nën mbrojtje, sepse pa e njohur të kaluarën nuk mund ta planifikojmë të ardhmen.

Edhe në periudhën iliro-romake, nëpër këto territore kalonin rrugë të rëndësishme. Dëshmi për këtë është pjesa e rrugës “vjetër” në luginën e lumit Topillë që lidhte lindjen me perëndimin.¹

Shtimja si vendbanim përmendet për herë të parë në vitin 1326 me emrin Shtimni, në një diplomë lëshuar për një dubrovnikas, që dëshmon për ekzistencën e pallatit të mbretit S. Deçani. Sipas kartës së Dushanit të vitit 1348, banorët e Shtimes ishin të obliguar të ndajnë një sasi nga prodhimet bujqësore për të. Në regjistrin kadastral të vilajetit Vëllk të vitit 1455, Shtimja është shënuar si fshat i madh me 109 shtëpi. Në fund të shekullit XIX Shtimja kishte 100 shtëpi. Në vitin 1905 kishte 97 shtëpi. Sipas

¹ . Jusuf Osmani; Vendbanimet e Kosovës, f.152

shënimeve statistikore, në vitin 1913 kishte 1232 banorë. Në regjistrimin e vitit 1921 kishte 153 shtëpi me 1071 banorë.

Për shkak të pozitës së mirë gjeografike, si nyje komunikacioni që lidhte lindjen me perëndimin edhe në periudhën osmane Shtimja kishte numër të konsiderueshëm të punëtorive zejtare, kështu që, u bë tërheqëse për banorët e rrethinës së saj. Qysh në vitin 1931 Shtimja, arriti që t'i ketë 25 dyqane zejtare.² Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, fillon rritja e matur e qytetit dhe popullsisë së këtij vendbanimi. Kjo shihet sipas të dhënave nëpër vite:

Në vitin 1921 Shtimja kishte 1071 banorë.

Në vitin 1948 popullsia u shtua në 2003 banorë.

Në vitin 1971 numri i banorëve prek shifrën 3866 banorë.

Në vitin 1981 numri i banorëve arriti në 5271 banorë.

Me formimin e komunës së Shtimes në vitin 1988, në kuadër të së cilës hynë 21 vendbanime, u paraqitën kushtet dhe dispozitat reale për një zhvillim të pavarur në bazë të mundësive të shfrytëzimit të resurseve natyrore dhe ekonomike ekzistuese. Niveli i urbanizimit të Shtimes dhe vendbanimeve përreth është ende në nivel të ulët. Kjo pasqyrohet me zhvillimin e pamjaftueshëm ekonomik dhe mungesës së industrisë, rrjetit të dobët rrugor, në vet qytetin dhe, vendbanimet përreth, pastaj, niveli ulët i pajisjes me infrastrukturë komunale (ujësjellës, kanalizim, etj), ndërtim i shumë njësive banuese dhe biznesi në mënyrë të pa planifikuar, të cilat në të shumtën e rasteve janë pa infrastrukturë përcjellëse urbane.

III.2. ORGANIZIMI HAPËSINOR DHE ADMINISTRATIV I VENDBANIMIT TË SHTIMES

Vendbanimi Shtime, shtrihet rrzëzë shpateve të malit Carraleva, me pjerrësi të vogël në drejtim të fushës së Kosovës, në udhëkryqin e rrugëve që lidhin Prishtinën, Prizrenin dhe Ferizajin, në distancën prej 31 km nga kryeqendra e Kosovës, Prishtina. Fillet e banimit në territorin e Shtimes datojnë, që nga periudha dardane e më herët, këtë e dëshmojnë gjurmët e lashta në formë të gërmadhave, që ndodhen përreth këtij vendbanimi, por të pa hulumtuara.³ Vet pozita e volitshme e vendbanimit rrzëzë maleve të Carralevës duhej të ishte atraktive për banim që nga parahistoria. Për shkak të kryqëzimit të rrugëve që takohen në qendër të qytetit, vendbanimi u zhvillua përgjatë këtyre boshteve dhe, kjo kushtëzoi formën lineare të kësaj qendre urbane.

Shtimja deri vonë ishte pothuajse vetëm një fshat nën administrimin e Ferizajt. Kurse nga viti 1988, proklamohet qendër komunale, në të cilën gravitojnë 23 vendbanime të karakterit rural. K. kadastrale e Shtimes përfshin sipërfaqen prej 1282 ha me rreth 9100 banorë, ndërsa sipërfaqja e përgjithshme e kompleksit ndërtimor arrin në 199.3 ha. Zona e ndërtuar (180.1 ha) bashkë me sipërfaqet me destinim të veçantë (5.62 ha) dhe

² .J. Osmani;vepra e cituar, f.205.

³ .Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, f.205.

sipërfaqet e transportit (13.56 ha) përfshin sipërfaqen prej 199.3 ha. Brenda kësaj zone të përgjithshme për qëllime apo aktivitete të ndryshme urbane (199.3 ha) dominojnë sipërfaqet e banimit me 77.8 %, Të gjitha këto tregojnë se vendbanimi i Shtimes si qendër urbane ende ndodhet në nivel të ulët të zhvillimit dhe organizimit shoqëror-ekonomik.

Harta 2. Zona urbane Ortofoto 2004



III.3. POZITA, PEIZAZHI DHE KARAKTERISTIKAT NATYRORE TË QYTETIT TË SHTIMES

Gjerësia dhe gjatësia gjeografike- Shtimja, për nga pozita gjeografike (41° e $30'$ min të gjerësisë gjeografike veriore dhe 21° e $20'$ min të gjatësisë gjeografike lindore) ndodhet në pjesën qendrore të Kosovës, në udhëkryqin e rrugëve me traditë të gjatë historike.

Relievin e rajonit të Shtimes e përbëjnë terrenet e rrafshëta me lartësi mbidetare 500-550 metra dhe terrenet morfologjike në perëndim me shpate të buta (550-600 m) të cilat janë të përshtatshme për zhvillim dhe zgjerim të mëtejshëm të qytetit.

Klima-Faktori kryesor makroklimatik që ndikon në veçoritë klimatike të Shtimes është ndikimi dominues i qarkullimit veriperëndimor të ajrit.

Për nga lartësia ose niveli i të reshurave, Shtimja i takon grupit të vendeve mesatarisht të thata.

Insolimi mesatar vjetor është 2034 orë, temperatura më e lartë mesatare mujore (qershor-gusht) është 18.9 gradë c, kurse më e ultë në muajin janar, deri -2.6.gr C. Temperatura mesatare vjetore është 9.9 ° C.

Lagështia relative e ajrit sillet rreth 86 % (dhjetor-janar) dhe më e ulëta 63% (prill-maj).

Reshjet mesatare vjetore sillen rreth 731.2 mm, ndërsa sasia më e vogël e reshjeve është në gusht, me 42.2 mm.

Në aspektin hidrografik, territori i Shtimes është i varfër. Rrjedhat ujore të territorit të Shtimes e përbëjnë lumin Shtimjanja.

Karakteristikat gjeologjike dhe gjeomekanike janë mjaft të ndryshueshme.

Terreni sizmik aktiv, sikurse në hapësirën më të gjerë kosovare, është karakteristikë edhe për territorin e Shtimes, me lëkundje të mundshme të intensitetit deri 9⁰ të Merkalit.

Gjendja e faktorëve natyror - krahas zhvillimit dhe rregullimit urban faktorët natyror mund të jen të ndryshueshëm në kohë dhe hapësirë. Prandaj, në këto raste doemos duhet të trajtohen ndryshimet që ndodhin në toka bujqësore, pyje, hapësira ujore dhe ndryshimet në cilësinë e ajrit.

Tokat bujqësore vazhdimisht po pakësohen si pasojë e ndërtimit të pakontrolluar, erozionit, deponive, eksploatimit të dheut e rërës, ndotjes, etj. Sipërfaqet bujqësore brenda zonës kadastrale të Shtimes janë 859 ha.

Fondi i sipërfaqeve pyjore brenda zonës kadastrale arrin në 36.36 ha, pyllëzimi i sipërfaqeve të reja është në nivel të ulët.

Lumenjtë - lumi që kalon përgjatë territorit të zonës urbane, sipas klasave të ndotjes i takon këtyre kategorive:


Shtimjanja nga burimi deri në hyrje të zonës urbane i takon klasit të -I-, kurse nga qyteti deri në derdhje, i takon klasit të IIb.

Lumi i Shtimes tani ka rolin e kolektorit të ujërave të zeza, ndërsa nga dalja e qytetit ndotja është më e theksuar për shkak të shkarkimit të ujërave të zeza pa trajtim paraprak. Shkarkimi i ujërave të zeza dhe industriale në lumin Shtimjanja rritë shkallën e ndotjes së lumit. Në pjesën e lumit Shtimjanja, që kalon nëpër qytetin e Shtimes shkarkohen ujërat e zeza pa ndonjë trajtim paraprak.

Lumi Shtimjanja është me shkallë të ndotjes II-b nga dhe, lumi Caralevës nga vendbanimi Caralevë e deri në gryk, e që derdhet në lumin Sitnica dhe pas daljes nga qyteti shkarkohen ujëra të zeza, ku shkalla e ndotjes rritet. Ndotja e ujit të lumit Shtimjanja është pasojë e shkarkimit të ujërave të zeza të qytetit të Shtimes dhe fshatrave që shtrihen përgjatë lumit, si dhe, objekteve të ekonomive të vogla.

Shkarkimi i ujërave të zeza në rrjedhjet lumore pa trajtim paraprak rritë shkallën e ndotjes së lumit Shtime. Mesatarisht çdo banor shkarkon 16.46 m³/vit ujëra të zeza.

Vetëm Shtimja si qytezë me 9100 banorë shkarkon 4.74 l/s ose 149786 m³ ujëra të zeza të pa trajtuara në lumë brenda vitit, pa llogaritur këtu objektet shoqërore,



tregtare hoteliere, industriale etj, si dhe, pa llogaritur vendbanimet tjera që shkarkojnë ujërat e zeza në rrjedhat lumore.

Ajri - ndotës kryesor i ajrit në qytetin e Shtimes është komunikacioni dhe lirimi i gazrave, tymit nga ngrohja e objekteve individuale, që zakonisht për djegie përdoret druri e më pak thëngjilli, nafta e gazi.

III.4. ZHVILLIMI DEMOGRAFIK I QYTETIT

III.4.1. Numri i popullsisë

Në qytetin e Shtimes jetojnë rreth 9100 banorë⁴. Dihet se të dhënat për popullsinë mungojnë jo vetëm për qytetin e Shtimes, por edhe në nivel të Kosovës. Regjistrimi i fundit për popullsinë në Kosovë është realizuar në vitin 1981 dhe pas këtij viti janë bërë vetëm vlerësime.

Vlerësimi i numrit të popullsisë në qytetin e Shtimes është bërë nga Kuvendi komunal në bashkëpunim me kompaninë DATA Gis Consulting dhe është mbështetur në disa metoda. Për vlerësimet dhe analizat demografike të qytetit të Shtimes janë shfrytëzuar të dhënat e vitit 1991, të dhënat nga vlerësimi i UNHCER-it të vitit 1998, pastaj të dhënat nga orto-fotot duke e identifikuar numrin e objekteve të banimit, si dhe, gjatë intervistave me qytetarët. Literaturë tjetër që është shfrytëzuar gjatë këtyre analizave janë edhe hulumtimet e ndryshme, që janë realizuar nga Enti i Statistikës së Kosovës (ESK).

Që nga viti 1948, e deri më sot, qyteti i Shtimes, ka pasur një rritje të vazhdueshme të popullsisë. Në vitin 1948 Shtimja kishte 2003 banorë, ndërsa në vitin 2008 ajo vlerësohet ti ketë rreth 9100 banorë, që do të thotë se për këtë periudhë kohore (60 vjeçare) numri i popullsisë është rritur më tepër se tri herë.

Numri i popullsisë në qytetin e Shtimes ka shënuar një rritje të konsiderueshme me rreth 7097 banorë prej vitit 1948 deri në vitin 2008. Pra, në bazë të kësaj rritje del se mesatarisht popullsia ka shënuar rritje prej rreth 118 banorë në vit. Brenda periudhë kohore 60 vjeçare.

⁴ Vlerësim i numrit të popullsisë për komunën e Shtimes për vitin 2008, nga Kuvendi komunal në bashkëpunim me kompaninë DataGISConsulting.

Tabela 4. Zhvillimi demografik i Shtimes deri sot

Viti	shtëpi	banorë	Anëtar për ekonomi familjare
1455	109		
Shek. XIX	100		
1905	97		
1913		1232	
1921	153	1071	
1948	346	2003	5.8
1953		2292	5.8
1961	490	2832	5.8
1971	612	3866	6.3
1981	825	5271	6.4
1991		6657 (vlerësim)	
2008	1500	9100	6.1


Sipas të dhënave nga tabela, vërehet se, deri në vitet e 60-ta, qyteti i Shtimes ka shënuar rritje demografike, por shkallët e kësaj rritje kanë qenë më të vogla, për faktin se kishte shkallë të lartë të natalitetit dhe mortalitetit, ku si pasojë, kishte shtim të ulët natyror. Pas viteve të 60-ta gjegjësisht viteve të 70-ta, kemi një rritje më të theksuar të popullsisë, si pasojë e zvogëlimit të shkallëve të mortalitetit dhe, në anën tjetër, shkalla e natalitetit mbetet ende e lartë, ku si pasojë kemi shkallë më të lartë të shtimit natyror. Rritje më e theksuar demografike e popullsisë vërehet në periudhën kohore 1971 – 1981. Mes viteve 1991 dhe 2008 është rritja më e theksuar por në fakt përfshihet edhe një periudhë më e gjatë kohore rreth 20 vjeçare. Gjithashtu rritje të konsiderueshme ka pasur edhe gjatë periudhës 1981 – 1991. Pas përfundimit të luftës të vitit 1999, ekziston një rritje më e theksuar në krahasim me periudhën e pas Luftës.

III.4.2. Shtimi natyror i popullsisë

Veçori themelore e popullsisë së qytetit të Shtimes, është se shtimi natyror në tërë periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore ishte faktor primar i rritjes së përgjithshme të numrit të popullsisë. Në periudhën e pasluftës, krahas shkallës së lartë të natalitetit edhe mortaliteti ishte mjaft i lartë për shkak të mortalitetit të lartë infantil, si rezultat i nivelit të ulët të zhvillimit social e mjekësor. Gjatë periudhës 1971 – 1981, krahas rënies së natalitetit, bie dukshëm edhe mortaliteti, e me këtë zvogëlohet edhe shtimi natyror i popullsisë. Përkundër zvogëlimit, shkalla e natalitetit mbetet ende shumë e lartë (rreth 30 promil), ndërsa rënia rapide e mortalitetit ndikojë, që shtimi natyror dhe rritja e përgjithshme e popullsisë në qytetin e Shtimes të mbetet e lartë. Kjo periudhë gjithashtu është edhe periudha, kur popullsia e Shtimes kishte rritje më të lartë të popullsisë. Dhe, një rritje e tillë ka ndikuar në krijimin e një popullate me moshë të re, që i takon tipit ekspansiv të strukturës së popullsisë sipas moshës. Pas viteve të 90-ta, ndodh një thyerje e madhe lidhur me natalitetin, kur shkalla e tij zbret deri në rreth 20 promil në vitet 1995

– 1996, ndërsa shtimi natyror rreth 16 promil. Kjo thyerje ndodh si pasojë e rrethanave të vështira socio-ekonomike dhe politike që ishin krijuar.

Të dhënat e shtimit natyror për vitin 2006, janë vlerësuar, duke i shfrytëzuar të dhënat për lindjet dhe vdekjet nga Enti i Statistikës së Kosovës për vitin 2006 në tërë Kosovën, njëkohësisht edhe për komunat. Këto të dhëna janë shndërruar në promil dhe janë dhënë shkallët e natalitetit, mortalitetit dhe shtimit natyror.



Grafiku 1. Shtimi natyror në promil për vitin 2006 në Shtimes

Siç shihet edhe nga Grafiku, shkalla e natalitetit në qytetin e Shtimes është afër 20 promil apo 2 %. Shkalla e mortalitetit është 3.8 promil apo 0.38 %. Në bazë të këtyre shkalleve të natalitetit dhe mortalitetit del se shtimi natyror i popullsisë në qytetin e Shtimes është 16.2 promil apo 1.62 %.


III.4.3. Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë

Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe për zhvillimin demografik dhe ekonomik të një vendi, si për të tanishmen ashtu edhe për të ardhmen. Nga kjo strukturë rrjedhin kontingjentet kyçe të popullsisë, që kanë ndikim në zhvillimin demografik dhe socio-ekonomik të një popullate. Në aspektin demografik kjo strukturë ka rëndësi për riprodhimin biologjik, sepse krijohet kontingjenti fertil. Ndërsa në aspektin socio-ekonomik, ndikon në krijimin e kontingjentit të punës. Struktura e popullsisë sipas gjinisë dhe moshës ka rëndësi edhe për strukturat tjera demografike, për faktin se, strukturat e popullsisë sipas veçorive të ndryshme socio-ekonomike (sipas aktivitetit, veprimtarisë, profesionit, arsimit etj.) hulumtohen njëkohësisht edhe sipas gjinisë dhe moshës.

Qyteti i Shtimes në aspektin e zhvillimit demografik ka veçoritë e saj edhe në përbërjen e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë. Në këto struktura kanë ndikuar shumë faktorë demografik dhe socio-ekonomik dhe janë krijuar shumë karakteristika dhe efekte të tjera sasiore dhe cilësore në zhvillimin demografik. Qyteti i Shtimes ka popullsi kryesisht të


re dhe, me bazë të zgjeruar të piramidës, sipas moshës edhe pse, në periudhat e fundit kohore, vërehen disa tendenca me ndryshime të vogla në zvogëlimin e grup-moshave të reja. Struktura gjinore e popullsisë, po ashtu është karakteristike, me dominim të popullsisë mashkullore dhe, me ndryshime të theksuara të koeficientit të maskulinitetit sipas grup-moshave.

Deri në vitet e 90-ta, në qytetin e Shtimes ka dominuar plotësisht tipi progresiv i popullsisë, ku shkalla e lartë e natalitetit dhe rëniet e vazhdueshme të mortalitetit kanë ndikuar drejtpërdrejt në krijimin e këtij tipi të popullsisë. Ndryshimi i rrethanave socio-ekonomike dhe politike pas viteve të 90-ta, kanë ndikuar në zhvillimin e përgjithshëm demografik të qytetit, njëherit edhe ndryshime në strukturën e popullsisë sipas moshës. Pothuaj gjatë gjithë pjesës së dytë të shekullit të kaluar, piramida e popullsisë në qytetin e Shtimes kishte bazë të zgjeruar me dominimin e grup-moshave 0 deri 4 vjeç. Gjatë analizës së të dhënave demografike për vitin 2004, kur qyteti i Shtimes ka bërë edhe regjistrimin e moshës së banoreve, vërehen ndryshime në strukturën e popullsisë. Këto ndryshime mund t'i dallojmë më çartë, përmes piramidës së popullsisë.




Grafiku 2. Piramida e popullsisë së qytetit të Shtimes në vitin 2004

Në vitin 2004, forma e piramidës ndryshon duke u ngushtuar baza e saj dhe kjo si pasojë e dy faktorëve: migrimeve dhe të tendencave të zvogëlimit të natalitetit. Nga piramida e popullsisë vërehet se grup-moshat e reja 0 deri 4 dhe ato 5 deri 9 vjeç, te gjinia mashkullore kanë pjesëmarrje më të vogël në popullsinë e përgjithshme në krahasim me grup-moshën 10 deri 14 vjeç. Te gjinia femërore vërehet një dallim ku pjesëmarrje më të madhe kanë grup-moshat 0 deri 4 vjeç. Në përgjithësi grup-moshat e reja të popullsisë (0 deri 19 vjeç) dominojnë dukshëm në popullatën e përgjithshme të komunës edhe ky është një indikator mjaft i rëndësishëm, që tregon se në të ardhmen do të ketë natalitet të lartë, nga fakti se këto grup-mosha në të ardhmen japin një përqindje të konsiderueshme të popullsisë fertile që konsiderohet si burim i lindshmërisë.



Grafiku 3. Tri grup-moshat e popullsisë të qytetit Shtimes

Mbi 40 % të popullsisë së përgjithshme janë me moshë të re 0 deri 19 vjeç. Ndërsa, grup-moshat mbi 65 vjeç kanë pjesëmarrje të vogël, rreth 4 % të popullsisë së përgjithshme.



Grafiku 4. Përqindja e popullsisë sipas gjinisë në qytetin e Shtimes

Struktura gjinore e popullsisë në Qytetin e Shtimes ka karakteristikat e veta me dominim jo të madh të gjinisë mashkullore. Koeficienti i maskulinitetit është rreth 1066, që do të thotë se mesatarisht ekzistojnë 1066 meshkuj në çdo 1000 femra.

Siç shihet edhe nga grafiku, ekziston një debalanc i vogël gjinor, në popullsinë e qytetit të Shtimes, ku popullsia mashkullore dominon me 51.6 %, në krahasim, me popullsinë femërore që ka 48.4 % të popullsisë së gjithmbarshme.

Struktura e krijuar e moshës dhe gjinisë dhe, ndryshimet e tyre gjatë kohës, kanë krijuar efekte të reja socio-ekonomike dhe demografike. Këto dy struktura kanë ndikuar në krijimin e kontingjenteve të rëndësishme siç janë: Kontingjenti i punës, fertil, shkollor, i moshuar etj.

Tabela 5. Kontingjentet më të rëndësishëm të strukturës së moshës dhe gjinisë në %⁵

Kontingjentet e rëndësishëm	Përqindja
Kontingjenti parashkollor dhe me shkollim të obligueshëm (0-14 vjet)	32,3 %
Popullsia fertile femërore (15-49 vjet)	26,7 %
Kontingjenti i punës (15-64/m dhe 15-59/f)	62,3 %
Kontingjenti i moshuar (mbi 65 vjet)	4,3 %

Kontingjentet e popullsisë janë në varësi reciproke në mes strukturës së popullsisë sipas moshës e gjinisë dhe proceseve tjera demografike e socio-ekonomike. Analiza dhe vlerësimi afatgjatë i këtyre kontingjenteve ka rëndësi të shumëfishtë, por para se gjithash, për planifikim në sfera të ndryshme të organizimit shoqëror dhe ekonomik. Ato reflektojnë efekte në planifikimin afatgjatë kohorë siç janë punësimi, shkollimi dhe entet parashkollore, mbrojtja shëndetësore etj.

III.4.4. Familja dhe karakteristikat e saj


Një ndër karakteristikat e veçanta të zhvillimit demografik dhe shoqëror të Kosovës janë edhe numri, madhësia mesatare dhe përbërja e ekonomive familjare, të cilat janë të kushtëzuara nga ndikimi i faktorëve ekonomik, social, demografik etj.⁶

Qyteti i Shtimes kryesisht karakterizohet me numër të madh të anëtareve të familjes, që është karakteristikë për disa vise të pa zhvilluara dhe kryesisht rurale.

Në përgjithësi në qytetin e Shtimes dominojnë familjet me nga 7 anëtar si dhe ato me nga 6 dhe 5 anëtar. Gjithashtu kemi edhe numër të konsiderueshëm të familjeve që kanë 8 e më shumë anëtar. Ndërsa, familje që kanë 1, 2 dhe 3 anëtar janë shumë pak, që janë rreth 5 % e të gjitha familjeve në komunë.

⁵ Përqindjet janë llogarit bazuar në regjistrimin e vitit 2004 të realizuar nga Kuvendi Komunal i Shtimes

⁶ Hivzi Islami, Studime Demografike, 100 vjet të zhvillimit demografik të Kosovës, Prishtinë 2008.



Grafiku 5. Përqindja e familjeve sipas numrit të anëtareve

Pjesëmarrja e vogël e ekonomive familjare me 1 - 3 anëtar është një dëshmi se, me gjithë transformimet socio-ekonomike dhe të tjera, proceset e modernizimit të shoqërisë në qytetin e Shtimes nuk kanë qenë të fuqishme për të kushtëzuar ndryshime rrënjësore në përbërjen e ekonomive familjare përmes shthurjes së ekonomive të zgjeruara tradicionale familjare në të ashtuquajtura familje nukleare, siç ka ndodhur në vendet e tjera të zhvilluara.

III.4.5.. Lëvizja mekanike e popullsisë - Migrimet

Migrimet e popullsisë sot paraqesin një problem shumë dimensional hapësinor, demografik, ekonomik, social dhe politik, ndërsa i nxisin një varg faktorësh të ndërlikuar dhe shpeshherë reciprokisht të lidhur e të kushtëzuar⁷

Mungesa e të dhënave demografike në përgjithësi dhe për migrimet në veçanti, vështirëson punën dhe arritjen deri te rezultatet e sakta mbi migrimet në qytetin e Shtimes. Megjithatë, regjistrimi i popullsisë që është realizuar nga kuvendi komunal i Shtimes në vitin 2004, na mundëson që të analizohen edhe migrimet e sidomos në nxjerrjen e disa vlerave relative. Gjatë këtij regjistrimi janë mbledhur edhe të dhëna për numrin e emigranteve në botën e jashtme edhe pse ato nuk janë të plota për faktin se nuk kanë mundur të regjistrohen të gjithë këta emigrant, si dhe të dhëna për numrin e migrameve definitive. Përmes këtyre të dhënave dhe transformimit të tyre në vlera relative, kemi arritur në konstatime të përafërta mbi migrimet në qytetin e Shtimes.

Gjatë këtij regjistrimi janë nxjerr edhe të dhënat për migrimet e jashtme dhe ato definitive që janë paraqitur në tabelën e më poshtme.

Tabela 6. Migrimet në komunën e Shtimes (Migrimet në botën e jashtme dhe ato definitive)⁸

Tipi vendbanimit	Nr. banorëve	Nr.emigrantëve	%	Nr.migrameve	%
------------------	--------------	----------------	---	--------------	---

⁷Hivzi Islami, Studime Demografike, 100 vjet të zhvillimit demografik të Kosovës, Prishtinë 2008. fq. 255.

⁸ Regjistrimi i popullsisë në komunën e Shtimes, nga KK Shtime 2004.

				definitive	
Qytet	6640	698	10.5	78	1.17

Numri më i madh i emigranteve është nga zona rurale (nga fshatrat e komunës së Shtimes), në krahasim me zonën urbane (qytetin e Shtimes). Në qytetin e Shtimes janë evidentuar 698 emigrant apo 10.5 % e popullsisë së përgjithshme të qytetit. Natyrshëm numri dhe përqindja e emigranteve është më e madhe në fshatra se në qytet nga fakti se banoret në qytet kanë mundësi më të mira për punësim dhe kushte më të mira të jetesës. Në qytet janë evidentuar si të ardhur 78 persona gjatë vitit 2004 që përfshinë rreth + 1.17 % të popullsisë së përgjithshme të qytetit, dhe kjo tregon se qendra komunale ka saldo pozitive migruese. Nga kjo vërehet se banoret nga viset rurale shpërngulen kryesisht në qytetin e Shtimes, dhe për këtë arsye fshatrat kanë saldo negative migruese ndërsa qyteti ka saldo pozitive migruese.

III.6. SHFRYTËZIMI I TOKËS NË QYTETIN E SHTIMES

Duke u bazuar nga hulumtimet në terren, përdorimit të ortofotove dhe hartave tjera, përmes të cilave shprehen karakteristikat e mjedisit, konstatohet se një pjesë të konsiderueshme të komunës kadastrale të Shtimes e përbëjnë sipërfaqet e rrafshëta të tokave që i takojnë klasit të lartë të bonitetit. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre sipërfaqeve është mbuluar nga ndërtimet e objekteve të ndryshme. Pjesa më e madhe e hapësirës urbane shtrihet në drejtim të rrugëve kryesore që lidhin qendrat e rëndësishme të Kosovës, pranë të cilave shihet perspektiva dhe lidhjet më të shpejta me këto qendra. Funksionet e shërbimeve të ndryshme shtrihen pranë këtyre rrugëve kryesore, e sidomos pranë qendrës ku takohen këto vija komunikative. Banimi është i ulët, kurse sipërfaqja e zonave industriale është e vogël. Në anën perëndimore shtrihen sipërfaqe të gjelbra të pyjeve. Në drejtim të lindjes rrjedh lumi i Shtimes, që i japin të gjitha këto një vlerë këtij vendbanimi.

Në nivel të komunës kadastrale të Shtimes shfrytëzimi i sipërfaqeve ka këtë strukturë; sipërfaqet e banimit, institucionet publike, sipërfaqet e transportit, objektet religjioze, bizneset dhe sipërfaqet e veçanta, sipërfaqet e gjelbra, etj.

Hapësira e ndërtuar e Shtimes dhe sipërfaqet tjera (të veçanta dhe infrastrukturë) përfshin sipërfaqen prej 199.3 ha, kryesisht e ndërtuar në tokë bujqësore të kategorisë së dytë dhe tretë. Në tri dekadat e fundit hapësira e kompleksit ndërtimor u zgjerua nga 56 ha, sa ishte në vitin 1974, në 199.3 ha në vitin 2004.

Sipërfaqet e ndërtuara përfshin 180.1 hektar, nga e cila sipërfaqe pjesa më e madhe i takon funksionit të banimit, me 155 hektar. Industria, depot dhe bizneset përfshin 12.74 hektar, ndërsa hapësirat me përmbajtje publike dhe institucione administrative, sociale, etj. janë 8.76 hektar, sipërfaqet e mbuluara nga trafiku janë 13.56 hektar, sipërfaqet ujore 2.9 hektar, ndërsa sipërfaqet e veçanta ose specifike janë 5.62 hektar.


Nga sipërfaqja e përgjithshme e komunës kadastrale të Shtimes prej 1282 ha, 15.5 % është sipërfaqe e ndërtuar dhe sipërfaqe për aktivitete tjera urbane, ndërsa 84.5 % janë sipërfaqe të gjelbra; sipërfaqe bujqësore, pyje, etj. Sipërfaqe të rregulluara, gjelbëruara në

vendbanimin e Shtimes ka shumë pak, vetëm 832 m², të cilat shtrihen përgjatë brigjeve të lumit Shtimjanja.

Tabela 7. Bilanci i sipërfaqeve ekzistuese sipas mënyrës së përdorimit në kuadër të komunës kadastrale të Shtimes

Përshkrimi	Njësia	%
Banimi	155 ha	77.8
Institucionet edukative arsimore	2.55	1.3
Institucionet kulturore (qendra kulturore, biblioteka, sport, rekreacion	1.73	0.87
Objektet shëndetësore	5.66	2.8
Shërbime administrative (k. komunal dhe qeverisja lokale)	0.42	0.2
Shërbime tjera publike (zjarrfikësit, policia, posta, banka, etj)	0.90	0.45
Biznese, industri, depo	12.74	6.4
Objekte religjioze	1.07	0.5
Gjithsej sipërfaqe e ndërtuar	180.1	90.36
Tregu i gjelbër	0.50	0.25
Varreza	3.72	1.86
Pikë karburanti	0.88	0.44
Trafostacion	0.52	0.26
Gjithsej sipërfaqe me destinim të veçantë	5.62	2.8
Korridore transporti	12.89	6.5
Parking	0.67	0.3
Gjithsej sipërfaqe transporti	13.56	6.8
Gjithsej sipërfaqe e kompleksit ndërtimor në raport me k. Kadastrale	199.3	15.5
Sipërfaqe bujqësore	859.6	79.4
Sipërfaqe nën pyje	36.4	3.4
Zonat e lira të parregulluara	183.8	16.97
Lum	2.9	0.3
Gjithsej sipërfaqe e gjelbër	1082.7	84.5
Sipërfaqja e përgjithshme e komunës kadastrale	1282	100.0

Shtimja në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore, por edhe deri sot, u zhvillua në mënyrë të paplanifikuar dhe me disa kondita edhe në mënyrë stihike. Kjo në radhë të parë ishte si pasojë e statusit që e kishte deri vonë (vendbanim rural), ndërsa nga kjo arsye mungonin edhe planet dhe programet që duhet t'i ketë një qendër komunale. Varësia politike, ekonomike dhe administrative e Shtimes nga qendra urbane e Ferizajit, deri në vitin 1988 ishte vetëm një qendër rurale në kuadër të kësaj komune, u reflektua negativisht në zhvillimin e funksioneve urbane të saj. Të gjitha kërkesat dhe nevojat e qytetarëve të Shtimes duhej të realizoheshin në qendrën më të afërt, por edhe më larg.

Harta 3. Shfrytëzimi i tokës në zonën urbane

III.7. BANIMI NË QYTETIN E SHTIMES

Banimi, si një nga pesë funksionet themelore të njeriut, është funksion i rëndësishëm i individit dhe familjes, ka rëndësi të madhe për shoqërinë në përgjithësi. Madje edhe gjendja shëndetësore e popullsisë qëndron në korrelacion të ngushtë me cilësinë e kushteve të banimit. Mënyra e banimit është masë e zhvillimit ekonomik, të mirave materiale dhe nivelit kulturor të shoqërisë njerëzore.⁹

Tabela 8. Territori i analizuar në hektar

Vendbanimi	Sipërfaqja e komunës kadastrale	Sipërfaqja e hapësirës së ndërtuar	Kompleksi i zonës së banimit
Shtime	1282 ha	180.1 ha 14.0 %	155 ha 86.06 %

Nga tabela shihet se sipërfaqja e përgjithshme e hapësirës së ndërtuar është 180.1 hektar, ose 14.0 % e komunës kadastrale, ndërsa kompleksit të banimit i takojnë 155 hektar, ose 86.06 % të sipërfaqes së ndërtuar. Sipërfaqet tjera janë të destinuara për funksionet qendrore dhe infrastrukturë tjetër përcjellëse.

Banimi në tërësi është i karakterit individual, me parcela relativisht të mëdha për zonat urbane dhe në të shumtën e rasteve të rrethuara me mure të larta.

Karakteristikë e ndërtimit individual të banimit në Shtime është:

- ✓ ndërtimi stihik dhe pa plan (në masë të konsiderueshme)
- ✓ dendësia e vogël e banimit për 58.7 b/ha, (është llogaritur vetëm për zonën e banimit)
- ✓ sipërfaqja e banimit për anëtar (21.9 m²/banorë)
- ✓ pjesëmarrja e konsiderueshme e objekteve me material të dobët

Zhvillimi i Shtimes në gjysmë e dytë të shekullit XX, karakterizohet me rritje të shpejtë demografike, ndryshime në strukturën shoqërore-ekonomike dhe hapësinore, por pa ndonjë planifikim të mirëfilltë. Ndryshimet gjatë kësaj periudhe mund të vërtetohen me këto parametra:

- ✓ Popullsia në hapësirën urbane të Shtimes u rrit nga 2003 banorë, sa ishte në vitin 1948, në 9100 banorë në vitin 2008, ose 4.5 herë.
- ✓ Sipërfaqja e territorit urban, në periudhën 30 vjeçare u zgjerua për rreth 4 herë.

Në kuptimin hapësinor pjesa e konsiderueshme e qytetit u zhvillua në mënyrë të pakontrolluar dhe pa infrastrukturë përcjellëse, për jetë normale.

Të dhënat demografike dhe urbanistike tregojnë se:

- ✓ numri mesatar i anëtarëve në ekonomi familjare është 6.1 anëtarë,
- ✓ sipërfaqja mesatare e banesave është 133 m²,
- ✓ sipërfaqja e shfrytëzuar e banesave është në 17.6 m²/banorë,

⁹ .M. Vresk; Osnovi Urbane Geografije, Skolska knjiga, Zagreb, 1980, f.26.

- ✓ dendësia mesatare e banimit është 58.7 b/ha, sistemi i infrastrukturës urbane nuk është i kompletuar dhe në nivelin e duhur.

Numri i banesave dhe sipërfaqja banesore është nxjerrë nga regjistrimet e popullsisë deri në vitin 1981. Pas këtij viti të dhënat janë marrë nga grupet punuese të planit të Shtimes.. Sipas regjistrimeve të fundit, në qytetin e Shtimes kanë dalë këto rezultate:¹⁰

Tabela 9. Fondi i banesave dhe sipërfaqet banesore

Viti	Banesat			Sipërfaqja
	Numri	Indeksi	m ²	Indeksi
1971	570	100.0	28 187	100.0
1981	846	148.4	61 742	219.0
2004	1500	177.3	200 071	324.0

Nga regjistrimet shihet se numri i banesave në vitin 1981, në raport me regjistrimin e më hershëm u rrit për 48 %, kurse sipërfaqja banesore u rrit për 119.0 %. Nga të dhënat e fundit numri i banesave u rrit për 77 %. Kjo rritje e ndërtimit ndikoi pozitivisht në përmirësimin e kushteve të banimit.

Tabela 10. Madhësia dhe sipërfaqja mesatare e banimit për anëtar

	VITET		
	1971	1981	2004
Madhësia mesatare e banesave m ²	49.5	73.0	133.4
Sipërfaqja mesatare e banimit për anëtar	7.5	11.9	21.8
Numri mesatar i anëtarëve për një banesë	6.5	6.1	6.1


Në vitin 1981 sipërfaqja banesore për banorë ishte diçka më e mirë se mesatarja e nivelit të Kosovës (10.1 m²) me vlerën prej 11.9 m², kohët e fundit dukshëm ndryshoi edhe struktura sipas madhësisë së banesave. Kjo ndodhi si rezultat i ndërtimit të objekteve të banimit me dimensione më të mëdha. Sa i përket vjetërsisë së banesave, rreth 90% u ndërtua pas luftës së dytë botërore dhe një numër i konsiderueshëm u ndërtua pas luftës së fundit, të vitit 1999, kurse nga kjo mund të konstatohet se fondi i banesave është relativisht i ri. Funksioni i banimit zë rreth 80 % të sipërfaqes së vendbanimit. Parcelat që shfrytëzohen për banim kanë forma të parregullta, ndërsa madhësia e sipërfaqes së tyre sillet rreth 600 m². Në shumë raste, afër objektit të banimi janë prezentë edhe objektet tjera ekonomike, si: garazhe, hambarë, etj. Kohët e fundit objektet e banimit janë ndërtuar nga materiali i fortë: tulla, beton, hekur.

¹⁰ Regjistrimi i popullsisë , ekonomive familjare dhe banesave, 1971 dhe 1981. Prishtinë, ndërsa të dhënat për vitin 2008 janë siguruar nga K. Komunal i Shtimes.

Tabela 11. Treguesit urbanistik të gjendjes ekzistuese

Sipërfaqja e zonës së banimit	155 ha
Numri i popullsisë	9100 banorë
Numri mesatar i anëtarëve në ekonomi familjare	6.1 anëtarë
Dendësia neto e banimit	58.7 b/ha
Dendësia bruto e banimit	45.6 b/ha
Koeficienti bruto i ndërrueshmërisë	0.120
Koeficienti i shfrytëzueshmërisë së tokës	8.3
Sipërfaqja e shfrytëzuar banesore për banorë	17.6 m ² / ban
Sipërfaqja e përgjithshme e banuar	200 071 m ²
Numri i objekteve banesore	1500


Harta 4. Zgjerimi i zonës së ndërtuar sipas viteve



III.8. VENDBANIMET JOFORMALE

Institucionet komunale, në bashkëpunim me ekipin për përpilimin e planit zhvillimor komunal kanë identifikuar vendbanime joformale që duhet trajtuar urgjent. Lokacioni i parë i vendbanimit joformal gjendet në afërsi të Pishave, në anën e djathtë, derisa lokacioni i dytë shtrihet në komunën katastrale të Belincit, përkatësisht në lokacionin e ish gurthyesit. Ky lokacion, përveçse është joformal, paraqet rrezik për banorët. Ndërsa lokacioni tjetër shtrihet në toka bujqësore të cilësisë së lartë, mes rrugës qarkore dhe rrugës magjistrale Prishtinë-Shtime-Prizren.

Harta 5. Vendbanimet jo formale



III.9. TRASHËGIMIA KULTURORE

Trashëgimia kulturore e qytetit përmban pasuri vlerash shpirtërore e materiale, me ngjarje e shkatërrime tragjike edhe të këtyre vlerave që nga antika e deri sot. Sipas të dhënave dhe zbulimeve historike e arkeologjike edhe qyteti i Shtimes, pjesë e Dardanisë antike, është tejet e pasur me vlera materiale autoktone. Nëpër këtë territor kalonin rrugë të rëndësishme ilire-romake. Zbulime arkeologjike janë gjetur në disa lokalitete afër qytetit të Shtimes.

Numri i monumenteve në këtë qendër, sipas të dhënave të Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës dhe të dhënave plotësuese nga institucionet komunale, janë evidentuar këto monumente:

Duhet theksuar se shumë monumente antike mendohet se janë zhdukur plotësisht dhe në të shumtën e rasteve dalin vetëm në toponiminë e kësaj treve, ndërkohë që objektet e vjetra, për arsye të rrethanave historike, në pamundësi të kujdesit institucional, vazhdojnë të humbin gjurmët ose të dëmtohen shumë.

Kuvendi komunal në bazë të hulumtimeve të bëra në terren duhet të marr masa për mbrojtje institucionale me qëllim të ruajtjes dhe restaurimit të këtyre objekteve që kanë vlera të trashëgimisë kulturore për qytetin e Shtimes

Tabela 12. Monumentet e trashëgimisë kulturore

Vendbanimi	Lokalitet arkeologjik ,Lokalitete te vjetra ,monumente te vjetra	Varreza arkeologjike	Objekt fetar
Shtimja	Gjurmë arkeologjike „Te lajthijat“		

Vendi	Emri	Viti ndërtimit	Destinimi	Gjendja	sipërfaqja
Shtime	-Xhamia e vjetër -Varri i Ahmet Sylejmanit - Shtimja	1824 1923	Objekt fetar Varr i kryetarit të parë shqiptar në K. Shtimes	E mirë Restaurim	x
Shtime	Kulla e Agush Agës	1890	Shfrytëzohet nga shoqatat e dala nga lufta	Nevojë restaurimi	Dy kate, 8 dhoma
Shtime	Tyrbja e Shtimes	x	Objekt fetar	Nevojë restaurim	X
Shtime	Kulla e Muhamet Begut	Fund shek XIX	Dikur objekt banimi	Nevojë urgjente restaurimi	Objekti 100m ² Oborri 35 ha
Shtime	Shtëpia e Përshpirtshme	Fillimi i shek XX	Inkubator biznesi, qendër rinore	X	822 m ²
Shtime	Shtëpia e Mulla Hysenve dhe Mulla Sylëve	Fillimi i shek XX	Objekt banimi	Nevojë urgjente restaurimi	X
Shtime	Kroi i vjetër	X	Furnizim me ujë	Nevojë urgjente restaurimi	X

Shtime	-Kisha ortodokse	1923	X	X	X
Shtime	Shkolla e parë në Shtime	1920	X	X	520 m ²
Shtime	Rezervuari i parë i ujësjellësit	1932	x	x	X
Shtime	Kroi i vjetër	x	x	x	x

HISTORIA E RE



Foto nga terreni

Në Fshatin Reçak është në ndërtim e sipër Kompleksi Përkujtimor i Masakrës së Reçakut.

III.10. ZHVILLIMI EKONOMIK I QYTETIT TË SHTIMES

III.10.1. Bujqësia

Bujqësia është një ndër degët bazë të ekonomisë, dhe si e tillë luan rrol të rëndësishëm në zhvillimin e një regjioni apo komune. Komuna e Shtimes gjendet në pjesën qendrore të Kosovës, apo në pjesën jug perëndimore të Fushëgropës së Kosovës. Territori i komunës së Shtimes ka një sipërfaqe prej 134 km² (13,450.8 hektarë), gjegjësisht, 1,2 % të territorit të Kosovës¹¹. Afër 48,4 % e territorit të komunës është tokë bujqësore, që d.m.th gati gjysma e territorit komunal është tokë buke.

Gjatë analizimit të disa indikatorëve si pjerrtësinë e terrenit, ekspozicionin e terrenit, bonitetin e tokave, shtrirjen e vendbanimeve dhe popullsisë, komuna e Shtimes karakterizohet me tri zona bujqësore, si zona kryesisht agrare, zona agraro blegtorale-pylltare dhe zona blegtoralo-pylltare¹².

Zona kryesisht agrare - karakterizohet kryesisht me terren të rrafshët, me toka të klasave të bonitetit prej II-V, me koncentrim të madh të popullsisë. Kjo zonë definohet edhe si zonë me potencial të zhvillimit të lavërtarisë, perimtarisë dhe blegtorisë intensive.

Shtimja është vendbanimi në komunën e Shtimes me numrin më të madh të kafshëve blegtorale, me pjesëmarrje 8.5% ose 472 krerë të përgjithshëm të fondit blegtoral. Prej tyre janë 394 gjedhe, 53 dele, 10 dhi dhe 15 kuaj.

Konkludohet që ngjarjet që ndodhën në fund të viteve të 90-ta ishin fatale për bujqësinë dhe ekonominë në përgjithësi në komunën e Shtimes duke e prekur drejtpërdrejt ekonominë familjare.

Shkalla e parcelizimit është mjaft e theksuar në komunën e Shtimes dhe nuk ndryshon fare në raport me situatën e përgjithshme në Kosovë. Mesatarja e madhësisë së parcelës në komunën e Shtimes është 0.62 ha. Në qytetin e Shtimes dominojnë kryesisht parcelat e madhësisë 0-05ha dhe përbëjnë 84% të numrit të përgjithshëm të parcelave. Kurse ato të madhësisë 0.5-1.0ha përbëjnë 12% të numrit të përgjithshëm të parcelave dhe vetëm 4% të parcelave janë të madhësisë mbi 1.0ha. kjo tregon që për çdo intervenim urbanistike duhet konsultuar me numër të madh pronarësh.


III.10.2. Transporti

Transporti në veçanti dhe komunikacioni në tërësi është parakusht për zhvillimin ekonomik dhe social të një territori. Komuna e Shtimes karakterizohet vetëm me transport rrugor i cili përshkohet prej dy rrugëve magjistrale dhe dy rrugëve regjionale si dhe rrugë të tjera lokale,

¹¹ Plani strategjik zhvillimor afatmesëm për komunën e Shtimes, faqe 3.

¹² Analizë në GIS.

Rrugët magjistrale janë rruga Prishtinë-Prizren (M25) dhe rruga Shtime-Ferizaj (M25.3), kurse rrugët regjionale janë rruga Carralevë-Komoran (R102) dhe rruga Gjurkocv-Koshare (R207)¹³. Përgjatë këtyre akseve rrugore zhvillohet transporti ndër-urban dhe kryesisht është i mbuluar nga kompanitë regjionale të transportit publik si të, Prishtinës, Prizrenit dhe Ferizajt, si dhe kompani të tjera lokale. Qyteti i Shtimes edhe pse është kryeqendër komunale nuk ka stacion të autobusëve.



Grafiku 6. Gjatësia e rrugëve në territorin e qytetit të Shtimes¹⁴

Nga Grafiku kuptohet që, nga të gjitha rrugët që shtrihen në territorin e komunës së Shtimes 66.32% e tyre janë rrugë lokale dhe rrugë sekondare të qytetit, që d.m.th se të gjitha këto rrugë me gjatësi prej 66.2 km janë nën menaxhimin e qeverisë lokale të Shtimes. Kjo gjendje është barrë e madhe e qeverisë lokale të Shtimes. Qyteti i Shtimes nuk disponon me transport urban, arsye e mungesës së transportit urban shpjegohet me faktin që prej qendrës së qytetit, gati i gjithë qyteti mbulohet me një rreze prej 1000m.

III.10.3. Tregtia

Nga të gjitha veprimtaritë ekonomike që janë aktive në komunën e Shtimes, tregtia zë vendin kryesor për nga numri i ndërmarrjeve, me një pjesëmarrje prej 47.37% dhe me 226 biznese të regjistruara. Një orientim i tillë i biznesit kryesisht është kushtëzuar nga norma mesatare e

¹³ MTPT

¹⁴ MTPT (GIS) dhe Plani strategjik zhvillimor afatmesëm për komunën e Shtimes, faqe 30

investimeve për një biznes, mundësia e kontrollimit më të lehtë të kapitalit sipas qasjes direkte, tradita, etj¹⁵.

Sa i përket shpërndarjes së bizneseve në vendbanimet e komunës së Shtimes, mundë të themi që qendra më atraktive e vendosjes së tyre është kryeqendra komunale, qyteti i Shtimes me një pjesëmarrje prej 75,70% ndaj numrit të përgjithshëm të bizneseve. Arsye e koncentritimit të bizneseve në qytetin e Shtimes është për faktin që në këtë qytet ekziston e gjithë infrastruktura adekuate për funksionimin e një biznesi, duke përfshi; shërbimet bankare, administratën, transportin, frekuentimi shumëdimensional, koncentrimi më i madh i popullatës, fuqi punëtore e kualifikuar etj. Me të tjera fjalë, nëse do ta kishim këtë lloj të infrastrukturës edhe në vendbanime të tjera, koncentrimi i bizneseve do të ishte më i balancuar dhe më i shpërndarë.

Nga analizat e bëra kuptohet që përqendrimi më i madh i bizneseve është përgjatë akseve rrugore magjistrale dhe regjionale, fakt i cili është i kushtëzuar nga gjendja e mirë e rrugëve, transportit, përqendrimit dhe qarkullimit të popullatës. Vetëm në vendbanimet si Shtime, Carralevë, Davidovc, Gjurovc dhe Muzeqinë janë të përqendruara rreth 82.3% e bizneseve tregtare dhe 85% e të punësuarve në tregti, ndërsa vetëm 38.7% e popullatës së komunës së Shtimes është e koncentruar në këto vendbanime.

III.10.4. Turizmi

Në territorin e komunës së Shtimes nuk ka ndonjë objekt apo zonë turistike me infrastrukturë përcjellëse ku qytetarët e Shtimes do të mund të kalonin vikendet. Me fjalë të tjera në Shtime nuk ka ofertë turistike, por qytetarët Shtimjan bëjnë turizëm në zonat e tjera turistike, si Blinaja (gjueti), Brezovicë (skijim, etj), Prevala (shëndetësorë) dhe qendrat apo zonat e tjera që ndodhen në Kosovë.

Ndërsa, për nga peizazhi gjeografike, si vlera të përgjithshme turistike në territorin e komunës së Shtimes ka dy lloje të peizazheve, fushën e cila shtrihet kryesisht në pjesën lindore dhe malet të cilat shtrihen në pjesën perëndimore të komunës së Shtimes. Ka mundësi të mira të zhvillimit të turizmit kulturor dhe ruralo-malor.

Vlerat më të mëdha turistike kryesisht shtrihen në pjesën perëndimore të komunës, në vendbanimet si Reçak, Petrovë, Mollopolc, Rancë, Belincë, Topillë, Carralevë, Karaqicë, Zborc dhe Pjetërshticë. Në këto vendbanime është e koncentruar gati e gjithë trashëgimia kulturore dhe natyrore e karakterizuar me dendësi të vogël banimi, frekuentim të vogël, ndotje të vogël, shkallë të madhe të degradimit të mjedisit nga gurthyesit, me klimë të përshtatshme, etj. Elemente tjetër turistike i kësaj zone është Kompleksi Memorial i Reçakut.

¹⁵ Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2007 – 2010, faqe 17.

Kurse, pjesëmarrja e bizneseve hoteliere ndaj numrit të përgjithshëm të bizneseve është 7%, me strukturë kryesisht hoteleri dhe të koncentruar kryesisht në vendbanimet si Shtime, Rashincë, Carralevë, Pjetërshticë, Godanc i Ulët dhe i Epërm dhe Petrovë¹⁶.

III.10.5. Industria

Prej 518 ndërmarrjeve ekonomike sa ka komuna e Shtimes, 11.78% e tyre janë ndërmarrje industriale kurse sa i përket raportit të punësuarve në industri ndaj të punësuarve në total në sektorët ekonomik është 18.64%¹⁷. Siç shihet, në komunën e Shtimes pas tregtisë sektori i tretë për nga rëndësia është industria. Sa i përket funksionimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme industriale në komunën e Shtimes tregohet një gjendje e njëjtë si në gjithë Kosovës.

Nga analizat e bëra kuptohet që numrin më i madh i aktiviteteve industriale është i përqendruar në vendbanimet përgjatë rrugëve magjistrale por edhe në vendbanimet e tjera ku kanë infrastrukturë të përshtatshme. Përqendrimi më i madh është në vendbanimet si Shtime, Belinë, Carralevë, Petrovë dhe Muzeqinë dhe në një far mënyre krijojnë një zonë industriale e cila mund të kuptohet edhe nga harta e mësipërme.

Gjithashtu edhe pozita e mirë në rrjetin rrugor nacional ka ndikuar në koncentrimin e disa ndërmarrjeve industriale të sektorit të ndërtimtarisë. Ky sektorë ka pjesëmarrje prej 6.37% të bizneseve dhe 11.66% të punësuarve në gjithë komunën.

Komuna e Shtimes, rëndësi të veçanet i ka kushtuar edhe organizimit dhe përqendrimit të bizneseve në një zonë të veçanet të veprimit të tyre. Me këtë rast, komuna e Shtimes nën partneritetin Slloveno-Kosovar ka fituar një projekt shumë më rëndësi për komunë dhe me këtë rast është përzgjedhë edhe hapësira ku do të ndërtohet Parku Industrial – “Teknopolis”, i cili ka një sipërfaqe prej 10ha dhe me gjithsej 25 parcela.

Teknopolisi apo parku industrial në Shtime do të ketë një sipërfaqe prej 10ha të cilat do të kenë 9 objekte industriale dhe edukative, e cila në fazën fillestare parashihet ti punësoj 300 punëtorë. Disa biznese të cilat priten të vendosen në këtë park industrial janë përfaqësi të pjesëve të Mercedesit, Audisë dhe BMW, gjithashtu edhe një shkollë e lart e menaxhimit të turizmit dhe mirëpritjes, si dhe një qendër për inovacione dhe teknologji¹⁸.

¹⁶ Vegla e punës të plotësuar nga K Shtimes.

¹⁷ Veglat e punës të plotësuar nga K Shtimes.

¹⁸ <http://www.kosovareport.com/20080416882/Business-and-Economy/Kosovar-Slovenian-partnership-to-build-Teknopolis.html>.



25 plots available in
a zone:

5	H	1.000	m ²
1	H	2.600	m ²
4	H	2.000	m ²
1	H	4.250	m ²
1	H	1.900	m ²
6	H	3.000	m ²
1	H	3.700	m ²
5	H	5.000	m ²
1	H	10.000	m ²



Business - industrial zone SHTIME, Hosouo



III.10.6. Buxheti komunal dhe shërbimet bankare


Komuna e Shtimes për vitin 2006 kishte të aprovuar një buxhet prej 2,260,522€, ku prej tyre 86.28% ose 1,950,522€ përbënte granti qeveritar, kurse të hyrat vetanake merrnin pjesë me vetëm 13.72% ose 310,000€.

Tabela 13. Të hyrat në buxhetin e komunës së Shtimes për vitet 2008-2010¹⁹

Burimi i të hyrave / '000€	2006		2007		2008		2009		2010	
	Aktuale	%	Buxheti	%	Projeksioni	%	Projeksioni	%	Projeksioni	%
Gjithsej grantet	1,950,522	86	1,998,051	89	2,148,645	87	2,378,836	88	2,631,031	88
të hyrat vetanake	310,000	14	250,000	11	316,623	13	332,959	12	351,943	12
Totali	2,260,522	100	2,248,051	100	2,465,268	100	2,711,795	100	2,982,974	100

Në përgjithësi buxheti është rritur nga viti 2006 në vitin 2008 dhe po ashtu projeksionet deri në vitin 2010 tregojnë rritje të të hyrave në buxhetin komunal, ndërsa raporti në mes të hyrave vetanake dhe granteve qeveritare mbetet I madh dhe I dominuar nga këto të fundit.

¹⁹ Korniza afatmesme buxhetore 2008-2010, faqe 8.

Grafiku 7. Të hyrat e administratës komunale për vitet 2008-2010²⁰


Gjatë tri viteve të fundit të hyrat në administratën komunale kanë qenë të kryesura kryesisht nga taksat pronësore, shfrytëzimi i tokës komunale, lejet për shfrytëzimin e tokës dhe për ndërtim, gjobat e trafikut, grantet e donatorëve dhe të hyrat në shëndetësi. Kurse projeksionet buxhetore për vitin 2009 dhe 2010 tregojnë kryesim dominues nga gjobat në trafik dhe taksat pronësore, pastaj më pak nga lejet për shfrytëzimin e tokës për ndërtim dhe inspektimet në tokë bashkë me aktivitetet tjera gjeodezike.

Kurse sa i përket shërbimeve bankare, në Shtime veprimtarinë bankare e para e ka filluar dega e Bankës Private të Biznesit - Shtime, ndërsa në vitin 2006 kanë filluar të punojnë edhe dy degët e bankave: Reiffeissen Bank dhe Pro Credit Bank. Ndërsa tani veprimtarin e tyre e ushtrojnë edhe bankat si KEP dhe Banka Private e Biznesit. Kushtet për zhvillimin e bizneseve këto banka i ofrojnë sikurse në pjesë tjera të Kosovës, pra edhe pse për komunën e Shtimes këto banka kanë rëndësi të madhe për zhvillimin ekonomik lokal ende ka nevojë për kushte më të mira për përkrahjen e bizneseve e sidomos të atyre fillestare.

III.10.7. Projektet kapitale të realizuara në periudhën 2001-2008

²⁰ Korniza afatmesme buxhetore 2008-2010, faqe 9.

Komuna e Shtimes gjatë periudhës 2001-2008 ka realizuar më se 270 projekte kapitale në vlerë prej 18,739,484 €. Investimet kapitale kanë prekur çdo vendbanim, natyrisht disa më shumë e disa më pak, kjo varësisht nga nevoja dhe rrethanat tjera. Vlera më e madhe e investimeve është bërë në infrastrukturë me 10,866,272 € ose me 58% të totalit²¹.



Grafiku 8. Përqindja e investimeve kapitale sipas sektorëve në K Shtime për periudhën 2001-2008

Pas infrastrukturës, investimet më të mëdha janë bërë në arsim me 4,011,962 € ose me 22% nga totali, në kulturë me 2,243,390 € ose me 12% nga shuma e përgjithshme e investimeve, kurse sektorët tjerë kanë një pjesëmarrje më të vogël, kryesisht prej 2% e më pak. Sigurisht që investimet në sektorin e bujqësisë janë shumë të vogla me një pjesëmarrje jo më shumë se 0.1% ose 42,416 €. Investimet në këtë sektorë duhet të rriten në qoftë se pretendohet që bujqësia të jetë një sektor prioritar, natyrisht që duhet të hartohen edhe më shumë projekte.

Ndërsa për sa i përket shpërndarjes hapësinore të projekteve sipas numrit dhe vlerës së tyre, kuptohet që qyteti i Shtimes për 8 vite ka kryesuar si për nga numri i projekteve poashtu edhe nga vlera e tyre, ku janë realizuar mbi 120 projekte dhe janë investuar më se 11 milion €²².

III.11. INFRAFRASHTRUKTURA-TOMA

- III.11.1. INFRASTRUKTURA RRUGORE
- III.11.2. TRANSPORTI PUBLIK

²¹ Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim K Shtime.

²² Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim K Shtime.

- III.11.3. ENERGJIA ELEKTRIKE
- III.11.4. INFRASTRUKTURA E FURNIZIMIT ME UJË
- III.11.5. SISTEMI I KANALIZIMIT
- III.11.6. TELEKOMUNIKACIONI

III.11.8. Menaxhimi i mbeturinave

Grumbullimin e mbeturinave e realizon kompania “Pastërtia” me periferi të Shtimes, në të cilën kompani janë të punësuar 27 punëtor. Kompania bënë grumbullimin e mbeturinave nga kontejnerët e shpërndarë në qytet dhe disa fshatra përreth, por numri i tyre dhe lokacioni janë të pamjaftueshëm dhe nuk mbulojnë të gjitha zonat banimit. Nga kjo arsye mbeturinat hidhen kudo. Ndërsa lumi që kalon nëpër Shtime është i rrezikuar shumë nga hedhja e tyre dhe nga kanalizimet që derdhen në mënyrë individuale. Në terren janë evidentuar disa pika të hedhjes së mbeturinave që janë potencial i dëmtimit dhe degradimit të mjedisit, në anën tjetër, paraqesin rrezik permanent për shëndetin e banorëve përreth.

Shpërndarja e kontejnerëve me kapacitet 1.1 m³ janë 75 copë si dhe 7 copë janë me kapacitet 5.5 m³.

Në bazë të analizave për numrin e banorëve 9100 banor në ditë gjenerojnë sipas një mesatare ditore 2kg/ditë atëherë llogaritet se ne zonën urbane ne Shtime gjenerohen 18200kg/dit ose 546t ne muaj ndërsa nga kompania. Pastrimi për një muaj barten rreth 150 ton mbeturina. Në bazë të kalkulimeve vetëm 1/3 e mbeturinave menaxhohet.

IV. SWOT ANALIZA – QYTETIT SHTIME

Metoda e SWOT analizës shërben për të identifikuar përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet për hapësirën e caktuar. Që të kemi një vlerësim të gjendjes ekzistuese për territorin e Shtimes, kemi aplikuar këtë metodë dhe kemi këto rezultate si më poshtë;

	TË BRENDSHËM	TË JASHTËM
	Përparësitë	Mundësitë
POZITIVË	○ Pozita e volitshme gjeografike; ○ Popullsia në moshë të re (nën 30 vjeç); ○ Popullsia e shëndosh dhe orientuar drejt vlerave arsimore; ○ Sipërfaqe të mjaftueshme të tokave jo produktive për zgjerim të qytetit; ○ Mundësitë e dendësimit të hapësirës urbane; ○ Ekzistimi i OJQ-ve për mbrojtjen e mjedisit; ○ Sipërfaqe cilësore të tokës bujqësore (kategoria II-IV) ○ Trashëgimi natyrore dhe kulturore ○ Resurset ujore ○ Pozitë e mirë për zhvillim të sektorit tregtarë (transport nacional dhe ndërnacional si dhe afërsia me disa qendra të mëdha urbane dhe aeroportin) ○ Parku industrial – Teknopolis ○ Qasja e popullsisë në sistemin e ujësjellësit ○ Qasja e popullsisë në telefoni fikse	○ Programe të veçanta-profesionale për të papunët sipas kërkesave të tregut; ○ Programe për zhdukjen e analfabetizmit; ○ Ofrimi i shërbimeve shëndetësore për të gjithë; ○ Peizazhe të përshtatshme për pushim dhe rekreacion; ○ Vetëdijësimi i popullatës për mbrojtjen e ambientit; ○ Harmonizimi i zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së mjedisit ○ Ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore ○ Procesi i privatizimit në funksion të zhvillimit ekonomik; ○ Zgjerimi i sipërfaqeve të kultivuara me pemë dhe perime; ○ Mundësi të mira për zhvillimin e tregtisë; ○ Përmirësimi i kushteve për kredi (ulja e kamatave); ○ Mirëmbajtja e rrugëve lokale të asfaltuara; ○ Menaxhimi adekuat i ujësjellësit; ○ Ndërtimi i stacionit të autobusëve; ○ Përmirësimi i rrjetit të energjisë elektrike; ○ Shtrirja e rrjetit të kanalizimit në tërë qytetin ○ Ndërtimi i një impianti të ujërave të zeza në bashkëpunim me komunën e Lypjanit; ○ Ndriçimi i rrugëve në zonën urbane;

	TË BRENDSHËM	TË JASHTËM
	Dobësitë	Kërcënimet
NEGATIVË	○ Niveli jo i kënaqshëm i shërbimeve në arsim dhe shëndetësi; ○ Shkalla e lartë e papunësisë dhe varfërisë; ○ Mungesë e barazisë gjinore; ○ Mungesa e shtëpisë së kulturës, teatrit dhe qendrës sportive; ○ Vendbanimet jo formale; ○ Dendësia e vogël në qendrën urbane për ha; ○ Humbja e tokës bujqësore nga zhvillimet e paplanifikuara; ○ Mungesa e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza; ○ Ndotja e mjedisit nga mbeturinat ○ Mbrojtja jo e mirë nga vërshimet ○ Degradimi i lumit dhe tokës bujqësore; ○ Mungesa e pronave të duhura komunale që do të mund të destinoheshin për zhvillim ekonomik; ○ Orientimi i gabuar i subjekteve afariste vetëm në tregti dhe shërbime e jo në prodhim; ○ Buxheti i kufizuar komunal për projekte kapitale; ○ Gjendja fizike jo e mirë e rrugëve ○ Mungesa e stacionit të autobusëve ○ Gjendja fizike jo e mirë e rrjetit të energjisë elektrike;	○ Mungesa e donacioneve në programe profesionale për; papunësi, analfabetizëm, ndërtimin e objekteve shëndetësore dhe arsimore; ○ Zgjerimi i vendbanimeve jo formale; ○ Ndërtime ilegale në toka bujqësore; ○ Ndërtime individuale përgjatë korridoreve dhe rrezikimi i tyre; ○ Ndotja e mjedisit; ○ Fatkeqësitë e mundshme natyrore: tërmetet dhe vërshimet; ○ Investimet jo të mjaftueshme në mjedis; ○ Ekonomia joformale; ○ Mungesa e informacioneve për investitorë të huaj për fushat e mundshme të investimit; ○ Mos funksionalizimi i parkut industrial;

IV.1. SFIDAT E IDENTIFIKUARA NË QYTETIN E SHTIMES

SFIDA 1. NIVELI JO I LARTË I SHËRBIMËVE NË ADMINISTRATË PUBLIKE

Si të arrijmë shërbime më të mira në administratë publike?

Edhe përkundër arritjeve në shërbimet administrative akoma mbetet për tu bërë. Ngritja e nivelit të shërbimeve elektronike, do të shkurtojë kohën e marrjes së shërbimit nga qytetarët dhe do të rrisë bashkëpunimin e ndërsjellë. Shërbime cilësore mund të kemi atëherë kur administrata posedon kuadër të specializuar, shërbime të internetit, intranetit, kompjuter, server, softuer, GPS, skaner, plloter, telefoni fikse digjitale, etj.

SFIDA 2. NIVELI I ULËT I SHËRBIMEVE SOCIALE

Si të arrijmë shërbime më të mira sociale?

Niveli i ulët i shërbimeve sociale ka prekur të gjitha poret e jetës shoqërore. Mungesa e hapësirës shkollore dhe shëndetësore në zonën urbane parqet problem në vete. Po ashtu, në mungesë të shtëpisë së kulturës dhe teatrit mungojnë shfaqjet e ndryshme kulturore ose edhe ato pak shfaqje të cilat realizohen, paraqiten në vende të pa përshtatshme. Përveç këtyre, mungojnë edhe shërbime të tjera të rëndësishme si: çerdhja e fëmijëve, stadiumi i qytetit dhe qendra sportive të cilat janë të domosdoshme për plotësimin e nevojave të shoqërisë.

Pa përmirësimin e gjitha shërbimeve sociale të përmendura si më lartë nuk mund të kemi standard cilësorë të jetesës.

SFIDA 3. SHKALLA E LARTË E PAPUNËSISË DHE VARFËRISË

Si të zbusim shkallën e papunësisë dhe varfërisë?

Fenomeni i papunësisë dhe varfërisë në qytetin e Shtimes është i shprehur për kohë të gjatë. Për të minimizuar këtë fenomen kërkohet përkrahje e bizneseve të vogla dhe të mesme përmes stimulimeve, krijimi i kushteve të përshtatshme për donator, informimi adekuat për donator vendor dhe ndërkombëtar për mundësitë që kanë për investime në këtë territor, sigurimi i punës sezonale, rritja e sigurimit të ndihmave për të varfrit, zhvillimi i bujqësisë etj.

SFIDA 4. MUNGESA E BANIMIT ADEKUAT DHE NDËRTIMET E PA PLANIFIKUARA

Si ta përmirësojmë nivelin e banimit dhe të ndalen ndërtimet pa plan?

Për shkak të zhvillimit horizontal dhe dispers të qytetit është humbur sipërfaqe e konsiderueshme e tokës bujqësore, ku shumica e ndërtimeve janë bërë në tokë produktive dhe përgjatë korridoreve të rrugëve. Kjo formë e ndërtimit vështirëson zgjerimin e rrugëve ekzistuese. Kushtet e banimit gjithashtu nuk janë të përshtatshme si pasoj e mungesës së infrastrukturës përcjellëse për objektet e banimit. I tërë banimi në qytetin e Shtimes është individual.

Për të përmirësuar gjendjen e banimit dhe planifikimin e ndërtimeve, është me rëndësi të hartohen, në radhë të parë, planet rregullative urbane që nuk janë pjesë e këtij projekti, por

duhet realizuar në fazat e mëvonshme. Gjithashtu është e rëndësishë së veçantë zoonimi i hapësirës së ndërtuar që përcakton kufirin e zgjerimit të qytetit dhe mundësitë e shfrytëzimit racional të hapësirës ekzistuese brenda zonës.

SFIDA 5. PRANIA E VENDBANIMEVE JOFORMALE

Si ti rregullojmë vendbanimet joformale?

Vendbanimet joformale janë një sfidë serioze në nivel të Qeverisë së Kosovës, andaj identifikimi dhe trajtimi i tyre është ndër prioritetet kryesore. Edhe në qytetin e Shtimes janë identifikuar vendbanime të tilla të cilat ballafaqohen me mungesë të elementeve themelore të jetesës, si; mungesa e shërbimeve, pronësia, qasja në qeverisje dhe probleme të tjera.

Këto zona në qytetin e Shtimes duhet trajtuar në mënyrë të veçantë, duke krijuar kushte të përshtatshme jetësore për komunitetin si dhe integrimin e tyre me planin zhvillimor komunal dhe urban.

SFIDA 6. SHKALLA E ULËT E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Si të arrijmë nivel më të lartë të zhvillimit ekonomik?

Qyteti i Shtimes nuk ka nivel të duhur të zhvillimit ekonomik. Aktivitetet ekonomike më të theksuara janë ato tregtare dhe zejtare, të cilat nuk ofrojnë bazë të fortë ekonomike, punësojnë numër të vogël të punëtorëve dhe ballafaqohen me probleme të natyrave të ndryshme. Nuk ka industri të zhvilluar ku mund të mbështetet zhvillimi i sigurtë ekonomik i qytetit apo edhe komunës. Meqë është qytet i vogël me elemente agrare, atëherë mund të themi se edhe veprimtaritë primare janë pjesë e ekonomisë së qytetit por ato nuk patën ndikim në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik.

Ekonomia e qytetit është një element mjaft i rëndësishëm i zhvillimit urban, andaj edhe në qytetin e Shtimes duhet parashihen zhvillime të caktuara ekonomike. Përcaktimi i zonave për biznes dhe atyre industriale, ofrimi i infrastrukturës së përshtatshme, përkrahja e bizneseve të vogla dhe të mesme, promovimi i turizmit dhe zhvillimi i pemëtarisë e perimtarisë janë disa nga masat që duhet ndërmarr për përmirësimin e situatës ekzistuese.

SFIDA 7. INFRASTRUKTURË JO CILËSORE DHE E PA MJAFTUESHME

Si t'i përmirësojmë shërbimet në infrastrukturë?

Qyteti i Shtimes është një vendbanim transit ku kalojnë rrugë magjistrale dhe regjionale të cilat e ngarkojnë komunikacionin urban. Rrugët e asfaltuara janë të dëmtuara dhe pa infrastrukturë përcjellëse. Sistemi i kanalizimit nuk është në gjendje të mirë, ndërsa mungesa e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza shprehet negativisht në mjedis.

Shkarkimi i qytetit nga trafiku ndërregjional duhet të bëhet përmes rrugëve transite, ndërsa brenda qytetit është me rëndësi të përmirësohet sistemi rrugor dhe infrastruktura përcjellëse. Intervenimi në sistemin e ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit energjetik si dhe impiantit për trajtimin e ujërave të zeza paraqesin masat bazë për përmirësimin e infrastrukturës fizike të qytetit.

SFIDA 8. NDOTJA E MJEDISIT DHE HUMBJA E TRASHEGIMISË**Si ta mbrojmë mjedisin dhe ta ruajmë trashëgiminë?**

Qyteti i Shtimes përballet me ndotje të ujit, tokës dhe ajrit. Menaxhimi jo i plotë i mbeturinave dhe ndotja e ujit, janë veprime negative që e ndotin mjedisin. Objektet e trashëgimisë kulturore nuk kanë përkujdesin e duhur dhe mungojnë investimet për to.

Në zonën urbane duhet ndërmerren masa për minimizimin e veprimeve të dëmshme në mjedisin urban, si: zgjerimi i hapësirave të gjelbra, mbrojtja e peizazheve, si brenda ashtu edhe përreth qytetit, parandalimi i hedhjes së mbeturinave si dhe mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

V. POTENCIALET PER ZONËN URBANE

1. Popullsi e shendosh dhe në moshë të re (nën 30 vjeç);
2. Fuqia punëtore;
3. Numër i konsiderueshëm i emigrantëve;
4. Parcelat e mëdha në qendrën urbane;
5. Sipërfaqe cilësore të tokës bujqësore;
6. Traditë në aktivitete agrare;
7. Parku industrial “Teknopolis”;
8. Mundësi për zhvillim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
9. Aktivitetet shërbyese dhe tregtare;
10. Gatishmëria e participimit të qytetarëve në projektet e përbashkëta;
11. Urë lidhëse mes rrafshit të Dukagjinit dhe të Kosovës në pjesën JLL. të Kosovës;
12. Shtrirja e planifikuar e trasesë së autostradës Durrës - Morinë – Merdare;

VI. RAPORTI I TAKIMIT TË PARË PUBLIK


Raporti takimit pare

“VIZIONI, PARIMET DHE CAQET”

FAZA E DYTË

I.PLANI HAPËSINOR I KOSOVËS-ZONA E KALTËR

Komuna e Shtimes së bashku me Prishtinën, Obiliqin, Drenasin, Podujevën dhe Lipjanin, janë të shënuara si zonë e kaltër- Porti i Kosovës në Planin Hapësinor të Kosovës. Kjo zonë karakterizohet me përqendrim në administratë, edukim, përkujdesje shëndetësore, industri të lehtë, industri bujqësore dhe turizëm.



I.1. QËLLIMET E PËRGJITHSHME PËR ZONËN E KALTËR

SHTIME

- Zhvillimi i rrjetit e atraktiv të qyteteve të planifikuara, me qeverisje e shërbime publike në favor të qytetarit, me rritje të kualitetit të jetës së qytetarëve, punësimit dhe barazi sociale.
- Mbështetje ZHEL për ZHEK – shfrytëzimi i përparësive konkurruese,

- Zhvillimin e lidhjeve efikase brenda urbane, ndër urbane me 5 hapësirat e tjera dhe më gjerë lidhjet e fuqishme rajonale përmes zhvillimit të rrjetit të infrastrukturës (rrugore, hekurudhore, ajrore, TI-së).
- Promovim i TZHEK, lokacion për grupim aktiviteteve në aspekt hapësinor, investime të huaja, kompani multinationale,
- Mbështetje aktiviteteve H&ZH, për një ekonomi të njohurive, mbështetur nga kapacitetet organizative,
- Promovimi i Prishtinës si qendër e diturisë të rajonit më të gjerë të Evropës Juglindore.
- Zhvillim i aktiviteteve administrative, arsimore, shërbyese tregtare, energjetike, agroindustriale e turistike.

I.2. ZONAT ME INTERES TË VEÇANTË NË ZONËN E KALTËR

Me Plan Hapësinor të Kosovës janë propozuar zonat me interes të veçantë, të cilat gjenden në **Portin e Kosovës (Hapësirë e kaltër).**

Zonë me Interes të veçantë për Republikën e Kosovës në Komunën e Shtimes është: **Korridori i autostradës Durrës – Morinë - Merdare që kalon nëpër territorin e komunës.**

Për harmonizimin e dokumenteve hapësinore nga niveli lokal në atë qendror na ka shërbyer Plan Hapësinor i Kosovës 2005-2015+, Ligji për Planifikim Hapësinor dhe dokumentet tjera relevante.

Plani Hapësinor i Kosovës e vendos Shtimen në kufijtë e Zonës së Kaltër, aty ku kalon arteria e rëndësishme që kryqëzohet dhe lidhë Rrafshin e Kosovë me atë të Dukagjinit, si një urë lidhëse e këtyre regjioneve të Kosovës.

Planifikimi i hapësirës urbane në Shtime daton nga vitet e 80-ta, kur është hartuar plani i parë gjeneral urbanistik, e pastaj edhe plani detal urbanistik. Nga përvojat e deri tashme konstatohet se planet zhvillimore nuk janë implementuar në nivel të duhur në mungesë të mjeteve financiare.

Drejtorati për planifikim, zhvillim, rindërtim dhe urbanizëm është subjekt i rëndësishëm në institucionalizimin e veprimtarisë së planifikimit hapësinor dhe urban, me kompetenca mbi hartimin e dokumenteve të planifikimit, monitorimin e zhvillimeve humane, hapësinore dhe krijimin e bazës së të dhënave për dukuritë dhe proceset që zhvillohen në hapësirë.

Hartimi i planit zhvillimor urban shërben si udhëzues në:

- ✓ Identifikimin e lokacioneve me potencial të zhvillimit hapësinor të qytetit dhe rrethinës
- ✓ Aprovimin e vendimeve lidhur me zonat e banimit, shërbimeve, industrisë, biznesit, turizmit, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë natyrore e kulturore
- ✓ Identifikimin dhe përcaktimin e rolit të zonave kryesore brenda qytetit dhe atyre përreth që reflektohen në zhvillimin e përgjithshëm
- ✓ Përcaktimin e rolit socio-ekonomik dhe kulturor të qytetit

Aktualisht, zhvillimi urban i Shtimes bazohet në planin e vjetër gjeneral të vitit 1989, i cili është i tejkaluar. Pengesat për tu zbatuar ky plan janë të dimensionit kohor dhe ndryshimeve të rëndësishme shoqërore-ekonomike që ndodhën pas vitit 1999.

Vlerësimi i gjendjes ekzistuese, konsultimi i dokumentacionit dhe transparenca me komunitetin, hapin mundësitë për zhvillimin e mëtejshëm të Shtimes si qytet funksional dhe dinamik për banorët e saj.

II. VIZIONI PËR TE ARDHMEN E QYTETIT TË SHTIMES

Plani Zhvillimor Urban i Shtimes përcakton kahet zhvillimore për 10 vitet e ardhshme. Për këtë periudhë kohore, vizioni, parimet dhe qëllimet në vijim do ta udhëzojnë dhe orientojnë zhvillimin e qytetit.

Deklarata e vizionit:

“Shtimja qytet funksional me shërbime cilësore për qytetarët, banim adekuat, ndërtime të planifikuara dhe trajtim të vendbanimeve joformale, kushte më të favorshme për arsim dhe shëndetësi, avansim ekonomik, infrastrukturë të përshtatshme, mjedis të shëndosh dhe rrespektim të trashëgimisë”

Shtimja si pjesë e Portit të Kosovës, në afërsi me kryeqendrën, aeroportin, hekurudhën dhe lidhjet e mira rrugore në drejtim Lindje-Perëndim dhe Veri-Jug mund ti shfrytëzoj këto përparësi maksimalisht për zhvillimin ekonomik.

Duke u bazuar në pozitën e përshtatshme, heterogjenitetin hapësinor që e rrethon dhe potencialin njerëzorë, qyteti i Shtimes do të funksionoj si qendër e rëndësishme në rrafshin e Kosovës.

Politikat adekuate për tokën, avancimi e rrjetit të komunikacionit, infrastrukturës komunale dhe institucionale, sistemit të ujitjes, tregtisë, turizmit, zhvillimin e bizneseve të vogla e të mesme, si dhe potencialeve të tjera, do të reflektohen pozitivisht në zhvillimin ekonomik dhe hapësinor të qytetit. Në bazë të këtyre përparësive, Shtimja ka mundësi të tërheqë investitorët për zhvillimin ekonomik. Për ta arritur këtë qëllim duhet të ketë planifikim hapësinorë të mirëfilltë dhe shfrytëzim të mirë të lidhjeve tradicionale me qendrat përreth.

II.2. PARIMET E PËRGJITHSHME TË ZHVILLIMIT

Parimet e përgjithshme të planit zhvillimor urban bazohen në dokumentet e rëndësishme për planifikim hapësinor, si:

- **Ligji për Planifikim Hapësinor**
- **Parimet Udhëzuese për Zhvillimin e Qëndrueshëm Hapësinor të BE – ESDP**
- **Parimet e zhvillimit të qëndrueshëm – Agjenda 21**
- **Parimet e qeverisjes së mirë urbane – Agjenda e Habitatit**

Parimet bazë mbi të cilat do të fokusohen zhvillimet e përgjithshme të qytetit të Shtimes në raport me parimet ndërkombëtare janë :

- Promovimin e interesave të përbashkëta të komunës duke mbrojtur dhe zhvilluar resurset natyrore dhe duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm.

- Promovimin e procesit demokratik të pjesëmarrjes dhe përfshirjes në formulimin e strategjive zhvillimore dhe planeve fizike.
- Promovimin e transparencës së plotë në planifikim dhe procesin e marrjes së vendimeve duke iu lejuar pjesëmarrësve qasjen në të dhëna dhe hartat e nevojshme.
- Promovimin e të drejtave të barabarta ekonomike dhe shoqërore për të gjithë kosovarët.
- Promovimin e kualitetit të përmirësuar të jetës dhe forma të balancuara të vendbanimeve.
- Promovimin e harmonizimit me parimet dhe planet e vazhdueshme të zhvillimit hapësinor Evropian.

II.2. PARIMET E QEVERISJES SË MIRË

- **QËNDRUESHMËRIA** - të ketë qasje të integruar e cila përfshin elementet hapësinore të transportit, zhvillimit shoqëror-ekonomik, mjedisor dhe politikat tjera strategjike për komunë.
- **SUBSIDIARITETI** – marrja e vendimeve mbi baza të hierarkisë nga niveli qendror në atë lokal dhe zbatimi sa më efikas.
- **BARAZIA** - plani duhet të merr parasysh aspektet e barazisë: minoritetet, femrat, fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara (adresimi i nevojave të grupeve të tilla përmes pjesëmarrjes publike) të ketë në konsideratë aspektet e ndjeshmërisë gjinore.
- **EFIKASITETI** - ti prijë zhvillimit strategjik në territorin e komunës dhe të trajtojë çështjet e rëndësishme strategjike për fushat përkatëse.
- **TRANSPARENCA** – të gjitha zhvillimet të cilat ndodhin në hapësirë duhet të kenë arsyen, dhe personat përgjegjës duhet të jenë transparent për zhvillimet në hapësirë.
- **PJESËMARRJA** – në këtë rast plani zhvillimor dhe urban si dy projekte shumë të rëndësishme për të ardhmen e komunës duhet të përfshijnë pjesëmarrje të gjerë me qëllim të përfaqësimit të interesave të të gjithëve pa dallime.
- **PËRGJEGJSHMËRIA** – për të gjitha zhvillimet të cilat ndodhin në hapësirë duhet të jemi të përgjegjshëm. Këtë duhet ta bëjë si sektori publik, privat dhe deri te qytetari.

III. QËLLIMET AFATËGJATE TË ZHVILLIMIT

Analiza e gjendjes aktuale dhe evidentimi i problemeve, (njohja e të së kaluarës dhe të tashmes) hapin shtigje dhe mundësi të reja për përmirësimin e kushteve jetësore. Komuna ka burime të limituara në dispozicion, por megjithatë, është e rëndësishme që këto burime të përqendrohen në sektorët adekuat të cilat mundësojnë një zhvillim më të sigurtë dhe me perspektivë.

Qëllimi Q1. Administratë publike efikase

Q1S1. Transparente

Q1S2. Përmirësimi i shërbimeve në administratë

Q1S3. Digjitalizimi i administratës

Q1S4. Themelimin e gjykatës komunale

Qëllimi 2. Zhvillim i shërbimeve social

- Q2S1. Zgjerimi i hapësirës shkollore dhe shëndetësore
- Q2S2. Rritja e bashkëpunimit në avancimin e kushteve në entin special
- Q2S3. Avancimi i shërbimeve mjekësore në lëmi të specializuara
- Q2S4. Ndërtimi i shtëpisë së kulturës, teatrit dhe qendrës sportive
- Q2S5. Zhvillimi i programeve më karakter edukativo-kulturor
- Q2S6. Rregullimi i stadiumit të qytetit
- Q2S7. Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve

Qëllimi 3. Zbutja e shkallës së papunësisë dhe varfërisë

- Q3S1. *Organizimi i trajnimeve profesionale sipas kërkesave të tregut*
- Q3S2. *Sigurimi i punës sezonale*
- Q3S3. *Përkrahje të bizneseve të vogla dhe të mesme*

Qëllimi 4. Banim adekuat dhe ndërtime të planifikuara

- Q4S1. Hartimi i planeve rregullative për tërë zonën urbane
- Q4S2. Përcaktimi i vijës ndërtimore në zonën urbane
- Q4S3. Shfrytëzim racional i hapësirës brenda kufirit ndërtimor ekzistues
- Q4S4. Përcaktimi dhe definimi i qendrës
- Q4S5. Rritja e dendësisë së banimit
- Q4S6. Ndërtim vertikal i objekteve
- Q4S7. Mbrojtja e tokës bujqësore

Qëllimi 5. Trajtim të vendbanimeve joformale

- Q5S1. Trajtim adekuat i vendbanimeve joformale

Qëllimi 6. Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik

- Q6S1. Zhvillimi i zonave për biznes dhe atyre industriale me infrastrukturë të përshtatshme
- Q6S2. Përkrahja e bizneseve të vogla dhe të mesme
- Q6S3. Funksionalizimi i zonës industriale “TEKNOPOLIS”
- Q6S4. Trajnime profesionale, seminare dhe kurse për zhvillim ekonomik dhe marketing
- Q6S5. Promovimin e infrastrukturës për rekreacion dhe turizëm
- Q6S6. Zhvillim i pemëtarisë dhe perimtarisë

Qëllimi 7. Infrastrukturë funksionale dhe cilësore

- Q7S1. Shkarkimi i qytetit nga transporti regjional

- Q7S2. Përmirësim i rrjetit rrugor me infrastrukturë përcjellëse
(Trotuari, staza për biçiklist, parkingjet, parkingjet për persona me aftësi të kufizuara, gjelbërimi skaj rrugës)
- Q7S3. Përcaktimi i lokacionit për stacionin e autobusëve
- Q7S4. Sigurimi i burimeve dhe avancimi i sistemit të furnizimit me ujë
- Q7S5. Përmirësimi dhe ndërtimi i sistemit të ri të ndarë të kanalizimit fekal dhe atij atmosferik
- Q7S6. Ndërtimi i impiantit për ujëra të zeza me interes nderkomunal
- Q7S7. Përmirësimi i rrjetit energjetik
- Q7S8. Ndriçimi publik për tërë zonën urbane
- Q7S9. Qasje e përgjithshme e zonës urbane me telefoni fikse dhe internet
- Q7S10. Menaxhimi efikas i mbeturinave

Qëllimi 8. Mjedis të shëndosh dhe respektim të trashëgimisë

- Q8S1. Minimizimi i ndikimeve të dëmshme të veprimeve të njeriut në mjedis
- Q8S2. Krijimi i kushteve për mbrojtje nga rreziqet e ndryshme natyrore
- Q8S3. Zgjerimi i hapësirave të gjelbra
- Q8S4. Mbrojtja e peizazheve natyrore përreth qytetit
- Q8S5. Mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore
- Q8S6. Parandalimi i hedhjes të mbeturinave
- Q8S7. Rregullimi i shtratit të lumit si mjedis i përshtatshëm për rekreacion

IV. PRIORITETET STRATEGJIKE

1. Banim adekuat dhe ndërtime të planifikuara
2. Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik
3. Infrastrukturë funksionale dhe cilësore
4. Zbutja e shkalles se papunësisë dhe varfërisë
5. Mjedis të shëndosh dhe respektim të trashëgimisë
6. Zhvillim i shërbimeve sociale
7. Administratë publike efikase
8. Trajtim të vendbanimeve joformale

“KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR URBAN”

FAZA E TRETË

I. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR URBAN

I.1 KONCEPTET KRYESORE TË ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Duke u mbështetur në analizën e gjendjes ekzistuese të këtij materiali, vizionit që ka të bëjë me synimet e planifikuara zhvillimore, parimet dhe prioritetet strategjike, plani zhvillimor urban duhet të përcaktojë strukturë të favorshme të zhvillimit të ardhshëm të qyteti të Shtimit. Kjo strukturë duhet të respektojë vlerat natyrore dhe trashëgimore të hapësirës në fjalë.

Deklarata e vizionit:

“Shtimja qytet funksional me shërbime cilësore për qytetarët, banim adekuat, ndërtime të planifikuara dhe trajtim të vendbanimeve joformale, kushte më të favorshme për arsim dhe shëndetësi, avancim ekonomik, infrastrukturë të përshtatshme, mjedis të shëndosh dhe respektim të trashëgimisë”

Vizioni për qytetin e Shtimes

Potencialet e qytetit të Shtimes dhe komunës mundësojnë orientimin në forcimin e strukturës së ndërtuar, avancimin e aktiviteteve socio-ekonomike dhe zhvillimin e hapësirave të gjelbra. Në bazë të këtyre komponentëve rrjedhin synimet dhe konceptet për një qytet me *perspektivë*, qytet *kompakt* dhe qytet i *gjelbëruar*.

Shtimja qytet me *perspektivë*-orientohet në aprovimin, përmirësimin dhe ngritjen e kushteve socio-ekonomike me qëllim të dinamizimit të qytetit. Parku industrial dhe niveli i lartë i shërbimeve ofrojnë mundësi për ngritjen e kësaj qendre urbane në nivel të kënaqshëm dhe tërheqëse për banorët:

Krijimi i zonave ekonomike/industriale

Zhvillimi i agro-biznesit

Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

Koncepti i qytetit *kompakt*- Sa i përket strukturës hapësinore të qytetit ajo është jo kompakte. Nga kjo arsye koncepti kryesor i zhvillimit orientohet në ndërtimin e një qyteti kompakt.

Konceptet kryesore që duhet të bazohemi gjatë hartimit të planit janë:

- ✓ Rritja e dendësisë së banimit
- ✓ Definimi i tokës për ndërtim
- ✓ Definimi dhe përforcimi i qendrës
- ✓ Plotësimi i hapësirave boshe në zonat e ndërtuara
- ✓ Zhvillimi i përqendruar në polet kryesore
- ✓ Qasje e lehtë në shërbime dhe infrastrukturorë,
- ✓ Përshtatja dhe përmirësimi i sistemit rrugor
- ✓ Lidhja funksionale e qytetit me rrethinën

Qytet i gjelbëruar - Duke u bazuar në vizionin e përcaktuar nga Plani Zhvillimor Komunal për komunën e Shtimes e cila mbështetet në promovimin e bujqësisë moderne dhe turizmit në hapësirat e gjelbra, sipërfaqet e gjelbra duhet orientuar në bujqësinë urbane:

Mbrojtja e hapësirave të gjelbra ekzistuese

Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbra

Lidhja e sipërfaqeve të gjelbra urbane me ato natyrore (pylli, lumi, hapësirat bujqësore, zonat turistike)

I.2. STRUKTURAT KRYESORE HAPËSINORE

Strukturat kryesore hapësinore që e përbëjnë konceptin e përgjithshëm të qytetit të Shtimes janë:

1. Struktura e sipërfaqes së ndërtuar
2. Infrastruktura dhe transporti
3. Struktura e sipërfaqeve të gjelbra

1. Struktura e sipërfaqes së ndërtuar-Koncepti kryesor lidhur me strukturën ndërtimore të qytetit të Shtimes është kompaktësimi i ndërtimeve me qëllim të ndaljes së dukurisë të ndërtimit të shpërndarë dhe zgjerimit të pakontrolluar. Sipas këtij koncepti zhvillimi duhet të kufizohet brenda sipërfaqes së ndërtuar. Kjo kompaktësi arrihet duke kompletuar dhe përforcuar strukturën ekzistuese fizike. Dendësimi është komponentë themelore që siguron kompaktësinë ndërsa funksionet dhe aktivitetet që ushtrohen brenda zonës së ndërtuar duhet të plotësojnë nevojat duke respektuar parametrat.

Përforcimi i qendrës dhe dendësimi i saj duhet të jenë më të shprehura në këtë plan, ndërsa identiteti dhe funksionalizimi i qendrës do të jetë tërheqëse jo vetëm për banorët e qytetit por edhe më gjerë.

Zona industriale vendoset dhe zhvillohet në periferi të qytetit. Lokacioni i propozuar në jug-lindje, afër rrugës për Ferizaj, ofron kushte të volitshme për zhvillim dhe lidhje të mira me trafikun. Kjo formë shmangë trafikun në qytet, zvogëlon konfliktet mes funksionit të punës e banimit, zvogëlon ndotjen nga gazrat dhe zhurma, etj.


2. Infrastruktura dhe transporti - duhet të paraqes sistem funksional përmes të cilës lidhen të gjitha aktivitetet interne dhe eksterne të qytetit, ndërsa krahas zgjerimit të rrjeteve tjera furnizuese të infrastrukturës ngritet edhe cilësia e standardit jetësor. Kjo do të arrihet me përmirësimin e cilësisë së rrugëve ekzistuese, hapjen e lidhjeve të reja, ndërsa me qëllim të zvogëlimit të fluksit të transportit nëpër qytet duhet ndërtuar rrugët qarkore në drejtim të qendrave dhe regjioneve.

Qyteti është i vendosur në udhëkryqin e rrugëve të rëndësishme ndërmjet Prishtinës-Prizrenit dhe Ferizajit. Zhvillimi i trafikut dhe lidhjet e mira shpesh herë shprehen negativisht ngase qendra e qytetit stërngarkohet me trafik. Rrugat qarkore në drejtim të qendrave të lartpërmendura do ta lirojnë qytetin dhe qendrën nga kjo ngarkesë e trafikut.

3. Struktura e sipërfaqeve të gjelbra - përbënë hapësirat e gjelbra të cilat duhet të lidhen me njëra tjetrën duke krijuar sipërfaqe unike. Në këtë sistem gjelbërues bëjnë pjesë sipërfaqet e gjelbra në qytet, shiritat e gjelbër në të dy anët e lumit, gjelbërimi në dy anët e rrugës kryesore, sporti e rekreacioni dhe sipërfaqet gjelbëruese jashtë zonës së ndërtuar të qytetit.

Të gjitha hapësirat e lira publike në qytet duhet kombinuar me korridore të gjelbra, duke arritur nga periferitë në qendër të qytetit Korridoret e gjelbra si pika fillestare kanë ose male ose peizazhe të hapura, përderisa pika përfundimtare në qendër të qytetit është sheshi i qytetit. Lumi Shtimjanja që kalon përgjatë qytetit duhet rregulluar në dy anët me gjelbërim dhe të integrohet në zonën e gjelbër. Sipërfaqet përreth qendrës rinore duhet gjelbëruar dhe zhvilluar në zonë rekreative.

Harta 6. Konceptet e zhvillimit hapësinor urban



1.3. Zhvillimi hapësinor

Lokacioni i Shtimes rrëzë bjeshkëve të Carralevës e bënë qytetin e Shtimes unik me natyrën dhe atraktive për banorët e saj. Pjesa më e madhe e qytetit është ndërtuar në mënyrë të shpërndarë (disperse). Dendësimi i këtyre zonave do të mundësoj ndërtimin duke ruajtur tokën bujqësore me vlerë. Përmes planifikimit urban hapësira do të shfrytëzohet në mënyrë racionale. Kjo qon në drejtim të dendësisë të zonës urbane sepse dendësia për zonën urbane është e ultë. Sipërfaqja e hapësirës së banuar sot është 155 ha, me dendësi të banimit prej 58.7 banorë për hektar. Nga kjo shihet qartë se qytetit i Shtimes për nga struktura hapësinore është e shpërndarë dhe e zhvilluar në mënyrë horizontale. Rritja e popullsisë është një nga faktorët kryesor që ndikon në planifikim hapësinor dhe zhvillim socio-ekonomik të një zone të caktuar.

Projeksionet e rritjes së popullsisë për qytetin e Shtimes tregojnë se numri i banorëve në qytetin e Shtimes deri në vitin 2020 do të rritet për rreth 3000 banorë, ose nga 9100 në rreth 12000. Rritja e dendësisë do të ndikonte në ngritjen e cilësisë së jetës duke minimizuar shpenzimet në zhvillimin dhe instalimin e infrastrukturës, ruajtjen e sipërfaqeve bujqësore, zvogëlimin e distancave dhe aspekte tjera socio-ekonomike.

Gjatë analizës së situatës aktuale supozohet se deri në vitin 2020 duhet të rritet dendësia e banimit rreth 90 banorë për ha, me disa dallime mes qendrës dhe periferisë, ndërsa dendësia optimale mund të arrij në qendrën e saj, me rreth 150 banorë për ha. Edhe përkundër dendësisë së vogël vërehen tendenca të ndërtimit në pjesët periferike dhe përgjatë rrugëve kryesore të qytetit dhe jashtë qytetit. Por, konstatohet se zgjerimi i qytetit për këtë periudhë të planit zhvillimor do të kishte indikacione negative nga se dendësia e banimit nuk do të rritet. Kjo dendësi e ulët është jashtë kriterëve urbanen ndërsa si kundërveprim do të kishte shfrytëzimin jo racional të tokës dhe pasojat tjera që do ta përcillnin një zhvillim të tillë.

Prandaj, koncepti i zhvillimit hapësinor të qytetit të Shtimes për vitin 2020 duhet të orientohet në plotësimin e hapësirave të zbrazëta brenda qytetit, zgjerim të kujdesshëm në infrastrukturë, zgjerim të sipërfaqeve të gjelbra dhe ndërtim të lartë në qendër. Qyteti i Shtimes nuk ka kufij të definuar urban që e përkufizon tokën ndërtimore dhe sipërfaqet që nuk janë paraparë për ndërtim. Kjo mangësi pastaj shprehet me ndërtime të pakontrolluara në tokën bujqësore, përgjatë korridoreve strategjike, afër brigjeve të lumit, duke penguar kështu zhvillimin normal.

Zona urbane është sipërfaqe me kufij të caktuar në të cilën tokë është planifikuar ndërtimi urban. Përkufizimi i tokës ndërtimore lejon ndërtimin në bazë të rregullave të përcaktuara, si dhe definon hapësirat me përmbajtje specifike, sipërfaqet e gjelbra, sipërfaqet e transportit, etj.²³ Definimi më i qartë i zonës urbane zakonisht bëhet në suaza të kufirit kadastral. Përmes destinimit të sipërfaqeve dallohen zonat e ndërtuara

²³ Plani Hapësinor i Kosovës; Prishtinë. 2003.

dhe llojet tjera të përdorimit të tokës dhe bëhet definimi i tokës urbane. Kjo realizohet me tërheqjen e kufirit në mes të tokës ndërtimore dhe sipërfaqeve që nuk parashihen për zhvillim urban, ndërsa kjo shprehet me zhvillim të harmonizuar dhe kompakt të qytetit.

Përparësitë e qytetit kompakt janë të shumta:

- ✓ ruajtja e tokës bujqësore,
- ✓ minimizim i shpenzimeve në infrastrukturë,
- ✓ zvogëlim i distancave brenda vendbanimeve,
- ✓ ruajtja e sipërfaqeve të gjelbra,
- ✓ zvogëlim i emisioneve nga karburantet,
- ✓ qasje më e mirë në shërbime,
- ✓ kufij urban të qartë, etj.

Në zona të caktuara do të lejohet ndërtimi i lartë (qendra P+4) dhe lokacioni i tregut të gjelbër P+8. Për lokacione të reja të ndërtimit (zgjerim i zonës urbane) nuk do të ketë nevojë sepse ka hapësira të mjaftueshme të pa ndërtuara brenda territorit urban, përveç hapësirës së përcaktuar nga organet komunale për familjarët e dëshmorëve të rënë në luftë. Lokacioni i përcaktuar për këtë qëllim ndodhet në perëndim të qytetit, gjegjësisht në anën e majtë të daljes së rrugës për Prizren.

Sipërfaqe të pa ndërtuara brenda zonës urbane janë rreth 50 ha. Kjo hapësirë do të mundësoi vendosjen e 600 objekteve të banimit (shtëpi), ose 3000 banorë (5 anëtarë për ekonomi familjare) duke llogaritur deri 20 objekte banimi për ha, me dendësi prej 90 banor për ha. Ndërtesat nuk duhet të jenë më të larta se dy kate (P+2), përveç në zonat e përcaktuara me PZHU.

Parqet publike dhe hapësirat e gjelbra mungojnë në brendi të qytetit. Qyteti duhet të ofroj hapësirë ku banorët mund të shëtisin dhe relaksohen. Cilësinë e zhvillimit urban do ta rris zgjerimi i zonave të gjelbra dhe rregullimi i sipërfaqeve të gjelbra përgjatë brigjeve të lumit. Duhet të krijohen më shumë sipërfaqe të hapura por edhe lidhje më të mira me sipërfaqet e gjelbra përreth qytetit. Lumi Shtimjanja kalon në një pjesë të qytetit. Në gjendjen ekzistuese lumi fatkeqësisht është i ndotur nga lirimi i kanalizimeve individuale dhe hedhja e mbeturinave, pastaj janë bërë ndërtime mu në brigjet e tij që e keqësojnë gjendjen. Hapësira përgjatë lumit duhet rregulluar me gjelbërim, e ndriçuar dhe staza për lëvizjen e këmbësorëve, ndërsa shtrati duhet rregullohet edhe më tej. Hapësirat e lira publike në qytet duhet kombinuar me korridore të gjelbra, duke arritur nga periferia në qendër të qytetit. Korridoret lidhen me malet dhe peizazhet e hapura si dhe me lumin.

Për ta avancuar identitetin urban të Shtimes është më së e domosdoshme të përfordhet qendra e qytetit. Të gjitha funksionet e rëndësishme do të përqendrohen në qendër. Dendësia dhe lartësia e ndërtesave do të jetë më e lartë se në zonat përreth. Në të dy anët e rrugës kryesore që kalon në qendër, të zhvillohet gjelbërimi dhe trotualet për lëvizjen e qytetarëve. Përgjatë qendrës, në përdhes të objekteve mund të zhvillohet tregtia dhe aktivitete tjera ekonomike e shërbyese duke e shndërruar atë në qendër atraktive e vitale për vizitorët dhe banorët e saj. Aty mund të vendosen zyra e biznese të vogla, ndërsa

bizneset e mëdha vendosen në qendrën industriale në jug-perëndim të qytetit. Qarkullimi i automjeteve do të zvogëlohet dukshëm përgjatë qendrës nga se shkakton ngarkesë të madhe, ndotje të ajrit me gazra të liruara, pluhur dhe zhurmë. Këtë do ta mundësoi vazhdimi i rrugës qarkore në drejtim të Prizrenit dhe ndërtimi i qarkores në drejtim të Ferizajit.

Përforcimi i qendrës së qytetit. Për identitetin urban të qytetit të Shtimes rëndësi të veçantë ka përforcimi i qendrës, me që rast ajo do të rigjenerohet. Në këtë qendër janë të përqendruara funksione të rëndësishme urbane. Pjesën qendrore të qytetit e përbënë bulevardi qendrorë që shtrihet përgjatë rrugës Tirana. Kjo do të jetë pjesa qendrore dhe sheshi i qytetit, me gjelbërim në të dy anët e rrugës, e cila lidhet me parkun e qytetit në lindje, gjegjësisht në dalje të qytetit të Shtimes. Dendësia e ndërtimit dhe lartësia e objekteve është më e theksuar se në zonat përreth.

Lumi Shtimjanja që kalon afër qendrës është rregulluar me staza dhe gjelbërim, ndërsa rrjedha lumore bëhet atraksion për banorët e qytetit. Për të ofruar shërbime funksionale dhe qarkullim të lirë të banorëve, dhe për ta liruuar presionin nga trafiku është ndërtuar rruga qarkore në drejtim të Prizrenit dhe Ferizajit.

Zhvillimi dhe dendësia e ndërtimit. Pjesa më e madhe e qytetit është zhvilluar në mënyrë disperse. Plotësimi i zbrazëtirave brenda kufirit urban do të mundësoj ndërtimin duke ruajtur tokën bujqësore me vlerë dhe duke kompaktësuar qytetin. Ndërsa, me rastin e zgjerimit të mëtejshëm të qytetit (pasi të plotësohen zbrazëtirat), prioritet duhet ti jepet sipërfaqeve joproduktive përreth qytetit.

II. STRUKTURA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

II.1. ZHVILLIMI EKONOMIK

Strukturat ekonomike urban në qytetin e Shtimes përbehen kryesisht prej ndërmarrjeve-objekteve bujqësore-fermave, tregtare si tregtisë me shumice dhe pakice, industriale dhe shërbyese. Të gjitha këto lloje të objekteve kanë specifikat e tyre në dimensionin e hapësirës dhe formës së nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të tyre prodhues, tregtare ose shërbyes. Edhe në qytetin e Shtimes bujqësia është një ndër sektorët ekonomik shumë të rëndësishëm. Qyteti, sidomos periferia e tij merret edhe me aktivitete bujqësore-blegtorale të cilat janë të shprehura në dy forma, si biznese ose ndërmarrje ekonomik por edhe si aktivitet ndihmës në ekonominë familjare. Qyteti ka fond të konsiderueshëm të tokës bujqësore e cilat kryesisht shtrihet në mes të rrugëve magjistrale M25 dhe M25.2 si dhe rrugës tranzitore të qytetit. Ky fond i tokës do të luaj një rol të rëndësishëm në zhvillimin e agrobiznesit në qytetin e Shtimes dhe do të jetë i orientuar kryesisht në prodhimin e fidanëve, luleve dekorative, perimtarisë intensive (me sera) si dhe blegtorisë intensive.

Lidhja e mirë në rrjetin e transportit nacional dhe afërsia me qendrat e mëdha urbane do të jetë faktorë i stimulimit të zhvillimit të bujqësisë dhe industrisë ushqimore bazuar në ofrimin e produkteve ushqimore kualitative. Industria ushqimore është një ndër aktivitetet shumë të rëndësishme në zhvillimin ekonomik të komunës së Shtimes. Përpunimi i lëndëve të para që ofron komuna e Shtimes për industri janë kryesisht prodhimet bujqësore, blegtorale dhe minerare. Prandaj orientimi i industrisë në këto fusha do e ndihmoj shumë edhe bujqësinë në përgjithësi por edhe minierat sipërfaqësore (gurthyesit) të cilët më pastaj do të kenë ndikim më pak të dëmshëm mjedisorë. Funksionalizimi i parkut industrial në qytetin e Shtimes do ti ndihmoj bizneset me karakter prodhues në ofrimin e të gjitha shërbimeve të nevojshme për aktivitetet e tyre si dhe do të ndikoj në zhvillimin e qytetit të Shtimes, krijimin e vendeve të punës, rritjen e të hyrave në buxhetin komunal, rritjen e shkallës së investimeve lokale etj.

Orientimi i shfrytëzimit të resurseve minerare në industrinë ndërtimore do të ndihmoj që përfitimet të jenë më të mëdha por njëherit edhe shkalla e degradimit të mjedisit do të jetë më e vogël.


Ndërtimi i muzeut lokal me vendndodhje në Kompleksin Memorial “Masakra e Reçakut” i cili do të prezantoj pamje vizuale të ngjarjes, në formë të filmit, fotografive, broshurave informative, do ta informoj turistin më shumë dhe më drejt për tërë ngjarjen dhe do ta bëj vizitën shumë më shumë atraktive në këtë kompleks. Zhvillimi modern i moteleve, restoranteve dhe pishinave do të ndihmojë jo vetën në ofrimin e shërbimeve për nevojat e banorëve të Shtimes, por do të ketë ndikim në rritjen e mundësive për punësim dhe zhvillim ekonomik të qytetit.

Ndërtimi i stacionit të autobusëve në qytetin e Shtimes është projekt i cili ka të bëjë me transportin në komunën e Shtimes në përgjithësi, i cili do të ofroj shërbime të kënaqshme për banorët dhe kompanitë e transportit në komunën e Shtimes si dhe do të mundësoj një lidhje më të koordinuar të linjave të transportit nga qyteti në vendbanimet

tjera të komunës si dhe do e bëj lidhjen e qytetit edhe me qendrat e tjera urbane në Kosovë.

Ndërtimi i stazave për biçiklizëm do të ndihmoj lëvizjen e qytetarëve brenda qytetit si dhe do të mbuloj kryesisht transportit urban në qytetin e Shtimes. Kjo nismë e transportit me biçikleta fillimisht nuk do të pranohet në tersi por më vonë do të krijohet shprehia dhe nevoja që biçikleta do të jetë zgjidhja më e mirë e transportit në këtë qytet. Kjo edhe për faktin që qyteti ka një rreze prej 1000m e cila nga dy skaje periferike nuk kalon më shumë se 2km distancë dhe mund të mbulohet lehtë nga transporti i biçikletave. Duke harmonizuar të gjitha sfidat që kanë të bëjnë me ekonominë e qytetit në Shtimes si dhe me kornizën e zhvillimit urban të qytetit të Shtimes apo konceptet zhvillimore për këtë qytet, dalin tri struktura kryesore ekonomike:

- Struktura mikste banim-afarizëm
- Struktura mikste banim-bujqësi
- Struktura industriale, zona industriale “Teknopolis”

Harta 7: Potencialet e zhvillimit ekonomik

Struktura mikste (banim-afarizëm) është e përbërë kryesisht prej shtëpive të banimit dhe bizneseve afariste të cilat ndodhen në katet e para apo përdhese të ndërtesave (shtëpive) dhe banimi në katet e sipërme. Në qytetin e Shtimes janë të koncentruar rreth 70% e bizneseve dhe 65% e punëtorëve që ka komuna e Shtimes. Kjo strukturë krijon një formë kryesisht lineare dhe përcjell rrugët më të rëndësishme të qytetit. Kjo zonë do të ketë edhe në të ardhmen këtë karakter mikst mirëpo do të rehabilitohet në mënyrë që do ti ofroj bizneseve hapësirë të mjaftueshme për ushtrimin e aktiviteteve të tyre.

Struktura mikste (banim-bujqësi) është e përbërë kryesisht prej ekonomive familjare të cilat merren edhe me aktivitetet primare apo bujqësore dhe përbën kryesisht zonën e cila shtrihet në pjesët periferike të qytetit të Shtimes. Pjesëmarrja e qytetit të Shtimes në blegtori, kryesisht me gjedhe është 9% të pjesëmarrjes së përgjithshme të tyre në komunë. Përveç tregtisë, shërbimeve dhe industrisë edhe bujqësia ka një rol shumë të rëndësishëm në të ardhurat e ekonomive familjare të një pjesë të konsiderueshme të banorëve të Shtimes. Numri i gjedheve në qytetin e Shtimes është 394 krerë, kryesisht gjedhe të mbajtura për nevoja familjare. Kjo strukturë edhe në të ardhmen do të ketë këtë funksion por do të rehabilitohet si për nga funksioni ashtu edhe nga forma. Do të pajiset me infrastrukturë adekuate dhe do ti nënshtrohet plotësisht rregullave urbane të ndërtimit, kurse në aspektin funksional do të investohet në bujqësi ose blegtori intensive, duke bërë shtimin e sipërfaqeve nën sera dhe kultura perimtarie, krijimin e sistemit të ujitjes aty ku është e mundur (kryesisht përgjatë lumit Shtimjanja), përzgjedhjen e racës së mirë të gjedheve të mbajtura si dhe zhvillimin e fermave për qumësht dhe trashje (për industri të mishit).

Struktura industriale-Parku industrial në Shtime do të ketë një sipërfaqe prej 17ha të cilat do të kenë 9 objekte industriale dhe edukative, e cila në fazën fillestare parashihet ti punësoj 300 punëtorë. Disa biznese të cilat priten të vendosen në këtë park industrial janë përfaqësi të pjesëve të Mercedesit, Audisë dhe BMW, gjithashtu edhe një shkollë e lart e menaxhimit të turizmit dhe mikpritjes, si dhe një qendër për inovacione dhe teknologji.



II.2. Destinimi i sipërfaqeve

Zona e qendrës shtrihet në të dy anët e Rrugës Tirana duke filluar nga Sheshi e deri te shkolla fillore dhe qendra e shëndetit. Qendra e qytetit të Shtimes është e rrethuar me objekte të rëndësishme, duke filluar nga qendra komunale e deri te stacioni zjarrfikësve. Zonat e banimit me aktivitete tjera e rrethojnë qendrën e qytetit. Rrugët kryesore në drejtim të qendrës, si dhe disa rrugë anësore ndaj qendrës, janë të rrethuara nga zonat për përdorim të përzier. Qendrat sekondare e plotësojnë qendrën e qytetit, si: Muzeqinë, Carralevë dhe Petrovë. Zonat e banimit zhvillohen në të gjitha anët e qendrës së qytetit, ndërsa zona e parkut industrial shtrihet në jug-perëndim të qytetit, në drejtim të rrugës për Ferizaj. Strukturën urbane të Shtimes në të ardhmen e përbëjnë edhe sipërfaqet e zbrazëta brenda kufirit urban të cilat do të plotësohen me ndërtime.

Destinimi i sipërfaqeve trajtohet në suaza të kufirit kadastral të qytetit të Shtimes, në të cilën hynë sipërfaqet e ndërtuara, transporti, sipërfaqet e veçanta dhe sipërfaqet e gjelbra.

Parametrat e gjendjes aktuale (profili) të shfrytëzimit të tokës në qytetin e Shtimes tregojnë se, sipërfaqja e tokës ndërtimore kryesisht është e destinuar për banim, duke përfshirë një sipërfaqe prej 180 ha, nga e cila, 155 ha ose 77.7 ha i takojnë zonës së banimit, hapësirat me përmbajtje publike janë 12.33 ha, ndërsa sipërfaqja e zonës industriale përfshinë 12.74 ha.

Sipërfaqja e ndërtuar përfshinë hapësirën prej 180 ha,

sipërfaqja e transportit zë hapësirën prej 13.56 ha,

sipërfaqe të veçanta janë 5.62 ha, (tregu i gjelbër, varrezat, pika karburanti, trafostacioni)

sipërfaqe të pa ndërtuara apo hapësira të gjelbra janë 1082.7 ha.

Sipërfaqja e ndërtuar, në periudhën kohore të **planifikuar** sipas Planit Zhvillimor Urban (2009-2020) do të jetë **249.9** ha, ose për 70 ha më shumë. Nga sipërfaqja e përgjithshme e ndërtuar prej **249.9** ha, pjesën më të madhe e zë funksioni i banimit me 184.7 ha, ose 73.88%, pastaj pjesa qendrore 25.09 ha, (banim dhe shërbime), institucionet e shërbimeve publike do të zënë sipërfaqen prej 13.68 ha, ndërsa sipërfaqja e zonës industriale dhe bizneseve do të arrij në 50.44 ha.

Sipërfaqja e ndërtuar përfshin hapësirën prej **249.9** ha.

sipërfaqja e transportit zë hapësirën prej 37.35 ha.

sipërfaqe të veçanta janë 13.72 ha, (tregu i gjelbër, varrezat, pika karburanti, trafo stacioni)

sipërfaqe të pa ndërtuar apo të hapësira të gjelbra janë 981.03 ha.

Sipërfaqet e transportit do të rriten në pjesën urbane dhe ndërtimin e qarkoreve jashtë zonës urbane me qëllim të rritjes së efikasitetit të lidhjeve, nga 13.56 ha, në 37.35 ha (me indexin 275.4).

Tabela 14. Bilanci i sipërfaqeve sipas mënyrës së përdorimit

Sipërfaqet sipas mënyrës së përdorimit	Sipërfaqe në ha	Sipërfaqe në %
Banim i përzier	108.88	43.57
Banim i përzier-zgjerim	50.73	20.30
Zona e qendrës	25.09	10.04
Objekte edukative-arsimore	3.95	1.58
Shëndetësi	5.26	2.10
Institucione kulturore dhe religjioze	2.74	1.09
Administratë	1.88	0.75
Shërbime tjera publike	0.93	0.37
Industri/biznese	50.44	20.18
Gjithsej sipërfaqe e ndërtuar	249.9	100
Korridore transporti	35.43	94.86
Parking	1.26	3.37
Stacion i autobusëve	0.66	1.76
Gjithsej sipërfaqe transporti	37.35	100

Tregjet	2.05	14.94
Tregu i gjelbër	0.35	2.55
Varreza	9.92	72.30
Pikë karburanti	0.88	6.41
Trafo stacion	0.52	3.79
Gjithsej sipërfaqe e veçantë	13.72	100
Park	18.72	1.9
Sport dhe rekreacion	34.26	3.49
Korridor gjelbërimi	16.22	1.65
Bujqësi	698.21	71.17
Pyll	19.34	1.97
Lum	2.0	0.20
Ripyllëzim	13.18	1.34
Sipërfaqe e rezervuar për industri	64.11	6.53
Sipërfaqe të lira	114.99	11.72
Gjithsej sipërfaqe e gjelbër	981.03	100
Sipërfaqja e përgjithshme e K. Kadastrale	1282	100

Sipërfaqet e gjelbra do të rriten dukshëm në qytet ngase qyteti i Shtimes nuk disponon me sipërfaqe të rregulluara gjelbëruese, si: parku, sipërfaqet për sport dhe rekreacion, korridoret dhe shiritat e gjelbër përgjatë lumit dhe rrugës së qendrës, etj. Këto sipërfaqe do të arrijnë në rreth 50 ha. Zgjerimi i hapësirës urbane dhe infrastruktura do të zhvillohen kryesisht në sipërfaqet joproductive. Ndërsa, sipërfaqet bujqësore do të mbeten pothuajse në vlera të njëjta.

Struktura urbane e qytetit të Shtimes përbëhet nga njësi të caktuara, përmes të cilës shihet destinimi i sipërfaqeve (shfrytëzimi i tokës):

Zona e qendrës - siguron hapësirë të mjaftueshme për banim, biznese, tregti, administratë dhe aktivitete tjera. Qendrat sekondare plotësojnë qendrën e qytetit me shërbime lokale.

Aktivitetet që do të zhvillohen janë:

- ✓ Objekte banimi
- ✓ Zyra, administratë dhe biznese,
- ✓ Tregti me pakicë,
- ✓ Përdorimet tjera joshqetësuese komerciale,
- ✓ Vendparking për automjete.

Zonat me destinim të përzier, janë zona që sigurojnë hapësirë për banim dhe aktivitete të domosdoshme që përcjellin funksionin e banimit, pastaj aktivitete komerciale të cilat nuk e pengojnë njëra tjetrën, si:

- ✓ Objekte banimi,
- ✓ Biznese të vogla,
- ✓ Tregtia me pakicë,
- ✓ Përdorimet tjera joshqetësuese komerciale,
- ✓ Objekte kulturore, shëndetësore, fetare, sociale, sportive, argëtimi, etj.

Zonat për përdorim të përbashkët (Hapësirat me përmbajtje publike)- sigurojnë hapësirë për funksione publike, si: administratë, shkolla, çerdhet e fëmijëve, qendrat e kujdesit shëndetësorë, qendrat kulturore, etj.

Zona industriale dhe bizneset- sigurojnë hapësirë për të gjitha llojet komerciale, kryesisht aktivitete që nuk janë të lejuara në zonat tjera. Në këto zona parashihen aktivitete si në vijim:

Të gjitha llojet e ndërmarrjeve komerciale dhe industriale, ndërtesat e dyqaneve, depot dhe ndërmarrjet publike,

Biznes, zyra dhe administratë për ndërmarrjet,

Pika furnizuese karburantesh,

Objekte dhe hapësira sportive.

Sipërfaqet e transportit-paraqesin korridore ku qarkullojnë automjetet, këmbësorët dhe çiklistët, si dhe sipërfaqet e parkimit.

Sipërfaqet e gjelbra-paraqesin hapësira për sport dhe rekreacion, hapësira për pushim-park, korridore gjelbërimi, shirita të gjelbër mbrojtës, sipërfaqe bujqësore, pyll, sipërfaqe me ujë.

Sipërfaqet e veçanta (specifike)-janë sipërfaqe të cilat sigurojnë hapësirë për përdorime të ndryshme: Tregu i gjelbër, pika furnizuese karburantesh, varreza, trafostacion, etj.

II.3. BANIMI

Zhvillimi demografik i qyteti të Shtimes, si një proces kompleks është shtjelluar sipas disa elementeve kryesore siç janë: numri i popullsisë, dendësia, shtimi natyror, strukturat dhe migrimet. Trajtimi i këtyre temave është me rëndësi edhe për parashikimin demografik. Në procesin e planifikimit rol të veçantë luan edhe parashikimi i popullsisë për të ardhmen. Kjo nga fakti se i tërë ky planifikim behet për njerëzit që jetojnë sot në qytetin e Shtimes si dhe për gjeneratat që vinë. Në fakt të dhënat që janë shfrytëzuar janë vlerësime të bazuara në metoda të ndryshme, dhe ato do të jenë një bazë e mirë që mund ti shfrytëzojmë edhe për llogaritjen e parashikimit demografik për qytetin e Shtimes deri në vitin 2020.

Gjatë vlerësimit të popullsisë për qytetin e Shtimes deri në vitin 2020 janë llogaritur dy komponentët themelore që ndikojnë drejtpërdrejtë në rritjen demografike siç janë: shtimi natyror dhe migrimi. Në vazhdim do të paraqitet ky parashikim sipas formulës:

$$P_a = P_o \times [(S_n + S_m) \times V / 100] + 1$$

Shpjegimet e simboleve:

P_a = parashikimi i popullsisë për vitin 2020

P_0 = vlerësimi i popullsisë për vitin 2008

S_n = shkalla vjetore e shtimit natyrorë

S_m = shtimi vjetorë nga migrimi

V = vitet e llogaritura deri në vitin 2020

Parashikimi i numrit të popullsisë për qytetin e Shtimes për vitin 2020:

$$P_a = P_0 \times [(S_n + S_m) \times V / 100] + 1$$

$$P_a = 9100 \times [(1.62 + 1.17) \times 12 / 100] + 1 =$$

$$= 9100 \times 1.3348 = 12146$$

Sipas këtyre llogaritjeve del se numri i popullsisë për qytetin e Shtimes do të jetë 12 146 banorë në vitin 2020.

Në bazë të parashikimeve demografike mund të konstatohet se numri i ekonomive familjare do të shtohet për 500, nëse llogarisim numrin e anëtarëve nga 6 për ekonomi familjare, ndërsa gjithnjë po shkohet në drejtim të zvogëlimit të anëtarëve për ekonomi familjare prandaj në këtë rast ne llogarisim në 5 anëtar për ekonomi familjare. Nëse kalkulohet me parametrat e fundit qyteti i Shtimes do të ketë nevojë edhe për ndërtimin e rreth 600 shtëpive në të cilat do të vendoseshin këta ekonomi familjare. Sipërfaqja e nevojshme për ndërtimin e këtyre objekteve, duke përfshirë edhe infrastrukturën dhe hapësirat tjera të nevojshme, do të arrij në rreth 70 ha.

Me rastin e zhvillimit të zonës urbane plani do të mbështet parimin e dendësimit me qëllim të arritjes së dendësisë normale për zonat urbane, duke favorizuar zonën qendrore të qytetit (indin urban). Kjo do të reflektohet në funksionalizimin e shërbimeve dhe qasjen më të lehtë të banorëve me distanca më të vogla. Gjatë analizës së situatës aktuale supozohet se deri në vitin 2020 duhet të rritet dendësia e banimit rreth 90 banorë për ha, me disa dallime mes qendrës dhe periferisë, ndërsa dendësia maksimale mund të arrij në qendrën e saj, me rreth 150 banorë për ha. Në zona të caktuara do të lejohet ndërtimi i lartë (qendra P+4) dhe lokacioni i tregut të gjelbër P+8 (1.14 ha). Me këtë lloj ndërtimi qyteti i Shtimes do të ndryshoi identitetin urban dhe do të zhvillohet krahas qendrave tjera urbane të Kosovës. Deri tani qyteti është zhvilluar horizontalisht-banim individual, ndërsa me planin zhvillimor urban qyteti do të ndërroi strukturën e banimit, nga banimi i ulët individual në banim kolektiv-të lartë. Raporti në mes banimit të ulët dhe atij të lartë të mesëm do të jetë 80% me 20%. Ndërsa dendësia minimale do të jetë rreth 60 b/ ha (periferia). Ndërtesat nuk duhet të jenë më të larta se dy kate (P+2), përveç në zonat e përcaktuara me PZHU.

II.4. INFRASTRUKTURA SOCIALE

Zhvillimet sociale në zonën urbane të Shtimes do të shtrihen në atë mënyrë që të gjithë qytetarët të kenë qasje në shërbime publike në mënyrë të barabartë. Kjo do të arrihet përmes krijimit të kushteve për arsim, shëndetësi, kulturë, sport dhe shërbime publike administrative për të gjithë qytetarët.

III.4.1. Arsimi

Arsimimi si një ndër komponentët bazë për zhvillimin e një shoqërie, do të sigurohet për të gjithë qytetarët. Në zonën urbane, aktualisht ndodhën dy shkolla: një shkollë e mesme dhe një shkollë fillore. Këto dy shkolla nuk plotësojnë kushtet për mësim. Në të ardhmen shkollës së mesme do ti shtohet edhe një aneks ndërsa, do të ndërtohet një shkollë fillore e cila do ti plotësojë kushtet edhe për 10 vitet e ardhshme. Të gjitha shkollat do të pajisen me infrastrukturë bashkëkohore.

Po ashtu, do të ketë nevojë për organizimin e trajnimeve të kohëpaskohshme për personelin arsimor.

Shkolla speciale-Në këtë shkollë me nevoja të veçanta mungon kopshti me lodra ku nxënësit do të mund të kalojnë kohën. Në vitet në vijim është e nevojshme ndërtimi i një kopshti me lodrash në oborrin e shkollës me nevoja të veçanta. Ky kopsht do të duhej të ndërtohet në atë mënyrë që në asnjë formë të mos mund të rrezikohet jeta e këtyre nxënësve me nevoja të veçanta.

Çerdhe-kopshte-Aktualisht nuk ka asnjë çerdhe për fëmijë. Në të ardhmen janë të nevojshme dy çerdhe për fëmijë. Këto çerdhe do të jenë të kapacitetit 200-300 fëmijë²⁴.

Po ashtu, është e nevojshme që të ndërtohen edhe hapësira për kopshte me lodra për fëmijë. Vendet e preferuara për kopshte janë oborret shkollore (aty ku ka hapësirë të mjaftueshme dhe nuk pengohet procesi mësimor) dhe hapësira të tjera publike.

II.4.2. Shëndetësia

Shoqëri e shëndosh, perspektivë për të ardhmen.

Në zonën urbane aktualisht ndodhet Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, e cila afron shërbime për të gjithë qytetarët. Kjo qendër ka nevojë për specialist të mjekësisë familjare dhe një stomatolog.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare – për 10 vitet e ardhshme do të ketë nevojë për 10 mjek dhe 20 teknik (aktualisht ka më shumë teknik medicinal se sa i duhen).

Objekti i kësaj qendre kryesore familjare kërkon një renovim në mënyrë që shërbimet shëndetësore të jenë në nivelin e duhur.

Instituti special

Ky Institut special i cili gjendet në zonën urbane, luan një rolë të rëndësishëm në rehabilitimin e personave me retardime të rënda. Edhe pse ky institut ndodhet në territorin e Shtimes, administrohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministria e Mirëqenies dhe Punëve Sociale. Në të ardhmen duhet pasur parasysh zgjidhjen e statusit të kompetencave të këtij institucioni.

²⁴ Sipas projeksioneve të popullsisë në komunën e Shtimes edhe për 10 vite të ardhshme grup-mosha e 0-5 vjet nuk pritet të ketë ndryshime të theksuara, ndryshime do të ketë në zhvillimet shoqërore prandaj, ndërtimi i dy çerdheve është i domosdoshëm.


II.4.3. Kultura, sporti dhe rekreacioni

Për zhvillimin e aktiviteteve kulturore në zonën urbane do të duhej të krijohen këto kushte;

- ✓ Të ndërtohet një shtëpi e kulturës në zonën urbane dhe teatri i qytetit.
- ✓ Të zgjerohet hapësira e objektit të bibliotekës ose të vendoset në një lokacion tjetër brenda zonës urbane me status të përhershëm të bibliotekës.
- ✓ Renovimi dhe ruajtja e muzeut të qytetit do të duhej të ndodhte në të ardhmen por njëkohësisht dhe pasurimi me vlera kulturore të të gjitha periudhave kohore e posaçërisht të periudhës më të re (luftës së UÇK-së) .
- ✓ Organizimi i ngjarjeve kulturore do të ndodh sepse në këtë mënyrë kujtojmë, ruajmë të kaluarën dhe ndërtojmë të ardhmen.

Mund të thuhet lirisht se sporti dhe rekreacioni janë një ndër fushat më të pëlqyera nga të gjitha shtresat e shoqërisë. Krijimi i kushteve më të mira për sport dhe rekreacion është masë e nevojshme. Kjo mund të bëhet përmes krijimit të; hapësirave sportive, ndërtimit të sallës së sporteve, krijimit të hapësirave të gjelbëruara (parku i qytetit), nën-qendra të vogla në kuadër të qendrës urbane etj.

Harta 9. Institucionet arsimore, kulturore dhe shëndetësore



II.5. SHËRBIMET ADMINISTRATIVE DHE PUBLIKE

Shërbimet administrative luajnë një rol të rëndësishëm në jetën shoqërore. Ofrimi i shërbimeve me kohë në administratën publike është prioritet i rëndësishëm. Shërbimet efikase në administratën komunale do të arrihen përmes sistemit elektronik. Të gjithë qytetarët do të kenë mundësi për informacione përmes sistemit elektronik. Për çdo


qytetar që do të merr shërbime apo konsulta do të rezervohet koha paraprakisht. Kjo është mundësi e mirë që të mos krijohet tollovi tek zyrat përkatëse për ofrimin e shërbimeve publike dhe çdo zyrtar përgjegjës do të jetë i vetëdijshëm për punët që e presin. Në këtë mënyrë do të ofrohen shërbime të shpejta më kualitative dhe do të rritet niveli i transparencës. Kjo mënyrë e marrjes së shërbimeve do të aplikohet te të gjitha institucionet të cilat ofrojnë shërbime publike për qytetarët.

Gjithashtu, themelimi i gjyqësorit komunal, do të duhej të realizohej në periudhën e afërt kohore.

II.6. ORGANIZIMI ADMINISTRATIV TERRITORIAL

Administrimi territorial i qytetit të Shtimes është i organizuar në dy bashkësi lokale. Numri i popullsisë në qytetin e Shtimes deri në vitin 2020 do të rritet për 3000 banorë dhe në bazë të prognozimit demografik qyteti do të ketë rreth 12000 banorë. Për këtë numër të popullsisë nuk do të ketë nevojë të formohen qendra të reja por ndihet nevoja për riorganizim hapësinor, me qëllim të qasjes më të mirë të popullsisë në këto qendra. Krahas rritjes së popullsisë ndihet nevoja edhe për institucione dhe shërbime shtesë për ti plotësuar kërkesat e banorëve, prandaj plani propozon hapësira të reja publike në lokacione të cilat i përgjigjen rrezes gravituese në distanca normale. Kjo formë e organizimit hapësinor urban do të jetë më e favorshme nga se popullsia ka qasje më të mirë duke shfrytëzua qendrën dhe rrugën kryesore. Secila nga këto bashkësi duhet të ketë përafërsisht numër të barabartë të banorëve. Kjo do të mundësonte një funksionalizim më të mirë të bashkësive dhe qytetit në përgjithësi, nga se më lehtë do të administrohet dhe do të funksionojë zhvillimi urban. Bashkësitë lokale urbane do të jenë: Bashkësia lokale I, që përfshinë pjesën perëndimore të qytetit dhe Bashkësia lokale II, që përfshinë pjesën lindore të territorit urban.

Harta 10. Organizimi administrativ



II.7. TRAFIKU DHE TRANSPORTI


Rruga magjistrale Prizren – Prishtinë, i krijon mundësi të mira komunikimi zonës urbane, mirëpo edhe njëkohësisht ndikon në frekuentimin mjaft të madh të automjeteve transportuese duke shkaktuar ngarkesë trafiku. Për të bërë shkarkimin e kësaj zone nga transporti regjional propozohet që të behet:

- Asfaltimi i rrugës nga nyja që lidhet me rrugën transit deri tek zona industriale (përball MAKSI-it), me gjatësi prej 2.7km.
- Gjithashtu përgjatë segmentit të rrugës magjistrale, regjionale dhe rrugëve të tjera që i lidhin vendbanimet propozohet që të ndërtohen staza për çiklistë dhe rregullim të trotuareve.
- Asfaltimi i rrugëve në pjesën e planifikuara për zgjerimin e zonës urbane me gjatësi prej 8.84 km.
- Ndërtimi i stacionit të autobusëve
- Ndërtimi i trotuareve nga kufiri me komunën kadastrale të Belincit deri tek nyja në rrugën transite në kufi me Komunën kadastrale të Davidoc-it, me gjatësi prej 3.7km në të dy anët e rrugës.
- Zgjerimi i rrugës urbane në qendrën e zonës urbane me gjatësi prej 1.6km

Prioritetet strategjike janë:

Rritja e sigurisë në trafik (parkingjet, shtigjet për çiklist dhe këmbësorë, sinjalizimi etj.


Harta 11. Rrjeti i rrugëve



II.8.RRJETI I UJËSJELLËSIT

Rrjeti i ujësjellësit në zonën urbane është i shtrirë mjaft mirë dhe krijon mundësi të qasjes së të gjithë banorëve në ujësjellësin publik. Në këtë segment propozohet që të ndërtohet rrjeti i furnizimit me ujë të pijes për zonat ku planifikohet zgjerim i zonës urbane me gjatësi prej 8.9km.


Harta 12. Rrjeti i ujësjetllësit



II.9. RRJETI I KANALIZIMIT

Rrjeti i kanalizimit në zonën urbane është i shtrirë mjaft mirë dhe krijon mundësi të qasjes së të gjithë banorëve në sistemin e kanalizimit publik. Në këtë segment propozohet që të ndërtohet rrjeti i kanalizimit të ujërave të zeza për zonat ku planifikohet zgjerim i zonës urbane me gjatësi prej 7.41 km, si dhe të ndërtohet paralelisht sistemi i kanalizimit për ujëra të bardha për tërë sipërfaqen e zonës urbane.

Harta 13. Sistemi i kanalizimit



II.10. PEIZAZHI DHE MJEDISI

II.10.1. Peizazhi

Struktura e gjelbër e qytetit të Shtimes lehtëson kërkesat e banorëve për pushim dhe rekreacion. Zonat e lidhura mes veti formojnë një ambient të përshtatshëm, duke freskuar mjedisin urban dhe duke krijuar mikroklimë të përshtatshme urbane. Sipërfaqet e gjelbra, fushat e sportit, dhe hapësirat tjera të hapura në qytet janë të lidhura me njëra tjetrën dhe formojnë tërësi të gjelbër unike. Korridoret e gjelbra zhvillohen nga peizazhi i hapur në drejtim të qendrës së qytetit. Lumi që kalon përgjatë qytetit paraqet korridor të gjelbër që lidhet me parqet dhe hapësirat e lira. Pika fillestare dhe pikvështrimi i këtij sistemi është parku me një bezen uji në lindje të qytetit (mbi pisha), ndërsa pika përfundimtare për këtë sistem të gjelbër është shiriti i gjelbër i qendrës së qytetit që vazhdon deri te sheshi. Ambienti i përshtatshëm gjelbërues përgjatë sheshit, që lidhet me shiritin gjelbërues të lumit, bëhet tërheqës dhe pikë takimi për banorët e qytetit. Sipërfaqet tjera gjelbëruese ofrojnë mundësi rekreative për banorët e rrethinës së tyre. Sipërfaqet gjelbëruese zhvillohen edhe gjatë rirregullimit të pjesëve të qytetit me plane rregullative. Në lindje të qytetit ndërtohet një akumulacion i cili do të shndërrohet në pikë rekreative për banorët e qytetit dhe rrethinës, ndërsa ambienti i gjelbër i pyjeve ofron freski, ajër të pastër dhe pejzazh atraktiv.

II.10.2. Mjedisi

Cilësia e mjedisit urban vlerësohet në bazë të shumë faktorëve e dukurive me frekuencë dhe amplitudë të ndryshme. Shtimi me i shpejtë i transportit, shfrytëzimi intensiv i burimeve të ndryshme, janë kërcënimet kryesore për mjedisin, shëndetin dhe mirëqenien. Keqësimi i cilësisë së ajrit për shkak të zhvillimit të vrullshëm të sektorit të transportit, të përdorimit në shkallë të madhe të automjeteve të përdorura, administritimit jo të mirë të hedhurinave urbane, zhvillimit të sektorit të ndërtimeve etj, është një dukuri e zakonshme. Politikat e zbatuara dhe masat e marra për mbrojtjen e cilësisë së ajrit kanë për qëllim që të ulin përqendrimet e ndotësve në shtresat e ulëta të atmosferës deri në vlera që nuk janë të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Ky synim mund të arrihet vetëm nëpërmjet një pakësimi të vazhdueshëm të sasisë totale të ndotësve që shkarkohen në ajër nga të gjitha kategoritë e burimeve të ndotjes së ajrit. Furnizimi me ujë në qytet është i kënaqshëm në bazë të analizave paraprake por ende ka për tu bërë si në cilësi ashtu edhe në sasi. Administrimi i hedhurinave të ngurta urbane përbën një hallkë shumë të dobët dhe një sfidë të vërtetë mjedisore si për autoritetet ashtu edhe për shoqërinë civile. Në komunën e Shtimes nuk ka asnjë impiant të trajtimit të hedhurinave të ngurta urbane. Ato barten në Deponinë Regjionale në Ferizaj mirëpo mjedise të ndotura urbane nga hedhurinat ilegale janë vërejtur në disa pjesë të qytetit. Ujërat e zeza shkarkohen drejtpërdrejt në mjedis pa asnjë lloj trajtimi paraprak. Disa lagje i hedhin mbeturinat në lumë që përshkojnë qytetin, e pjesa tjetër me kanalizim të organizuar në dalje të qytetit i shkarkojnë drejtpërdrejt në lumin Shtimjanja.


Sipërfaqet e gjelbra në qytet po vijnë duke u zvogëluar vazhdimisht si pasojë e ndërtimeve po njëherit edhe si pasojë e mos planifikimit të oazave të gjelbra në qytet. Edhe pse ligji tashmë ndalon në mënyrë taksative ndërtimet në sipërfaqet e gjelbra ka raste jo të pakta të thyerjes së tij.

Problemet e administrimit mjedisor menaxhohen pak ose aspak nga organet e pushtetit lokal të cilët për shkak të problemeve të shumta sociale dhe të mungesës së infrastrukturës janë përgjithësisht indiferentë ndaj mbrojtjes së mjedisit.

Degradimet dhe mbetjet urbane të mbeturinave-Janë evidente dhe duhet merren masa urgjente për pastrimin e tyre dhe rikultivimin e zonave të ndotura . Rreth 4 ha janë evidentuar si zona të ndotura brenda komunës kadastrale të Shtimes.

Cilësia e ujërave urbane-Në zonën kadastrale të Shtimes kalon lumi Shtimjanja si rezultat i bashkimit të dy lumenjve Carralevë dhe Mollopolc. Cilësia e ujit në lumin Shtimjanja është e kategorisë IIb si pasojë e shkarkimit të ujërave të zeza në degët e lumit nga vendbanimet për gjatë vijës hidrografike. Në cilësinë e ujit të lumit Shtimjanja kanë ndikuar edhe hedhja e mbeturinave shtëpiake si dhe mbeturinave tjera. Përgjatë vijës lumore që kalon nëpër zonën urbane të qytetit, në bazë të analizave dhe daljes në terren, janë vërejtë mbetje ilegale të hedhurinave, si dhe kycje të drejtpërdrejta të lirim të ujërave të zeza në shtratin e lumit.

Harta 14. Ndotja e lumit Shimjanja, mbetjet e mbeturinave dhe masat kundër përmbytjeve



Tendenca negative të zhvillimit natyror të vijës ujore janë konstatuar përgjatë tërë vijës ujore të lumit Shtimjanja. Ndikimet negative për shkak të ndotjes janë prezentë në papastërtinë e ujit, ndikimit në botën bimore dhe shtazore të lumit, ujërave nëntokësore etj. Rregullimi i shtratit të lumit me mure vertikale nga betoni janë zgjidhje jo të mira për shkak se shtrati i lumit ka humbur imazhin natyror. Rreth 315 m ndërtime të tilla duhet modifikohen, së paku të mveshen me guri natyror dhe të kthehet pamja natyrore. Vazhdimi i projektit për rregullimin e shtratit të lumit të mbetur në zonën urbane me rreth 610 m do zgjidhje hidroteknike (modeli i lumit Lepenc në Kaçanik, Modeli i Lumit Krivareka në Kamenicë ose Vardari në Shkup). Me planin detal rregullativ kjo zonë me rreth 1000 m duhet të urbanizohet në dy anët me drunj dekorativ, të ndërtohen shëtitore për nevoja pushimi e rekreimi. Përveç pastrimit të shtratit të lumit në zonën urbane planifikohet që me projekt të veçantë të bëhet pastrimi i shtratit të lumit në zonën katastrale të Shtimes me gjatësi 4.4 km.

Preferohet që nga vija ujore në distancë prej së paku 10m të jetë zonë e lirë .

Rekomandime:

Ndalimi i hedhjes së mbeturinave

Pastrimi i shtratit të lumit

Urbanizimi i shtratit të lumit me plan detal urbanistik

Krijimi i zonave të lira për rekreacion, pushim, ecje pranë shtratit të lumi etj.

Cilësia e ajrit-Cilësia e ajrit është një faktor i rëndësishëm nga pikëpamja ekonomike, ekologjike dhe sociale duke marrë parasysh pasojat e saj për shëndetin e njeriut (veçanërisht për sistemin e frymëmarrjes) dhe në mënyrë të përgjithshme për cilësinë e jetës (ndotja nga aromat, dëmtimi i të pamurit, etj). Ndotja e atmosferës është e lidhur si me kushtet klimatike lokale, ashtu dhe me shkarkimet e ndotësve atmosferik. Shumë probleme të cilësisë së ajrit në qytet shkaktohen nga prania e ndotësve të tillë, si SO₂, grimcat e pezullta, NO₂, oksidantët, monoksidi i karbonit, komponimet organike flurore (volatile) dhe metalet e rënda.

Ndotja atmosferike përbën një problem të veçantë në qytete, sepse pjesa më e madhe e burimeve antropogjene që shkaktojnë ndotje janë përqendruar pranë këtyre zonave (qarkullimi rrugor), çka ndikon seriozisht në cilësinë e ajrit të thithur nga qytetarët. Cilësia e ajrit urban mund të shprehet nëpërmjet përqendrimeve mesatare vjetore të SO₂, të grimcave të pezullta dhe të NO₂ që hasen në ajrin e qytetit. Këta indikatorë, megjithatë mund të fshehin ndryshimet e mëdha sezonale.

Për sigurimin e informacionit të nevojshëm lidhur me cilësinë se ajrit në qytetet, duhet kërkuar nga Instituti i Shëndetit Publik dhe Instituti i Hidrometeorologjikë për të filluar realizimin e një programi monitorimi për indikatorët kryesorë të ndotjes së ajrit. Shkarkimi i qendrës urbane nga presioni i qarkullimit të automjeteve duhet zgjidhur përmes rrugëve qarkore si zgjidhje e vetme.

Tani në qytetin e Shtimes është një vijë rrugore e qarkut mirëpo ajo rrugë është e pa përfunduar nga se kërkohet të jetë vij komunikatave jashtë zonës urbane. Gjithashtu

proponohet që nga qendra industriale në drejtim të rrugës qarkore të lidhet rruga Ferizaj-Shtime-Prizren. Shkarkimi i qendrës urbane nga qarkullimi i automjeteve rrit nivelin e pastërtisë së ajrit.

Ndërtimet urbane-Zhvillimi qytetit në tërësi ose i zonave të veçanta bëhet mbi bazën e planeve të hartuara që më parë. Por, praktika e dekadës së fundit ka dëshmuar se në shumicën e rasteve nuk janë planet ato që i paraprijnë zhvillimit. Popullsia është vendosur në mënyrë stihike duke ndërtuar vend e pa vend dhe duke mos e kursyer as tokën bujqësore. Në përputhje me numrin e popullsisë hartohet plani dhe përcaktohet rrjeti i infrastrukturës, i shërbimeve, sipërfaqet e gjelbra, terrenet sportive etj. Edhe në rastet kur planet ekzistojnë ato nuk i përgjigjen si duhet realitetit urban, sepse këto plane kanë nevojë që të plotësohen në atë mënyrë që të marrin parasysh aspektet mjedisore, ekonomike, infrastrukturore etj.

Sipërfaqet e gjelbra

Është llogaritur se në qytet sipërfaqet e gjelbra janë të vogla. Po t'i referohemi normës së sipërfaqes së gjelbër për një banor ajo është:

gjelbërimi i zonës së banimit, 5-7 m²/banor;

gjelbërimi i zonës së pushimit, 8-14 m²/banor.

Tabela 15. Sipërfaqet e gjelbra të K. Kadastrale të qytetit të Shtimes

Sipërfaqe bujqësore	698.21
Sipërfaqe nën pyje	19.34
Sipërfaqe për rripullëzim	13.18
Lum	2.0
Brez i gjelbër	16.22
Park	18.72
Sport dhe rekreacion	34.26
Sipërfaqe të lira	114.99
Sipërfaqe e rezervuar për industri	63.11
Gjithsej sipërfaqe e gjelbër	981.03
Sipërfaqja e përgjithshme e komunës kadastrale	1282

Në bazë të analizave në profilin urban është konstatuar se 996.8 ha e sipërfaqes kadastrale të Shtimes është zonë me sipërfaqe të gjelbër: ara, livadhe, kullosa, pyje, djerrina, sipërfaqe ujore etj.

Zonës urbane të banimit i mungon sipërfaqja e gjelbër, gjithashtu i mungojnë shiritat e gjelbër, si dhe mungon parku i qytetit.

Parakushtet për zhvillimin e brezave të gjelbër ekzistojnë.

Rregullimi i parkut të qytetit te Kompleksi i pishave .

Shiriti i gjelbër në qendër, në dy anët e rrugës nga ura deri te kompleksi i pishave

Shiriti i gjelbër nga kompleksi i pishave e deri te kompleksi „Masakra e Reçakut”.

Shiriti i gjelbër si dhe vendosja e karrigeve për pushim në dy anët e lumit Shtimjanja.

Kufizimi i zonës industriale me shirit të gjelbër së paku 25m nga zona urbane
Pyllëzimi i sipërfaqeve me erozion të mesëm në zonën kadastrale të Shtimes
Pyllëzimi i zonave të lira dhe të parregulluara.

Shiriti i gjelbër në mes zonës urbane dhe zonës industriale.

Tokat bujqësore

Shtimja si zonë kadastrale disponon me një fond të tokave cilësore ku zhvillohet ekonomia agrare.


Zënie pa kriter e tokës së punueshme për qëllime ndërtimi, sidomos në brendësi të sipërfaqeve të tokës së punueshme janë ndërtime të cilat pengojnë mekanizimin në bujqësi. Vihet re gjithashtu se ka shumë ndërtime në të dy anët e rrugëve, pa respektuar distancat e duhura, pa marrë parasysh zgjerimin perspektiv të rrugëve, gjelbërimin anash tyre etj. Prezent janë dëmtimet në sipërfaqe të gjelbra, të pyjeve, peizazheve me vlera, etj.

Problemet identifikohen në dy drejtime: brenda kufijve të shtrirjes së qytetit (brenda vijës ndërtimore) dhe jashtë këtyre kufijve, me tendenca të zgjerimit të qytetit në mënyrë të paplanifikuar

Brenda kufijve të territorit urban të qytetit janë identifikuar zona të lira ku mundë të ndërtohet, edhe pse kategoria e tokës është II-IV për shkak se ka humbur karakterin bujqësor nga se është kufizuar në të gjitha anët me ndërtime. Janë identifikuar rreth 70 ha sipërfaqe ku mundë të përdoren për objekte banimi dhe tregtare, varësisht nga planet detale urbanistike .

Zoonimi i sipërfaqes ndërtimore është parakusht për ndalimin e ndërtimeve në sipërfaqet bujqësore kualitative. Efektet e parandalimit janë pozitive dhe minimizojnë konfliktet mes sipërfaqeve bujqësore dhe atyre ndërtimore.

Harta 15.



Në bazë të analizave, sipërfaqja ndërtimore ekzistuese e Shtimes është 180ha. Kahet e zgjerimit të qytetit janë dhënë në drejtim të tokave të kategorisë mbi IV dhe janë plotësuar hapësirat brenda vijës ndërtimore edhe pse tokat bujqësore janë të kategorisë I-IV. Kjo është bërë nga arsya se këto sipërfaqe kanë humbur aktivitetin bujqësor ngase janë rrethuar me objekte banimi. Rritja është paraparë edhe për rreth 70 ha.


Gjithsej sipërfaqja urbane e ndërtuar për 10 vitet e ardhshme parashihet të shtrihet në 249.9 ha.

Rekomandime:

Përcaktimi i vijave ndërtimore (zoonimi) është prioritet i këtij Plani Zhvillimor Urban. Kahet e zhvillimit të ndërtimit dhe zonat ku ndalohet ndërtimi përcaktohet në bazë të numrit të popullsisë (rritja e numrit të popullsisë për 10 vitet e ardhshme), ndalim ndërtimi në zonat bujqësore me bonitet II-IV, vijat komunikative me interes për komunën dhe shtetin etj.

II.10.3. Trashëgimia natyrore dhe kulturore

Në zonën kadastrale të Shtimes si monument natyror është Kompleksi i Pishave. Kjo tërësi botanike duhet ruajtur për shkak të vlerave të larta natyrore .

Harta 16. Trashëgimia kulturore dhe natyrore e qytetit të Shtimes

Trashëgimia kulturore në Zonën kadastrale të Shtimes ku duhet të restaurohen objektet janë paraqitur në hartë.

Këto objekte me karakter kulturoro-historik rekomandohet që në bashkëpunim me MKRS dhe komunës të vëhen në mbrojtje. Restaurimi është i nevojshëm për shkak të vlerave që posedojnë këto objekte, për të cilat komuna në bashkëpunim me MKRS dhe komunitetin e bizneseve duhet urgjentisht të krijoj fonde për mirëmbajtjen e tyre. Krijimi i katalogut turistik të trashëgimisë kulturore të zonës urbane dhe komunës në përgjithësi është e domosdoshme duke përfshirë edhe zonën e Reçakut që ka vlera të larta kombëtare.

Lidhja turistike e këtyre vlerava në mes Shtimes dhe Reçakut është e domosdoshme nga se këto vlera kanë rëndësi për tërë Kosovën dhe më gjerë.

Rekomandohet:

Përpilimi i Planit Rregullativ urban Reçak – Shtime për inkorporimin e kompleksit memorial „Masakra e Reçakut” me vlera të larta të trashëgimisë.

“STRATEGJIA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR URBAN”

FAZA –IV

I. STRATEGJITË DHE VEPRIMET PËR ZBATIM

I.1 STRATEGJITË PËR ZBATIM DHE PLANET E VEPRIMIT TË SHOQËRUARA ME KONCEPTET HAPËSINORE OSE PARIMET

I.1.1. Strategjia e zhvillimit ekonomik të qytetit të Shtimes

Më poshtë janë sqaruar synimet, janë zbërthyer objektivat në masa, aktivitete dhe projekte:

Arritja e zhvillimit të balancuar ekonomik

Zhvillimi i balancuar ekonomik i qytetit të Shtimes ka për qëllim dy objektiva kryesore, e para që gjatë zhvillimit të një sektori ekonomik të mos dëmtohet sektori tjetër por përkundrazi të ndihmohet dhe e dyta është që zhvillimet të jenë të shpërndara në të gjithë territorin e qytetit të Shtimes.

Shfrytëzimi i potencialeve lokale si ato humane, organizative dhe kapitale me qëllim të arritjes së një zhvillimi ekonomik ku do të plotësohen nevojat momentale dhe do të ruhen interesat e gjeneratave të ardhme.

Shfrytëzimi i pozitës shumë të favorshme që ka komuna e Shtimes dhe qyteti i Shtimes konkretisht si një portë lidhëse në mes të rajoneve të Kosovës dhe rajonit më të gjerë mundëson koncentrimin dhe zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme të koncentruar nëpër disa qendra komerciale.

Shfrytëzimi i potencialeve lokale të mbështetur në kultivimin e kulturave bujqësore profitabile me theks në kultivimin e pemëtarisë dhe perimtarisë, pastaj zhvillimi i blegtorisë dhe bletarisë është parakusht i domosdoshëm për zhvillimin rural në komunë e Shtimes.

Funksionalizimi i parkut industrial “Technopolis” do të ndihmoj zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme si do ju mundësoj atyre një organizim më të mire duke ju ofruar edhe shërbimet e nevojshme.

Shfrytëzimi i potencialeve turistike kulturore mundëson zhvillimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm si dhe mundëson zhvillimin kulturore të qytetit Shtimes.

Synimi 1. Shfrytëzimi i mundësive për zhvillimin e bujqësisë në kulturat bujqësore të pemëtarisë dhe perimtarisë

Qyteti i Shtimes ka mundësi reale të zhvillimit të bujqësisë intensive të bazuar kryesisht në pemëtarinë dhe perimtarinë. Kjo ndihmohet nga fondi i konsiderueshëm i tokës bujqësore, kushtet klimatike, përvoja e mirë e bujkut dhe gatishmëria e fermerit për të jetuar nga bujqësia. Pjesa e konsiderueshme e tokës bujqësore që shtrihet kryesisht në pjesët fushore për gjatë lumit Shtimjanja kanë mundësi të shfrytëzimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore për ujitje. Në këtë zonë ose lokalitet do të zhvillohet bujqësia intensive e prirë kryesisht nga perimtaria. Kurse pjesa e territorit urban që shtrihet buzë maleve ka shumë mundësi të mira të zhvillimit të pemëtarisë për shkak të tokës së përshtatshme dhe kushteve mikroklimatike që gjenden në këtë pjesë të komunës. Një fond i konsiderueshëm i tokës djerrinë si dhe një fond i tokës në livadhe do të shndërrohet në plantacione të mollës, dardhës, kumbullës etj.

Për të arritur këtë objektiv do të realizohen një mori projektsh si në vijim:

- Organizimi i trajnimeve dhe vorkshopeve për fermerët
- Pastrimi i lumenjve

Synimi 2. Zhvillimi i blegtorisë

Qyteti i Shtimes është edhe vendbanim rural me mundësi të mira të zhvillimit të blegtorisë dhe bletarisë. Blegtoria ka një rrol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të Shtimes dhe në përmirësimin e të ardhurave të ekonomive familjare të cilat shtrihen kryesisht në pjesët periferike të qytetit.

Për të arritur këtë objektiv do të realizohen një mori projektsh si në vijim:

- Organizimi i vorkshopeve vetëdijesimi i fshatarit për të jetuar nga bujqësia

Synimi 3. Funksionalizimi i parkut industrial

Komuna e Shtimes, rëndësi të veçanet i ka kushtuar edhe organizimit dhe përqendrimit të bizneseve në një zonë të veçanet të veprimit të tyre. Parku industrial në Shtime do të ketë një sipërfaqe prej 10ha të cilat do të kenë 9 objekte industriale dhe edukative, e cila në fazën fillestare parashihet ti punësoj 300 punëtorë. Disa biznese të cilat priten të vendosen në këtë park industrial janë përfaqësi të pjesëve të Mercedesit, Audisë dhe BMË, gjithashtu edhe një shkollë e lart e menaxhimit të turizmit dhe mirëprirjes, si dhe një qendër për inovacione dhe teknologji. Sigurisht për shkak të krizës globale, investitori i jashtëm nuk ka arritur ti përmbush zotimet e tij për investime dhe si rrjedhojë komuna i ka marr të drejtën e menaxhimit të plotë të zonës. Në këtë rast komuna duhet të hartoj një strategji fleksibile e cila i mundëson investitorit të parë realizimin e investimeve të zotuar deri në momentin kur do shpreh interesim me projekt konkret ndonjë investitor tjetër ose i dytë.

Për të arritur këtë objektiv duhet të arrihet një objektiv kryesorë, si në vijim:

- Promovimi i interesit të komunës në funksionalizimin e këtij parku industrial

Synimi 4. Zhvillimi i turizmit në zonat rekreative natyrore dhe kulturore (Reçaku)

Identiteti i shekullit 21 i komunës së Shtimes është “Kompleksi Memorial Masakra e Raçakut, ky vend i shprehjes së dinjitetit mbarëkombëtarë dhe ndërkombëtarë do të shndërrohet jo thjesht vetëm në një vend përkujtimi njëvjetorësh por edhe një pikë strategjike turistike. Do të arrihet që turisti të jetë i motivuar të vizitoj këtë vend jo vetëm në data përkujtimore por gjatë gjithë vitit. Kjo do të arrihet me ndërtimin e muzeut lokal brenda kompleksit memorial Masakra e Raçakut, i cili do të prezantoj momente vizuale dhe akustike të ngjarjes në formë të filmit, zërit, fotografive dhe broshurave informative do ta informoj turistin më shumë dhe më drejt për tërë ngjarjen dhe do ta bëjë vizitën shumë herë më atraktive në këtë kompleks të kauzës humane.

Ndër projektet të cilat do të realizohen në këtë sektorë ekonomik-kulturorë janë:

- Ndërtimi i muzeut lokal në “Kompleksin Memorial Masakra e Raçakut”

Synimi 5. Përkrahje e bizneseve të vogla dhe të mesme

Në komunë dhe në qytet nuk ekzistojnë institucione qeveritare dhe joqeveritare apo organizata tjera me seli në Shtime të cilat në formë të specializuar merren me zhvillimin e alternativave të zhvillimit ekonomik lokal.

Prandaj Autoritetet lokale me përkushtim real merren dhe do të merren në të ardhmen me mbështetjen e komunitetit të biznesit përmes:

- Projektit të qendrës së biznesit
- Aktivizimit të pilot projektit të parkut të biznesit, ish-technopolisit
- Ndërtimit të infrastrukturës përcjellëse e cila do t'u bënte bizneseve funksionimin dhe operimin më të lehtë
- Organizimin e vorkshopeve, seminareve dhe trajnimeve praktike mbi aspektet e avancimit të zhvillimit ekonomik lokal
- Gjetja dhe kontakti me donatorë të mundshëm, të cilët mbështesin komunitetin e biznesit.

Bankat ekzistuese ne Shtime përmes kredive afatshkurtra e ndihmojnë biznesin, por me kamata mjaftë të larta, edhe pse për komunën këto banka kanë rëndësi të madhe për zhvillimin ekonomik lokal, prapë ka nevojë për kushte më të volitshme për përkrahje dhe ndihmë të bizneseve e sidomos të atyre fillestare.

Objektivi	Nr Aktivitetit	Aktiviteti	Akterët	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
			vendimmarrës				
Synimi 1. Shfrytëzimi i mundësive për zhvillimin e bujqësisë në kulturat bujqësore të pemëtarisë dhe perimtarisë	A1	Organizimi i trajnimeve dhe vorkshopeve për fermer	Komuna, MBPZHR, Shoqatat bujqëve dhe institucionet ndërkombëtare	Komuna dhe MBPZHR	2010-2012	Komuna dhe MBPZHR	10,000
	A2	Pastrimi i lumit Shtimjanja dhe Carraleva	Komuna dhe komuniteti	Komuna dhe komuniteti	2010-2012	Komuna dhe komuniteti	20,000
Synimi 2. Zhvillimi i blegtorisë dhe bletarisë	A1	Organizimi i trajnimeve dhe vorkshopeve për fshatarë	Komuna, MBPZHR dhe Shoqatat e bujqve	Komuna, MBPZHR dhe Fermerët	2010-2012	Komuna, MBPZHR, Fermerët, dhe donacionet nga jashtë	10,000
Synimi 3. Funksionalizimi i parkut industrial	A1	Promovimi i interesit të komunës në funksionalizimin e këtij parku industrial	Komuna, MTI dhe komuniteti i biznesit	Komuna, MTI dhe komuniteti i biznesit	2010-2020	Komuna, MTI dhe komuniteti i biznesit	200,000
Synimi 4. Zhvillimi i turizmit në zonat rekreative natyrore dhe kulturore (Reçaku)	A1	Ndërtimi i muzeut lokal në "Kompleksin Memorial Masakra e Kaçakut"	Komuna, MKRS dhe diaspora	Komuna dhe MKRS		Komuna, MKRS dhe diaspora	100,000

I.1.2. Destinimi i sipërfaqeve dhe mënyrat e përdorimit

Synimi 1: Sigurimi i tokës publike

Komuna duhet të siguroj tokë (përmes blerjes) për qëllime publike që ajo të jetë plotësisht pronë e komunës.

Komuna duhet të hartojë një politikë aktive si instrument për sigurimin e tokës, ndërsa tokën që e ka në pronësi ta ofroj për shfrytëzim të caktuar.

- Politikat afatgjate për sigurimin dhe shfrytëzimin e tokës për qëllime publike do ti ndihmojnë komunës në realizimin e synimeve të PZHU-së.
- Komuna duhet të krijoj një platformë të partneritetit publik-privat që ndihmon në realizimin efikas të politikave banimore duke ndarë bashkërisht përgjegjësitë, investimet dhe të mirat e një ambienti të ardhshëm më të qëndrueshëm.
- Komuna në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit hapësinor duhet të siguroj tokë dhe mjete për objekte të banimit social në shërbim të rasteve të rënda sociale përbrenda qytetit dhe komunës. Kjo do të zbus çështjen e banimit për rastet sociale me të ardhura të vogla vjetore.

Synimi 2: Hartimi i planit kadastral

- Komuna duhet të ketë kadastrë të avancuar, funksional dhe transparent për shfrytëzimin e tokës, sikurse edhe në shërbim të realizimit të projekteve.
- Komuna duhet ta përtërijë kadastrin ekzistues.
- Plani i ri kadastral duhet të jetë bazë për hartimin e planeve rregulluese, ndërsa kjo do të mundësoj zbatimin e PZHU-së në mënyrë precize.

Synimi 3: Arritja e dendësisë së planifikuar me PZHU

- Rritja e dendësisë së banimit.
- Promovimi i banimit të lartë në zonën e qendrës.
- Identifikimi i zbrazëtirave në qytet si lokacione potenciale për zhvillim të ardhshëm (plotësimi i zbrazëtirave).
- Ndërtimet e reja të respektojnë korridoret e propozuara nga PZHU dhe të jenë në harmoni me zhvillimet e rëndësishme në rrethinë, si: vija ndërtimore, lëvizja e këmbësorëve, gjelbërimi, etj.
- Kufizimi i ndërtimeve në zonat e reja mikse të banimit të definuara si zona të rezervuara për zgjerim në të ardhmen.
- Trajtimi i strukturës ekzistuese përmes: rikonstruktimit, rehabilitimit, interpolimit, dhe revitalizimit.
- Ndërtimi në zonat e reja të banimit të lejohet pasi të hartohen planet rregulluese.

Arritja e dendësisë së planifikuar në PZHU ndihmon në shfrytëzimin racional të tokës ndërtimore, ruajtjes së tokës bujqësore, me qëllim të përkrahjes së konceptit të qytetit kompakt.

Planet rregulluese

Në lidhje me implementimin e projekteve të vendbanimeve, është i nevojshëm mbulimi i zonës urbane me Plane Rregulluese (Neni 15, Ligji për Planifikimin Hapësinor).

Planet Rregulluese Urbane, “i përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave si dhe rregullat për lokacionin e ndërtesave në ngastrat urbane”. Përmes themelimit të bazës ligjore për ndërtimin e ndërtesave, ato e vendosin kornizën për investime private. Si rrjedhim, Planet Rregulluese Urbane janë si instrumente kyçe për implementimin e zonave të përcaktuara ndërtimore.

Plani Rregullues –Zona e Qendrës

Zona e Qendrës ka pësuar ndryshime të konsiderueshme zhvillimore. Zhvillimi i pakontrolluar tani po reflektohet në shfrytëzimin jo efikas të tokës ndërtimore. Për ta rregulluar zhvillimin e ardhshëm duhet të hartohet plani rregullues urban për këtë zonë me qëllim të orientimit më të mirë për ndërtim të mëtutjeshëm.

Vendbanimet Joformale (VBJF)

VBJF duhet të zyrtarizohen. Forma e formalizimit të tyre është dhënë në Udhëzuesin për formalizimin e VJ të MMPH-së.

Preferohet që komuna të bëjë profilizimin e të gjitha VBJF në qytet dhe krijimin e një baze të të dhënave për qytetin. Komuna duhet të përgatis profilin e gjendjes ekzistuese të vendbanimeve joformale në territorin e saj. Kjo do të shërbente për të përcaktuar prioritetet e rregullimit të vendbanimeve joformale, kurse donatorëve të mundshëm do t’u ofronte informata të nevojshme për nevojën e përkrahjes financiare, humane dhe teknike në rregullimin e tyre.

Shërbimet e kadastrit dhe pronës duhet të sigurojnë planet gjeodezike dhe shënimet pronësore në mënyrë që saktësia e informatave të mos paraqes problem për planifikim.

Lidhur me çështjen e pronësisë nevojitet një angazhim intensiv i Komunës për të përcaktuar të drejtat pronësore. Të gjitha dokumentet e nevojshme pronësore duhet të mblidhen dhe verifikohet vlefshmëria e tyre. Çështjet e pazgjidhura pronësore duhet të zgjidhen në mënyrë që të krijohet baza ligjore për fillimin e procesit të planifikimit.

Procesi i planifikimit - Rregullimi i vendbanimeve joformale duhet të realizohet përmes një procesi gjithëpërfshirës në mënyrë që pjesëmarrësit të kenë mundësi të artikulojnë kërkesat e tyre dhe marrja e vendimeve të jetë transparente. Për këtë qëllim duhet të organizohen banorët e vendbanimeve të tilla që të jenë të gatshëm të kyçen në proces përmes udhëheqësve të komunitetit apo pjesëmarrjes së të gjithëve.

Kostoja dhe kohëzgjatja e formalizimit dhe rregullimit të vendbanimeve joformale duhej të jetë komponentë e obligueshme e strategjisë afatmesme dhe afatgjate të rregullimit të vendbanimeve joformale në qytet.

Ndryshimet dhe plotësimet në PZHU mund të bëhen brenda periudhës 5 vjeçare për ndonjë arsye me interes të caktuar. Këto ndryshime duhet të miratohen nga Asambleja Komunale. Zbatimi efikas i planit duhet të jetë i qartë për të gjithë akterët kyç

(Autoritetet Qendrore dhe Lokale, Komuniteti i Biznesit, OJQ-të, institucionet e tjera publike, komuniteti).

Komuna në këtë rast ka një rol menaxhues dhe monitorues në zbatimin e PZHU-së.

Destinimi i sipërfaqeve dhe mënyrat e përdorimit							
Objektivi	Nr Aktivitetit	Aktiviteti	Akterët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
Synimi 1. Sigurimi i tokës publike dhe hartimi i planit kadastral	A1	Komuna si entitet legal duhet të siguroj tokë (përmes blerjes) për qëllime publike që ajo të jetë plotësisht pronë e komunës.	Kuvendi Komunal	Kuvendi Komunal	***	Kuvendi Komunal dhe AKM	e lart
	A2	Komuna duhet të ketë kadastrë të avancuar, funksional dhe transparent për shfrytëzimin e tokës, sikurse edhe në shërbim të realizimit të projekteve.	Kuvendi Komunal	Kuvendi Komunal	**	Kuvendi Komunal dhe Agjencioni Kadastral i Kosovës	e lart
	A3	Plani Rregullues për zonën e qendrës	Kuvendi Komunal	Kuvendi Komunal	*	Kuvendi Komunal	15000
	A4	Planet Rregulluese për zonën mikse dhe zonën periferike	Kuvendi Komunal	Kuvendi Komunal	**	Kuvendi Komunal	140000
	A5	Hartimi i planeve për trajtimin e vendbanimeve joformale	Kuvendi Komunal	Kuvendi Komunal	*	Komuna dhe MMPH	15 000

I.1.3. Transporti dhe trafiku

Synimi 1. Korridoret e transportit – për të ofruar qasje në rrugë të asfaltuara për të gjithë qytetarët e zonës urbane është e nevojshme që të ndërmerren këto aktivitete:

- ✓ Asfaltimi i 7.5km rrugë lokale brenda zonës urbane
- ✓ **Ndërtimi i rrugëve qarkore** - ndërtimi i rrugëve të reja qarkore të cilat mundësojnë lidhjen e lagjeve brenda zonës urbane, siç janë:
 - Rruga qarkore e cila lidhë pjesën e zonës urbane në anën e njësisë së zjarrëfiksive deri tek lumi, me gjatësi prej 0.70km
 - Rruga qarkore e cila lidhë pjesën e zonës urbane nga kuvendi komunal deri tek rruga transit, me gjatësi prej 0.60km
 - Rruga qarkore e cila lidhë pjesën e zonës urbane nga shkolla e mesme deri tek parku industrial Maksit-i, me gjatësi prej 1.05km.
 - Sigurimi i hapësirave për parking
 - Komuna duhet të përmirësojë çështjen e parkimit në zonën ekzistuese të qytetit duke përdorur qasje të ndryshme, si:
 - Sigurimi i ngastrave për parkim aty ku është e mundur për shfrytëzim më të gjatë (afër parkut të qytetit, afër tregut të gjelbër si dhe shërbimeve të tjera administrative dhe tregtare)
 - Parkimi për shtëpitë individuale duhet të organizohet përbrenda parcelës përkatëse. Komuna duhet të ndjek standardet dhe regullativat e parkimit në lidhje me ndërtimet e reja në qytet për të siguruar: hapësira të nevojshme të parkingjeve për zonat e banimit, parkingje për zonat e punës, parkingje për zonat e sportit dhe rekreacionit, parkingje për shërbime tjera.
- ✓ **Shtegu çiklistëve** – me qëllim të krijimit të kushteve të volitshme për zhvillimi e çiklizmit në zonën urbane duhet të ndërtohet shtegu i çiklistëve në pjesën qendrore të zonës urbane, përkatësisht përgjatë rrugës magjistrale që aktualisht kalon në zonën urbane, me gjatësi prej 1.81 km,.
- ✓ **Lëvizja e këmbësorëve** – për të krijuar kushte normale për lëvizjen e këmbësorëve brenda zonë urbane është e nevojshme që të behet plotësimi i hapësirave përgjatë rrugëve lokale me trotuare për këmbësor, me një gjatësi prej 11.5km.

Infrastruktura në zonën urbane							
Objektivi	Nr Aktivitetit	Aktiviteti	Akterët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
Synimi 1. Infrastruktura rrugore dhe trafiku	A1	Asfaltimi i 7.5km rrugë lokale brenda zonës urbane	Kuvendi Komunal	Kuvendi Komunal	***	Kuvendi Komunal	500000.00
	A2	Ndërtimi i rrugëve qarkore, 2.35km	Kuvendi Komunal	Kuvendi Komunal	**	Kuvendi Komunal	250000.00
	A3	Shtegu çiklistëve, 1.81km	Kuvendi Komunal	Kuvendi Komunal	*	Kuvendi Komunal	75000.00
	A4	Lëvizja e këmbësorëve, 11.5km	Kuvendi Komunal	Kuvendi Komunal	**	Kuvendi Komunal	140000.00

I.1.4.Strategjia e zhvillimit social

Synimi 1. Administratë publike efikase

Shërbimet administrative luajnë një rol të rëndësishëm në jetën shoqërore. Për të pasur shërbime administrative sa më cilësore duhet të krijohen këto kushte;

- Avancimi i sistemit elektronik, ku çdo qytetar të ketë mundësi të informohet me gjithçka që i intereson dhe të mund të plotësoj formular dhe parashtoj kërkesa sipas nevojës së tij përmes sistemit elektronik digjitalizimit të administratës.
- Themelimi i gjyqësorit komunal krijon mundësi më të mira për qytetarët sepse më nuk do të kenë nevojë të shkojnë në gjykatën rajonale në njërën anë dhe në anën tjetër lëndët zgjidhen më shpejt.

Të gjitha të arriturat si më lartë na mundësojnë shërbime më cilësore administrative.

Synimi 2. Shërbimet cilësore në arsim dhe shëndetësi

Për ngritjen e cilësisë mësimore dhe shëndetësore, nevojitet krijimi i kushteve më të mira duke përfshirë;

- Themelimin e dy çerdheve për fëmijë në zonën urbane të moshës 6 muaj deri 6 vjeç.
- Krijimin e hapësirave të nevojshme shkollore (shkollë fillore dhe të mesme).
- Organizimi i trajnimeve profesionale për personelin mësimor.
- Kompjuterizimi i shkollave në hap me trendët bashkëkohore.

Vetëm atëherë kur të jenë realizuar të gjitha projektet e parapara me këtë plan përkatësisht strategji, mund të themi se kemi arsimim dhe shëndetësi të avancuar. Këto projekte do të duhet të realizohen me kohë dhe sipas rëndësisë që kanë (shih tabelën më poshtë për më tepër).

Synimi 3. Minimizim të shkallës së papunësisë dhe varfërisë

Shkalla e papunësisë është e lartë dhe prek të gjitha strukturat e popullsisë pa dallim moshe, gjinie, etnie etj. Që të minimizohet papunësia kërkohet të hartohen plane konkrete të veprimtimit si;

- Stimulimi i bujkut përmes lirimit të kostonë së derivateve, plehrave artificiale, farërave, mbrojtje në raste të fatkeqësive natyrore, kredive me kamata të favorshme për bujqësi, organizimin e trajnimeve apo seminareve për metodologjitë dhe teknikat të reja etj.
- Përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes qasjes së lehtë në dokumente dhe ligje të nevojshme, kredi me kamata të ultë dhe afatgjata, sigurimi i hapësirës së nevojshme në rast interesimi të donatorëve, etj.
- Organizimin e trajnimeve profesionale sipas kërkesave të tregut (rrobaqepësi, frizeri, teknik të bardhë, tregti, turizëm rural, bagëti, pemëtari, perimtari etj).
- Lidhja e kontratës zezonave me ndonjë vend - shtet.

Synimi 4. Rritja e nivelit të barazisë gjinore.

Struktura e popullsisë sipas gjinisë në këtë komunë është përafërsisht e njëjtë, prandaj edhe niveli i pozitës udhëheqëse në punë dhe shkallës së punësimit nuk duhet të jetë me diferenca të theksuara.

- Pozitat udhëheqëse në punë duhet të caktohen mbi baza të bilancit gjinor por gjithmonë duke u bazuar mbi vlerat.
- Rritja e kuotës së të punësuarve në veçanti në institucionet publike në favor të gjinisë femërore.

Synimi 5. Kultura, sporti dhe rekreacioni

Për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, sportive dhe krijimin e hapësirave rekreative nevojitet marrja e masave adekuate si;

- Ndërtimi i shtëpisë së kulturës në qytet.
- Zgjerimin e hapësirës së bibliotekës së qytetit me elementet përcjellëse.
- Organizimi i ngjarjeve kulturore me karakter edukativo-kulturor gjatë vitit.
- Ndërtimi i sallës së sporteve në qytet.
- Krijimi i hapësirave gjelbëruese.
- Ndërtimi i mini kopshteve (vende lodrash) për fëmijë në vende publike përkatësisht në oborre shkollore dhe vende të ngjashme.

Të gjitha këto të arritura do të ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT SOCIAL							
Objektivi	Nr. Aktivitetit	Aktiviteti	Aktorët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
Synimi 1. Administratë publike efikase	A1	Digjitalizimi i administratës komunale.	K. Komunal Shtime	Kuvendi Komunal	••	Buxheti Komunal	???
	A2	Themelimi i Gjyqësorit komunal.	Ministria e Drejtësisë, K. Komunal	Ministria e Drejtësisë, K. Komunal	•	Buxheti i Kosovës, B. Komunal	150000
Synimi 2. Shërbimet cilësore në arsim dhe shëndetësi	A1	1+1 çerdhe / kopsht për fëmijë.	K. Komunal, MASHT, Sektori privat.	K. Komunal, MASHT	•&•••	K. Komunal	12000&120000
	A2	Hapësira të nevojshme shkollore.	K. Komunal, MASHT	K. Komunal, MASHT	•	K. Komunal, MASHT	550000
	A3	Organizim të trajnimeve profesionale për mësime të mësimdhënës.	MASHT	MASHT	•+	MASHT, K. Komunal	70000
	A4	Kompjuterizimi i shkollave.	MASHT, K. Komunal	MASHT, K. Komunal	•+	MASHT, K. Komunal	15000
Synimi 3. Minimizim i shkallës së papunësisë dhe varfërisë	A1	Përkrahja e sektorit të bujqësisë.	MBPZHR, K. Komunal.	MBPZHR, K. Komunal	•+	MBPZHR, K. Komunal	50000
	A2	Organizimi i trajnimeve profesionale sipas kërkesave të tregut.	MPMS, MBPZHR, K. Komunal.	MPMS, MBPZHR, K. Komunal.	•+	MPMS, MBPZHR, K. Komunal	90000
Synimi 4. Rritja e nivelit të barazisë gjinore.	A1	Rritja e kuotës së barazisë gjinore në punë.	Ministritë përkatëse, K. Komunal.	K. Komunal.	•+	K. Komunal	
Synimi 5. Kultura, Sporti dhe rekreacioni	A1	Ndërtimi i shtëpisë së kulturës në qytet.	MKRS, K. Komunal	MKRS, K. Komunal.	•	MKRS, Komunal	420000
	A2	Organizimin e ngjarjeve kulturore.	MKRS, K. Komunale	K. komunal	•+	MKRS, Komunal	60000
	A3	Ndërtimi i sallës së sporteve në qytet.	MKRS, K. Komunal, Sektori privat	MKRS, K. Komunal	•	MKRS, Komunal	520000
	A4	Krijimin e hapësirave gjelbëruese.	K. komunal, Sektori privat	K. komunal, Sektori privat	•+	K. Komunal	25000
	A5	Krijimin e mini kopshteve (vend lodrash) për fëmijë.	K. Komunal, Sektori privat	K. Komunal	•+	K. Komunal	15000

I.1.5. Peizazhi dhe mjedisi

Synimi 1. Minimizimi i ndikimeve të dëmshme të veprimeve të njeriut në mjedis

Shkalla e degradimit të mjedisit në zonën urbane është evidente në ujë, ajër dhe tokë.

Masat parandaluese do të kenë efekte pozitive në mjedisin jetësor si dhe parandalimin e efekteve negative.

Ato paraqiten në forma të ndryshme si psh. hedhja e mbetjeve të amvisërisë, hedhja e mbetjeve të materialeve të ngurta, hedhja e mbetjeve bujqësore, shkarkimi i ujërave të zeza në trupat ujor, shkarkimi i vajrave në ujera dhe tokë, ndërtimet e pa kontrolluara në tokë bujqësore dhe përgjatë korridoreve, mënyra e punimit të tokës, erozionet, eksploatimi i rërës dhe zhavorrit, shkarkimi i gazrave nga automjetet dhe djegia për nevojat e amvisërisë, shkatërrimi i florës për rreth zonës urbane etj.

Masat

- Rregullore komunale për Inspektoratin konform Ligjit për mjedis si dhe zbatimin i saj me masa ndëshkimore si për personat juridik dhe fizik.
- Kritja e kapaciteteve për Njësine punuese „Pastrimi” për menaxhim efikas.
- Planifikimi i rrugës qarkore të Ferizajt (zvogëlimi i zhurmës dhe ndotjes së ajrit)

Synimi 2. Krijimi i kushteve për mbrojtje nga rreziqet e ndryshme natyrore

Masat mbrojtëse në rast rreziku ndaj fatkeqësive të ndryshme duhet reaguar me kohë dhe hapësira të caktuara.

Komuna është e obliguar që në bashkëpunimi me Ministrin e Administratës Publike gjegjësisht me Departamentin e Emergjencave të hartoj projektin apo udhërrëfyesin në rast rreziku si të veprohet.

Njashtu në kuadër të komunës të formohet Shtabi i emergjencës multi diciplinare që varësisht nga cili lloj kanosje të jen e parapërgatitur komuna të veprojnë në kohë dhe hapësirë. Në kuadër të shtabit të emergjencave në trupat punuese duhet involvuar edhe pjesëtarët e FSK, SHPK, Njesisë së zjarrfikësve, Njësine punuese të ujësjellësit, Njësine punuese „Pastrimi”, grupe dhe shoqata punuese profesionale të komunitetit.

Grupet punuese të Shtabit të Emergjencave :

- Për bujqësi
- Për zjarre
- Për vërshime
- Për mjekësi
- Për tërmete
- Fatkeqësi natyrore
- Për raste lufte

Me PZHU është paraparë edhe ndërtimi i strehimores së qytetit në rast rreziku për evakuim.

Synimi 3. Zgjerimi i hapësirave të gjelbra dhe mbrojtja e peizazheve natyrore përreth qytetit

Koncepti qytet i gjelbër duhet të arrihet përmes hartimit të një udhëzuesi për hapësirat e gjelbra të qytetit i cili duhet të merret në konsideratë gjatë hartimit të planeve rregulluese me qëllim të mbrojtjes së tij.

Mbrojtja, mirëmbajtja dhe zgjerimi e zonave të gjelbra

- Toka bujqësore të mbrohet me kujdes.
- Parku i qytetit të kompleksi i pishave me rreth 10 ha ti bashkëngjitet parkut të ri
- Lumi të pastrohet dhe shtrati i lumit të rregullohet deri në dalje të zonës urbane.
- Sigurimi i hapësirës për parkun e ri të qytetit dhe fuqizimi i lidhjeve me shiritin e gjelbër të rrugës kryesore dhe lumit.
- Sigurimi i hapësirës për parqet e vogla dhe fushat e lojës pranë bashkësive lokale.
- Sigurimi i hapësirës për sport dhe rekreacion.
- Korridori i gjelbër të rregullohet përgjatë rrugës kryesore të Zonës së Qendrës..
- Krijimi i brezit gjelbërues përgjatë lumit Shtimjanja dhe mbrojtja nga aktivitetet ndërtimore.
- Brezi i gjelbër përgjatë lumit të pajiset me infrastrukturë adekuate (ndriçim, shtigje për lëvizje, ulëse për pushim, etj).
- Krijimi i brezit të gjelbër mbrojtës mes zonës industriale dhe qytetit.

Të gjitha sipërfaqet dhe korridoret e gjelbra, duke përfshirë edhe zonat rekreative dhe sportive, të lidhen mes vendi duke krijuar një sistem unik dhe funksional për qytetarët.

Synimi 4. Mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore

Në kuadër të zonës urbane si zonë e mbrojtur e trashëgimisë natyrore parashihet Kompleksi i Pishave

Masat:

- Komuna në bashkëpunim me MMPH/ Agjencionin për Mbrojtje të Mjedisit me akt të veçantë të shpall zonë të mbrojtur Kompleksin e Pishave

Trashëgimia kulturore e Shtimes karakterizohet me objekte të ndryshme kulturore historike. Për mbrojtje nga kohezioni kohor si dhe për konservim të së kaluarës parashihet rikonstruimi i objekteve që kanë vlera të çmueshme të trashëgimisë kulturore.

Masat për rikonsrtuim:

- Në bashkëpunim me MKRS/Departamenti i Kulturës së pari këto monumente të vihen nën mbrojtje institucionale
- Rikonstruimi i objekteve të trashëgimisë kulturore

Tabela 16. Monumentet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore

Emri	Viti i ndërtimit	Gjendja
-Xhamia e vjetër	1824	E mirë
-Varri i Ahmet Sylejmanit -Shtimja	1923	Restaurim
Kulla e Agush Agës	1890	Nevojë restaurimi
Tyrbja e Shtimes	x	Nevojë restaurim
Kulla e Muhamet Begut	Fund shek XIX	Nevojë urgjente restaurimi
Shtëpia e Mulla Hysenve dhe Mulla Sylëve	Filmi i shek XX	Nevojë urgjente restaurimi
Kroi i vjetër	X	Nevojë urgjente restaurimi
-Kisha ortodokse	1923	Nevojë mbrojtje
Shkolla e parë në Shtime	1920	Nevojë mbrojtje
Rezervuari i parë i ujësjellësit	1932	Nevojë mbrojtje

Synimi 5. Parandalimi i hedhjes të mbeturinave

Gjatë vizitave në terren si dhe në bazë të faturimit nga Kompania „Pastërtia” janë konstatuar mbetje të amvisërisë ilegale si përgjatë shtratit të lumit ashtu edhe në masat tokësore që ndikojnë në ekosistemin urban.

Masat

- Zgjerimi i kapaciteteve në Kompaninë „Pastërtia”
- Rritja dhe vendosja e kontejnerëve në tërë zonën urbane
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve kryesore në qytet
- Eliminimi i të gjitha mbetjeve ilegale si ato të amvisërisë dhe atyre të ngurta.
- Ndëshkimi i ndotësve nga Inspektorati mjedisor.

Synimi 6. Rregullimi i shtratit të lumit si mjedis i përshtatshëm për rekreacion

Bukuria e një mjedisi urban varet edhe nga shtrirja hidrografike e lumenjve nëpër qendrën urbane.

Aktivitetet e pushimit, rekreimit, argëtimit mundë të zhvillohen pikërisht për gjatë vijës ujore.

Masat:

- Modifikimi i mureve të betonit (rreth 315m) në dy anët me shkëmbinj natyror (të veshën muret e betonit për pamje sa ma natyrore)
- Vazhdimi i rregullimit të shtratit të lumit edhe për pjesën e mbetur rreth 600m
- Krijimi i brezit të gjelbër në dy anët e lumit me druj dekorativ si dhe vendosja e ulëseve të drurit për pushim.

URBANE Q8. Mjedis të shëndosh dhe respektim të trashëgimisë							
Objektivi	Nr Aktivitetit	Aktiviteti	Akterët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
Synimi 1. Minimizimi i ndikimeve të dëmshme të veprimeve të njeriut në mjedis	A1	Rregullore komunale për Inspektoratin konform Ligjit për mjedis si dhe zbatimi i saj me masa ndëshkimore si për personat juridik dhe fizik.	K. Komunal	Inspektorati i mjedisit	*	Buxheti Komunal	1500
	A2	Rritja e Efikasitetit dhe kapaciteteve për Njësine punuese „Pastrimi” për menaxhim efikas	Kuvendi Komunal dhe Zyra regjionale e mbeturinave	Njësia punuese „Pastrimi	**	Buxheti Komunal, Zyra regjionale dhe Donatorët	80000
	A3	Planifikimi i rrugës qarkore të Ferizajt (zvogëlimi i zhurmës dhe ndotjes së ajrit)	MTPT, K. Komunal	MTPT	**	Buxheti i Kosovës	Shiko çmimet në Infrastrukturë
Synimi 2. Krijimi i kushteve për mbrojtje nga rreziqet e ndryshme natyrore	A1	Ndërtimi i strehimores së qytetit në rast rreziku për evakuim.	K. Komunal, MPL, MAP	K. Komunal	**	Buxheti i Kosovës dhe K. Komunal	350000
	A2	Në kuadër të komunës të formohet Shtabi i emergjencës multi diciplinar	K. Komunal	K. Komunal, ShPK, FSK, Njësia Punuese e Ujësjiellës, Njësia e Zjarrfikësve, Drejtoria e Shëndetësisë	*		S’ka implikime buxhetore
	A3	Krijimi i fondit emergjent dhe krijimi i rezervave ushqimore	K. Komunal	Shtabi I emergjencave	*	Buxheti 000i komunal dhe Buxheti i Kosovës	30000
Synimi 3. Zgjerimi i hapësirave	A1	Parku i qytetit tek kompleksi i pishave me rreth 10 ha	K. Komunal	K. Komunal	*	Buxheti Komunal	50000
	A2	Krijimi i zonës së gjelbër për gjatë shtratit të lumit Shtimjanja	K. Komunal	K. Komunal	**	Buxheti Komunal	35000

të gjelbra dhe Mbrojtja e peizazheve natyrore përreth qytetit	A3	Krijimi i brezave të gjelbër me dru dekorativ në qendër të qytetit	K. Komunal	K. Komunal	**	Buxheti Komunal	26000
	A4	Komuna me akt të veçantë ndalon çdo aktivitet ekonomik në dëm të peizazhit	K. Komunal	K. Komunal	*	S'ka	S'ka implikime buxhetore
	A5	Përveç sanimit dhe prerjes fitosanitare të ndalohet çdo aktivitet	K. Komunal	K. Komunal-Drejtorati për bujqësi	*	S'ka	S'ka implikime buxhetore
Synimi 4. Mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore	A1	Komuna në bashkëpunim me MMPH/Agjencionin për Mbrojtje të Mjedisit me akt të veçantë të shpall zonë të mbrojtur Kompleksin e Pishave	K. Komunal ,MMPH	K. Komunal	**	S'ka	S'ka implikime buxhetore
	A2	Në bashkëpunim me MKRS/Departamenti i Kulturës së pari këto monumente të vëhen nën mbrojtje institucionale : -Xhamia e vjetër -Varri i Ahmet Sylejmanit - Shtimja, Kulla e Agush Agës, Tyrbja e Shtimes, Kulla e Muhamet Begut, Shtëpia e Mulla Hysenve dhe Mulla Sylëve, Kroi i vjetër, Kisha ortodokse, Shkolla e parë në Shtime, Rezervuari i parë i ujësjellësit	K. Komunal, MKRS	K. Komunal, MKRS	**	S'ka	S'ka implikime buxhetore
	A3	Nevojat për Restaurim të objekteve të trashëgimisë kulturore:Varri i Ahmet Sylejmanit - Shtimja,Kulla e Agush Agës, Tyrbja e Shtimes, Kulla e Muhamet Begut, Shtëpia e Mulla Hysenve dhe Mulla Sylëve,Kroi i vjetër	K. Komunal, MKRS	K. Komunal, MKRS	***	Buxheti I Kosovës	110000
Synimi 5. Parandalimi	A1	Zgjerimi i kapaciteteve në Kaompanin „Pastërtia”	Janë trajtuar në Infrastrukturë				
	A2	Rritja dhe vendosja e kontejnerëve në tërë zonën urbane					

i hedhjes të mbeturinave	A3	Pastrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve kryesore në qytet					
	A4	Eliminimi i të gjitha mbetjeve ilegale si ato të amvisërisë dhe atyre të ngurta brenda zonës urbane.	Kuvendi Komunal dhe Zyra regjionale e mbeturinave	Njësia punuese „Pastrimi	*	Buxheti komunal	30000
	A5	Ndëshkimi i ndotësve nga Inspektorati mjedisor.	Kuvendi Komunal	Inspektorati i mjedisit	*	S'ka	S'ka implikime buxhetore
Synimi 6. Rregullimi i shtratit të lumit si mjedis i përshtatshëm për rekreacion	A1	Modifikimi i mureve të betonit (rreth 315m) në dy anët me shkëmbi natyror (të veshën muret e betonit për pamje sa ma natyrore)	Kuvendi Komunal	Kuvendi Komunal	***	95000	Buxheti komunal dhe buxheti i Kosovës
	A2	Vazhdimi i rregullimit të shtratit të lumit edhe për pjesën e mbetur rreth 600m	Kuvendi Komunal	Kuvendi Komunal	***	220000	Buxheti komunal dhe buxheti i Kosovës
	A3	Krijimi i brezit të gjelbër në dy anët e lumit me drunjë dekorativ si dhe vendosja e ulëseve të drurit për pushim	Kuvendi Komunal	Kuvendi Komunal	**	45000	Buxheti komunal dhe buxheti i Kosovës

"DISPOZITAT PËR ZBATIM"

FAZA -V

I. DISPOZITAT PËR ZBATIM

I.1. UDHËZIMET MBI ÇËSHTJET E INTERPRETIMIT TË PLANIT ZHVILLIMOR URBAN LIDHUR ME HARTIMIN E PLANEVE RREGULLATIVE DHE PLANEVE TJERA

Komuna mund të filloj me zbatimin e planit menjëherë pas aprovimit të tij. Një numër i elementeve të përfshira me plan duhet të sqarohen me Plane Rregulluese. PZHU nuk ka definuar në tërësi përkufizimet, rregullat e ndërtimit, parametrat urban kështu që një numër i madh i aspekteve të ndryshme duhen të specifikohen më hollësisht. Për çdo zonë urbane duhet të hartohen plane rregulluese. Të gjitha hulumtimet e nevojshme si psh; studime mjedisore, studime në zona të veçanta si dhe studime rreth rregullimit të trafikut, janë të nevojshme dhe duhet zbatuar.

Përveç rolit udhëzues për zhvillimin e zonës urbane, PZHU definon kushtet e zhvillimit të pjesëve të qytetit-planeve rregulluese për lagjet dhe blloqet urbane. Planet rregulluese nuk duhet të jenë në kundërshtim me dispozitat e Planit Zhvillimor Komunal.

Dispozitat:

PZHU duhet të jetë i bazuar në Planin Hapësinor të Kosovës dhe vendimet për zhvillimet me rëndësi për nivelin e Kosovës duhet të respektohen në tërësi.

PZHU duhet të jetë i bazuar në PZHK dhe vendimet për zhvillimet me rëndësi për nivelin Komunal duhet të respektohen në tërësi.

PZHU do të jetë plan bazë për çfarëdo plani rregullues që do të hartohet për zonat urbane. Planet rregulluese nuk duhet të cenojnë dispozitat e PZHU.

Nëse ndonjë pjesë e planit rregullues urban nuk është në harmoni me PZHU, duhet rishikim adekuat dhe miratim në Asamblenë Komunale.

I.2. KUSHTET E PËRCAKTUARA NGA QEVERIA LOKALE MBI ÇËSHTJE TË RËNDËSISHME PËR ZHVILLIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E TOKËS NË ZONËN URBANE

Në PZHU toka për zhvillim është e dedikuar për shfrytëzim si në vijim:

- **Sipërfaqet e ndërtimit** (Banimi i përzier, hapësira e qendrës, hapësira me përmbajtje publike, biznes/Industri)
- **Sipërfaqet specifike** (tregu i gjelbër, trafo stacioni, Varreza, Pikë karburanti)
- **Sipërfaqet e gjelbra** (sport dhe rekreacion, park, shirit dhe korridor gjelbërimi, bujqësi, pyll, lum)
- **Sipërfaqet e transportit** (rrugët, shtigjet për këmbësor dhe çiklist, parkingjet publike)

Kushtet për shfrytëzimin e tokës janë sqaruar detajisht në kornizën e PZHU që ka të bëjë me destinimin e sipërfaqeve dhe mund të përdoren për këtë qëllim.

I.2.2. Kushtet për rregullimin e hapësirës

2.2.1. Kushtet për rregullimin e hapësirës për objektet me rëndësi për Kosovën

Ndërtimi do të jetë i lejuar vetëm në zonat e destinuara për ndërtim të përcaktuara me PZHU.

Të gjitha zhvillimet përgjatë korridorit të autostradës Durrës-Morinë-Merdare dhe zonës së kryqëzimit Komuna do të fus në kontroll të ashpër.

Për të zvogëluar ndikimet mjedisore – emetimin e gazrave, zhurmës dhe pluhurit, komuna do të siguroj një zonë mbrojtëse, brez të gjelbër përgjatë pjesë së korridorit të autostradës. Rregullimi i hapësirës për distancat ndërtimore përgjatë këtij korridori duhet të zbatohet.

2.2.2. Toka ndërtimore për zhvillimin e qytetit

Ndërtimi është i lejuar vetëm në tokën ndërtimore të definuar sipas PZHU-së 2009-2020.

Zhvillimi në qytetin e Shtimes të rregullohet me Plane Rregulluese Urbane.

Infrastruktura publike do të ofrohet vetëm në zonat e destinuara për ndërtim.

Në zonat ku Planet Rregulluese Urbane nuk janë të miratuara, duhet zbatuar hulumtimin për kërkesat, mundësitë dhe ofrimin e infrastrukturës.

Zhvillimet në hapësirën e lirë duhet bazuar në rregullat mjedisore për mbrojtjen e natyrës.

Në mungesë të planit rregullues urban, komuna duhet të nxjerrë udhëzimet përkatëse të karakterit obligues.

Në zonat ku zhvillimi është i lejuar, kushtet e lokacionin duhet të përcaktohen me sa vijon:

Formën dhe madhësinë e zonës së zhvillimit,

Mënyrën e shfrytëzimit apo përdorimin e autorizuar për ngastrën tokësore,

Rregullat e ndërtimit dhe distancën në mes të objekteve në ngastër,

Rregullat për kyçe të objektit në rrjetin e infrastrukturës,

Masat për mbrojtjen mjedisore dhe mbrojtjen e tërësive të trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

Përgatitja e lokacionit si: largimi i ndërtesave dhe rehabilitimi i dheut (tokës), hulumtimet gjeo-mekanike të terrenit.

I.2.3. Kushtet për vendosjen e objekteve të veprimtarive ekonomike

Komuna do të alokoj tokë të mjaftueshme që të përkrahë zhvillimin e biznesit i cili është i bazuar në shfrytëzimin e fuqisë punëtore vendore.

Komuna do të përkrahë themelimin e Këshillit Komunal për Zhvillim për ofrimin e hapësirës për zhvillim ekonomik, lokacion të biznesit dhe menaxhim.

Një parakusht tjetër për implementimin e suksesshëm të këtij plani është një këshill komunal i cili do të udhëheqë një numër të projekteve zhvillimore. Kjo mund të bëhet përmes dhënies se tokës në shfrytëzim, me ndërtimin e rrugëve dhe infrastrukturës

tjetër dhe me krijimin e kushteve më të mira për shitjen e parcelave individëve privat dhe biznesit.

Këshilli gjithashtu do ta bënte ndërlidhjen e planeve dhe programeve zhvillimore Evropiane dhe të Qeverisë Qendrore me qëllim të thithjes së investimeve dhe donacioneve të ndryshme të dedikuara për zhvillim në nivele të ndryshme organizative. Gjithashtu, Këshilli do ta organizonte informimin dhe këshillimin e investuesve privat gjatë promovimit të partneritetit privat/shoqëror.

Aktivitetet ekonomike-tregtare dhe ato të industrisë së lehtë jo shqetësuese deri në 1500m² do të lejohen edhe në zonat banuese-mikse në pjesën urbane.

Zonat komerciale/industriale

Zonat komerciale dhe industriale sigurojnë hapësirë për të gjitha llojet e çështjeve komerciale, kryesisht përdorimet që nuk janë të lejuara në zonat tjera. Janë paraparë përdorimet si në vijim:

- Të gjitha llojet e ndërmarrjeve komerciale dhe industriale, ndërtesat e dyqaneve, depot dhe ndërmarrjet publike,
- Biznes, zyra dhe administratë,
- Pika të karburantit,
- Pajisje sportive,

Përdorimet në vijim janë paraparë vetëm në raste të veçanta:

- Objekte për kulturën, pajisjet sociale dhe kujdesit shëndetësorë,
- Banimin për stafin mbikëqyrës, menaxherët ose pronarët e prodhimeve,
- Objektet e ndërmarrjeve.

I.2.4. Kushtet për vendosjen e objekteve të veprimtarive publike

Themelimi i shërbimeve të reja dhe përmirësimi i shërbimeve ekzistuese publike për qytetin e Shtimes do të jenë të përqendruara në zonën urbane.

Plani Zhvillimor Urban duhet të siguroj tokë rezervë për kërkesa të veçanta (banimi për të moshuarit, asistencë sociale, etj.), dhe zgjerimin e zonave të aktivitetit publik në përputhje me funksionin e Vendbanimit.

Komuna duhet të siguroj hapësirë për shkolla të reja dhe institucione parashkollore. Ato duhet rregulluar me breza mbrojtës dhe të jenë të arritshme nga transporti publik.

Komuna mund të siguroj një ngastër të përbashkët për ndërtimin e një objekti me destinim për: edukim, kulturë, shëndetësi dhe shërbimet sociale, qendra të komunitetit.

Zonat e destinuara për sport dhe rekreacion duhet të jenë të furnizuara me shtigje, infrastrukturë dhe gjelbërim. Në kuadër të këtyre zonave do të lejohet ndërtimi i objekteve të hapura dhe të mbyllura sportive, hapësira për parkim, restorante të vogla dhe dyqane që shërbejnë për pajisje sportive rekreative.

Zonat e alokuara për ndërtim duhet ti përmbushin dhe ndjekin këto kritere:

Institucioni parashkollor - çerdhja

Arritshmëria në distancë prej 400-600 m për dendësi 60-120 b/ha

Sipërfaqja e lokacionit të jetë 0.25-0.3ha (25m² fëmijë)

Sipërfaqja e ndërtuar 4.5-6.5 m²/ fëmijë (numri maksimal i fëmijëve në një ndërtesë duhet të jetë deri 120 fëmijë)

Shkolla fillore

Distanca shtëpi –shkollë duhet të jetë 500-800m (ecje – biçikletë) bazuar në dendësinë e banimit

Sipërfaqja e lokacionit të jetë 1-2 ha

Sipërfaqja e ndërtuar 2.5m² / nxënës (numri i nxënësve të jetë prej 300-400 (27-37 nxënës në një klasë).

Shkolla e mesme

Distanca shtëpi – shkollë duhet të jetë 1000-1500m (ecje-biçikletë), bazuar në dendësinë e banimit të qytetit.

Sipërfaqja e lokacionit të jetë 4-8 ha,

Sipërfaqja e ndërtuar 1.5m²/nxënës (hapësirat e mësimit 60m²) numri i nxënësve në shkollë të jetë prej 500-600),

Komuna mund të alokoj vend të përbashkët ndërtimi për aktivitetet publike si: edukimi, kultura, sporti, shërbimet sociale, qendra e komunitetit.

I.2.5. Kushtet dhe mënyra e ndërtimit të objekteve të banimit

Dendësimi në vendbanimet ekzistuese, pas përcaktimit të hapësirës për fusha të lojës, hapësirave publike dhe parkingjeve do të jetë i stimuluar. Në këto zona ku hartimi i PRRU është prioritet, një vlerësim i mundësive për dendësim do të përfshihet në procesin e hartimit të këtyre planeve.

Zonat e banimit për ndërtim dhe zhvillim janë definuar me PZHU. Ndërtimi është i lejuar vetëm përbrenda kësaj zone.

Komuna do të ndjek konceptin e qytetit kompakt (i propozuar nga PZHU) për zhvillimin e ardhshëm përbrenda qytetit, duke e rritur dendësinë e banimit dhe strukturën fizike në zonën e qendrës.

D-1 / Dendësia minimale 120 – maksimale 150 b/ha (propozuar për zonën e qendrës)

D-2 / Dendësia minimale 90 – maksimale 120 b/ha (në zonën mikse të banimit)

D-3 / Dendësia minimale 60 – maksimale 90 b/ha (në zonat skajore ose brezit të fundit të tokës ndërtimore).

Ndërtimi në zonën qendrore maksimum P+4

Ndërtimi në zonat mikse të banimit P+1 deri P +2

Ndërtimi në zonën periferike P+1, përveç lokacionit të tregut të gjelbër prej 1. 14 ha, në të cilën parashihet ndërtim i lartë: P+8 kate.

Shumica e zonave të banimit kryesisht sigurojnë hapësirë për banim. Në këto zona janë paraparë përdorimet si në vijim:

Ndërtesat për banim,

Furnizimi i zonave të nevojshme për tregti me pakicë, të furnizimit të ushqimit, dhe përdorimet komerciale jo shqetësuese,

Objekte për kulturën, pajisjet sociale të kujdesit shëndetësorë, dhe çështje sportive,

Përdorimet si në vijim janë paraparë vetëm në raste të veçanta:

Tregtia e akomodimit ,

Përdorimet tjera jo shqetësuese komerciale,

Ndërtesat për administratë,

Ndërmarrjet kopshtare,

Komuna duhet të sigurojë tokë për ndërtesat e banimit social,

Komuna duhet të krijojë një platformë të partneritetit publik-privat për zhvillimin e banimit (investime të përbashkëta, dhënia e tokës publike me koncesion, etj),

Objektet ekzistuese të banimit të cilat janë në zonën e gjelbër (jashtë tokës ndërtimore) mund të mbesin, por nuk mund të zgjerohen dhe rikonstruktohen.

I.2.6. Kushtet për përcaktimit e rrjetit të sipërfaqeve të korridoreve apo traseve telekomunikuese dhe rrjetit të infrastrukturës komunale

I.2.7. Kushtet për rregullimin e zonave dhe tërësive me vlera të veçanta

Do të rregullohen me Plane Hapësinore për zona të veçanta.

I.2.8. Masat për zhvillimin e sipërfaqeve sportive dhe rekreative

Qasja, vendosja dhe tipat e hapësirave për sport dhe rekreacion,

Fushë loje në lagje me sipërfaqe 0.2-0.3ha dhe distanca lëvizëse 400-800m,

Gjelbërimi përbrenda lagjes me sipërfaqe 0.5ha dhe distanca lëvizëse 400-600m,

Hapësira për sport dhe rekreacion në kuadër të qytetit me sipërfaqe 2ha dhe distanca lëvizëse 1000-1500 m,

Parku i qytetit me sipërfaqe 18.7ha dhe distanca lëvizëse 600-1000m,

Zonat natyrore të gjelbra me sipërfaqe 20 ha dhe mbulueshmëria 1500-2000m,

Bazuar në normat për sipërfaqet e duhura për sport dhe rekreacion ($3\text{m}^2/\text{b}$, nga të cilat 0.25m^2 - 0.3m^2 duhet të jenë të mbuluara), komuna duhet të sigurojë 4.5 ha për aktivitete të sportit dhe rekreacionit, andaj:

- Komuna duhet të sigurojë tokë për fusha të lojës dhe parqe të vogla përbrenda lagjeve për përdorim të komunitetit,
- Komuna duhet të rregulloj parkun e propozuar me infrastrukturën e nevojshme,
- Komuna duhet të alokoj tokë në afërsi të lumit për gjelbërimin e ri të propozuar dhe të krijojë një rrjet të qarkullimit për çiklist dhe këmbësor për të lidhur parkun e ri me natyrën,
- Komuna duhet të alokoj tokë për zonën e propozuar për sport dhe rekreacion.

I.2.9. Mënyra e trajtimit të hedhurinave

- Të angazhoj kompani për grumbullimin e mbeturinave për tërë territorin urban
- Kompania të marr përgjegjësin për grumbullimin, deponimin dhe bartjen e tyre
- Vendosja e kontejnerëve në vende të nevojshme dhe zgjedhja e këtyre vendeve

- Masa ndaj ndotësve të ujit dhe mos lejimi i hedhjes së mbeturinave në lum

I.2.10. Masat për zbatimin e planit

PZHU-ja duhet të ndryshohet nëse konditat e përgjithshme kanë ndryshuar në dimension esencial.

Bazuar në ligjin për planifikim hapësinor PZHU duhet të revidohet çdo 5 vite.

I.2.10.a. Detyrimi për hartimin e planeve detale rregulluese

Plani Zhvillimor Urban duhet të revidohet çdo 5 vite, ndërsa rishikimi i tij duhet të bëhet çdo 2 vite. Meqenëse hartimi i PRRU duhet të mbulojë tërë territorin urban, është e qartë se prioritet duhet ti jepet atyre zonave ku problemet hapësinore janë të asaj natyre që duhet reaguar me shpejtësi, e posaçërisht në zonat si në vijim:

-Për zona të cilat konsiderohen vendbanime joformale, që në vete kanë ndërtime me një status të paqartë,

- Zonat të cilat me ndërtimet e veta nuk janë në pajtim me PZHU,
- Në zonat apo objektet ku ridizajnimi dhe rikonstruimi i hapësirës publike kërkon zgjidhje të shpejtë.

Zonat në vijim janë identifikuar si zona prioritare për të cilat duhet filluar menjëherë procesin e hartimit të PRRU:

- Zona e Qendrës,
- Zona periferike e zhvillimit,
- Parku i ri i qytetit,
- Zonat rekreative sportive,
- Brezi i lumit.

I.2.10.b. Masat për rregullimin dhe mbrojtjen e tokave

Ndërtesat ekzistuese në zonat e gjelbra nuk duhet të zgjerohen.

Problemet specifike në lidhje me vendbanimet joformale do të vlerësohen dhe do të propozohen zgjidhje sipas direktivave MPH dhe DPH. Prandaj duhet të krijohet një bazë e të dhënave me informata detale për çdo objekt.

Rrërimi i ndërtesave mund të konsiderohet në ato raste ku ndërtimet nuk mund të legalizohen sipas Ligjit mbi ndërtimet ilegale.

Komuna do të ofrojë një lokacion për ndërtimin e shtëpive të reja për njerëzit që duhen ti lëshojnë shtëpitë e tyre në rast të rrënimëve. Gjatë zbatimit të planit nëse kërkohet, ndërtesat e ndërtuara ilegale mund të largohen pas shpronësimit apo marrëveshjes me pronarin. Në këtë rast komuna duhet të ofrojë kompensim të mirëfilltë.

-Në përgjithësi zhvillimi i banimit nuk duhet lejuar jashtë zonës urbane (tokës së planifikuar për ndërtim). Përjashtime mund të bëhen vetëm për objekte të caktuara, që janë në përkrahje të aktiviteteve në këto zona (bujqësi, prodhim, etj)

I.3. DISPOZITAT LIDHUR ME KONSULTIMIN, BASHKËPUNIMIN DHE PJESËMARRJEN

Përmirësimi i pjesëmarrjes, përfshirjes dhe vetëdijesimit

Jetësimi dhe zbatimi i PZHK dhe PRrU-ve është i mundshëm vetëm atëherë kur komuna krijon përkrahje dhe besim të qytetarëve për këto aktivitete, besim i cili do të arrihet me kontakte të drejtpërdrejta dhe fushata mediale me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve.

Centralizimi i informatave hapësinore

Shënimet dhe informatat duhet të centralizohen në një sistem të GIS-it.

Lejet e ndërtimit

Lejet e ndërtimit duhet të qartësohen si procedura dhe të përmirësohen. Baza e të dhënave dhe sistemi i GIS-it duhet ti asistojnë kësaj procedure.

Monitorimi dhe rishikimi

Komuna e Shtimes, si shumë komuna tjera në Kosovë, e ka eksperiencën e zhvillimit dinamik socio-ekonomik. Si rrjedhojë, nevojat për tokë ndërtimore dhe furnizim të infrastrukturës mund të ndryshojnë në mënyrë të papritur. Për këtë arsye, është e nevojshme që të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme zhvillimi i komunës. Nëse është e nevojshme të rishikohet përmbajtja e PZHK-së së paku njëherë në 2 vite. Rishikimi i tërësishëm i planit bëhet pas 5 vitesh.

Mandati i Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit

“Agjencioni duhet të ketë kompetenca t’i administroj Ndërmarrjet në pronësi Publike dhe Ndërmarrjet në pronësi Shoqërore të regjistruara në Kosovë që nga 31 dhjetori 1988 apo ndonjë date pasuese (pavarësisht a i është nënshtruar Ndërmarrja Transformimit apo jo)”. Në bazë të kësaj Rregulloreje, prona të shumta në komunën e Shtimes, bien nën mandatin e AKM-së. Patundshmëria urbane dhe bujqësore e natyrës Publike ose Shoqërore nën mandatin e AKM-së do të ketë një pjesëmarrje të konsiderueshme. Në mes të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe AKM-së është akorduar e ashtuquajtura “procedura për këmbimin e tokave”, në lidhje me kërkesat komunale për të siguruar pronë shoqërore për projekte të interesit të përgjithshëm”. Kjo politikë kërkon që kërkesat të vlerësohen “rast për rast”, ku Ndërmarrja në Pronësi Shoqërore do të kompensohet në mënyrë të duhur për cilëndo pronë të tyre që do ti transferohet komunës.

I.4. DISPOZITAT MBI RENDIN KRONOLOGJIK APO ETAPAT E ZBATIMIT

Buxheti i shpenzimeve komunale bazuar në PZHK dhe PZHU

Planifikimi i investimeve komunale, posaçërisht ato me komponentë hapësinore (përfshirë aktivitetet e planifikimit, punëve publike, shpërndarjen e shërbimeve publike, banimi dhe ndërtimi tjetër), do të realizohet në përputhje me veprimet e theksuara në të dy planet PZHK dhe PZHU.

Tre muaj pas miratimit të dy planeve (PZHK dhe PZHU), Asambleja Komunale do të miratoj planin e buxhetit me të cilin do të ceket qartë se si do të financohet zbatimi i të dy planeve për së paku tri vitet e para. Ky plan shtesë i buxhetit do të definoj mes tjerash se si do të hartohen PRrU-të, se si do të zbatohen hulumtimet e domosdoshme dhe si do

të financohet hartimi i dokumenteve politike zhvillimore sikur janë të përcaktuara me plane zhvillimore.

Sigurimi i përputhshmërisë me dokumentet ekzistues politike

Tre muaj pas miratimit të dy planeve (PZHK dhe PZHU), komuna duhet të rishikoj politikat sektoriale në mënyrë që ato të jenë në harmoni me dispozitat e PZHK dhe PZHU.

I.5. ELEMENTET DHE UDHËZIMET PËR HULUMTIM TË MËTUTJESHËM

Hulumtimet, planet dhe politikat që duhet hartuar:

- Plani i politikave mjedisore, në veçanti mbrojtja e ujërave, tokës bujqësore, pyjeve,
- Plani i infrastrukturës teknike,
- Politikat e mobilitetit,
- Hulumtimi i energjisë alternative,
- Zonat arkeologjike,
- Studimi i mundësive dhe i një furnizimi të qëndrueshëm me ujë të pijes,
- Prodhimet ekologjike,
- Zhvillimi ekonomik,
- Turizmi,
- Gjelbërimi, etj.